



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 31 JANAR DHE 1 SHKURT 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 31. JANUARA I 1. FEBRUARA 2018. GODINE**

**JANAR/SHKURT - JANUAR/FEBRUAR
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me ndotjen alarmante të ajrit

Dnevni red

1. Parlamentarna debata o alarmantnom zagađenju vazduha

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Në sallë janë të pranishëm aktualisht 63 deputetë.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas kërkesës së 40 deputetëve të Kuvendit.

E kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me ndotjen alarmante të ajrit

Para se të fillojmë seancën, Milaim Zeka e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Para se të fillojmë seancën, duke u bazuar në atë se të gjithë popujt e botës i nderojnë vlerat e veta, njerëzit e vet, heronjtë e vet. Mbrëmë ka ndërruar jetë një njeri shumë i madh, një njeri që i ka dhënë shumë këtij vendi, këtij kombi dhe falë atij njeriu jemi edhe ne sot në Parlamentin e Kosovës, e kam fjalën për zotin Haradin Bala.

Prandaj, në shenjë respekti dhe nderimi për të dhe të gjithë të tjerët kërkoj një minutë heshtje.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha pasur dëshirë, pasi është përvjetori i 21-të i rënies së tre heronjve të kombit, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, e kam pasur ndërmend të kërkoj nga seanca një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Lavdi!

Të nderuar deputetë,

Me iniciativën time në cilësinë e kryetarit të Kuvendit, i mbështetur nga 39 deputetë të tjerë nënshkrues, kam kërkuar që të mbahet seancë e jashtëzakonshme për të debatuar dhe gjetur zgjidhje për ndotjen alarmante të ajrit, me theks të veçantë në regjionin e Prishtinës.

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari z. Xhavit Haliti.

KRESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Të nderuar kolegë deputetë,
Faleminderit!

Duke ndarë shqetësimin e përbashkët me qytetarët dhe të gjithë ju për gjendjen alarmante të ambientit.

Në shumë pjesë të vendit tonë në mënyrë të veçantë në kryeqytetin tonë, në Prishtinë, është iniciuar edhe kjo seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Motivi themelor i kësaj iniciative është i qartë dhe i thjeshtë, si institucion më i lartë i shtetit Kuvendi i Kosovës nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj krizës ambientale, të cilën e kemi aktualisht, e cila sipas raportimeve të fundit ka marrë përmasa shqetësuese për jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë.

Kam iniciuar këtë seancë që përmes një debati racional dhe konstruktiv të japim kontributin tonë të domosdoshëm në përmirësimin emergjent të kësaj situatë të rëndë ambientale.

Kjo është një seancë e cila duhet të na bashkojë e jo të na ndajë, për këtë edhe e kemi bërë, se jemi mësuar veç për sende të rënda, të dalim edhe në pjesë më sensibile për qytetarët. Dëshiroj që të gjithë së bashku të diskutojmë pa dallime partiake dhe të jemi pjesë direkte jo vetëm e përmirësimit të strategjisë nacionale ambientaliste me masa konkrete, por direkt edhe përgjegjës, përkatësisht implementues në rolin tonë si mbikëqyrës si Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Shëndeti i qytetarëve është mbi çdo interes partiak, jam thellësisht i interesuar që nga ky debat të dalim me një pako të përbashkët ose rezolutë, rekomandime të seancës, të ideve dhe rrugëve praktike për sanimin e shpejtë të gjendjes.

Ne kemi përgjegjësi për gjetjen e zgjidhjeve, këtë e presin sot qytetarët nga ne dhe nga kjo seancë. Kemi pasur sot edhe një protestë mu në qendër të Prishtinës, me kërkesa të qarta. Besoj që të gjithë do të jemi të pajtuar në këtë pikë.

Veçantia e kësaj seance qëndron në idenë që sot këtu duhet të flasim më pak vetëm si përfaqësues të partive tona politike, edhe më shumë si prindër të fëmijëve të rrezikuar nga ndotja ekstreme, bijë e bija të prindërve që krahas viteve të pleqërisë u duhet të përballojnë edhe ambientin shumë të ndotur.

Të gjithë jemi dëshmitarë të gjendjes së rëndë, në të cilën ndodhet kryeqyteti ynë, e nuk e dimë fare në çfarë gjendje alarmante është edhe gjendja në Obiliq e Fushë-Kosovë, për arsye se nuk jemi matës, as në Mitrovicë.

Por, e mira është se qytetarët po bëhen çdo ditë e më të vetëdijshëm dhe jotolerues ndaj kësaj gjendje. Fakti është se ne kemi trashëguar një gjendje të mjerueshme të faktorëve që shkaktojnë ndotjen ambientale, industrializimi, siç është KEK-u në Obiliq, “Trepça” apo ndotja e lumenjve janë faktorë të cilët i kemi një kohë të gjatë. Edhe pas luftës ne duhet ta pranojmë faktin se për shkak të moskontrollit të industrisë së ndërtimit kanë lulëzuar ndërtimet e egra dhe kaosi urbanistik, i cili i ka ndihmuar gjendjes më të rëndë ambientale. Papërgjegjësia jonë qytetare, hedhja e mbeturinave, pastaj edhe prerja e drurëve po ashtu janë shkaktarë, të cilët e kanë keqësuar gjendjen tonë.

Kështu qytetet tona i kemi dëmtuar, i kemi helmuar, po kjo më së shumti vërehet në kryeqytetin tonë.

Kryeqyteti dhe jeta e qytetarëve në këtë qytet pothuajse është ngufatur. Hapësirat publike nga dita në ditë po ngushtohen dhe në shumë pjesë vitale të kryeqytetit tonë sot u ngjajnë labirinteve të zymta.

Koncentrimi i gjithë aktivitetit institucional dhe biznesor në Prishtinë vetëm se e ka rritur edhe më shumë ngufatjen dhe pasoja të rënda të ndotjes industriale.

Qarkullimi i ngarkuar i automjeteve të vjetërsuara, cilësia shpesh e dyshimit të karburanteve të përdorura si dhe përdorimi për ngrohje i lëndëve djegëse, ambientalisht të dëmshme, vetëm sa i kanë rënduar edhe më tepër gjendjen.

Atëherë kjo e ka krijuar një gjendje të dhimbshme, por të vërtetë.

Prishtina është bërë ambientalisht qytet i pajetueshëm, por edhe shumë qytete të tjera po ashtu nuk janë më mirë, e ripërsëris gjendjen në Obiliq, Fushë-Kosovë dhe në Mitrovicë.

Rangimi në krye të listave të qyteteve më të ndotura të kryeqytetit tonë është një gjë që duhet të na alarmojë të gjithëve. Ne i kuptojmë përgjegjësitë e ndara institucionale, por kjo nuk na krijon komoditetin që ta hedhim fajin dhe përgjegjësinë as vetëm te një komunë, as vetëm te Qeveria, por duhet të marrim përgjegjësi të gjithë bashkërisht.

Është momenti për fokusim të përbashkët ndërsektorial në marrjen e vendimeve të shpejta dhe efikase për tejkalimin e kësaj situatë të rëndë për shëndetin e qytetarëve tanë.

Interesimi dhe involvimi i Kuvendit duhet të shihet si rol direkt ndikues i domosdoshëm në përpalljen urgjente me gjendjen alarmante të ambientit në Kosovë.

Në rend të parë nuk duhet të mjaftoheni vetëm me masa kozmetike, të cilat vetëm e zhvendosin vëmendjen, por nuk e sjellin problemin.

Propozoj që nga kjo seancë të dalim me rekomandime ose rezolutë, këtë e vendos vetë seanca, për hapa konkretë për të siguruar një zgjidhje afatgjate.

Konsideroj se është e domosdoshme që ne t'i përmirësojmë politikat e deritanishme mjedisore lidhur me cilësinë e ajrit.

Të krijohet buxhet i veçantë për përkrahjen e investimeve të qytetarëve dhe bizneseve, me të cilat ulen shpenzimet e jetesës dhe rritet cilësia e shëndetit, duke investuar në izolimin e shtëpive, ndërtesave të paizoluara në Kosovë.

E kemi një projekt të jashtëzakonshëm për çka duhet të jemi falënderues, projektit amerikan MCC-së, i cili i ka ndarë tashmë 22 milionë dollarë, ndërsa ideja që Qeveria e Republikës së Kosovës, ky Kuvend, të votojë që t'i ndajë edhe 30 milionë euro për këtë qëllim do ta përmirësonte ekonomitë familjare gjendjen shumë, po flas drejtpërdrejt me izolimin e shtëpive të tyre.

Pastaj zgjerimi i projektit të kogjenerimit. Njëjtën kohë ideja e mbjelljes së drurëve në zonat urbane, e cila ka qenë një ide vetëm se u dha dhe nga një kolege deputete e "Vetëvendosjes" për një milion fidanë.

Trajtimi i ujërave të zeza, trajtimi i mbeturinave organike përmes riciklimit, ndihmesa për ngrahjen e qytetarëve me energji alternative përmes formave të lehtësimit, kreditimit me burime termike, kontrolli strikt i importit dhe i veturave, konform standardeve teknike dhe kontrollimi teknik, i cili duhet të jetë më i rreptë se sa aktualisht e kemi.

Të ndërmerren masa, hapa konkretë edhe për lidhjen me gazsjellësin përmes Shqipërisë, i cili do të krijonte mundësinë e përdorimit të gazit që do të kishte përfitime mjedisore dhe ekonomike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju ftoj për një debat sa më përmbajtjesor në dobi të qytetarëve, po ashtu me mirëkuptimin tuaj unë do të ftoja grupet parlamentare që ta caktojnë ndërkohë nga një anëtar që përfundimin e këtij debati ta përkthejnë me propozimet e tyre qoftë me hapa të cilat duhen të ndërmerren nga diskutimet në këtë seancë plenare të jashtëzakonshme, rekomandime ose rezolutë për tejkalimin e kësaj shtate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Tema për të cilën jemi mbledhur është temë e cila do të na bëhet aktuale çdo vit në këtë kohë, nëse nuk ndërmarrim diçka konkrete dhe serioze.

Sipas disa statistikave, me një hulumtim të shpejtë, në planetin tonë rreth 3 milionë njerëz vdesin për çdo vit nga ndotja e ajrit.

Kjo temë, edhe pse për momentin duket alarmante dhe problematike për ta zgjidhur, unë besoj si dhe grupi ynë beson që me angazhim të sinqertë e serioz të të gjithë aktorëve, pra Qeverisë, komunave të afektuara, donatorëve dhe Kuvendit, mund të bëjnë një zgjidhje edhe afatgjate, edhe të qëndrueshme.

Ndonëse besoj shumë që shumica prej kolegëve sot do të flasin për problemet që shkaktohen nga thëngjilli që përdoret për termocentrale, vjetërsinë e këtyre termocentraleve, cilësinë shumë problematike të derivateve të naftës që përdoren në Republikën e Kosovës dhe çështje të ngjashme që shkaktojnë këtë ndotje të ambientit.

Unë do të përdor këto 9 minutat e mbetura të flas për politika konkrete, të cilat besoj shumë do të mundë të afektonin dhe do të mund të krijojnë hapësirë për zgjidhjen e problemit.

Sido që të jetë, me që komuna e Prishtinës, e Obiliqit dhe e Fushë-Kosovës, e përmendi kryetari i Kuvendit edhe Mitrovicën, unë veç një informacion të vogël po e jap.

Komuna e Prishtinës para katër vjetësh, kur nuk kishte matës të ndotjes së ajrit, ngrohjen qendrore e kishte me mazut, shkollat në fshatra ngroheshin me qymyr, ndërsa në qytet me atë që thuhej naftë, po në fakt ishte gazoil.

Mbi 70% e taksive në komunën të Prishtinës para katër vjetëve ishin nën standardin Euro 3 dhe numri i fidanëve të mbjella ishte jashtëzakonisht i vogël.

Sot Prishtina ngrohet me avullin që vjen nga projekti i kogjenerimit, ndërsa numri i taksive që e tejkalon standardin Euro 5 është flota e taksive që operon ligjërisht në Prishtinë është mbi 70%, janë mbjellë mbi 10 mijë fidanë, por e gjitha kjo është e pamjaftueshme. Për të zgjidhur problemin e ndotjes në kryeqytet gjithsesi duhet të ecim tutje së bashku me Qeverinë dhe partnerët e tjerë donatorë.

Po besoj shumë që projekti i kogjenerimit ka qenë një prej shembujve të mirë se si mund të përdoret një, të themi, burim i energjisë, për të mënjanuar një ndotës, siç ishte mazuti në ngrohtoren “Termokos”. Sa për informacionin tuaj, kapacitetet ekzistuese mund të shtohen në blloqet e tanishme sa i përket kogjenerimit. Këtu më duhet të shpreh mirënjohjen time edhe për kryeministrin Haradinaj, i cili, me sa e kuptova, pardje kishte nënshkruar një vendim që të vazhdohet tutje me projektin e kogjenerimit dhe ngritjen e kapaciteteve duke i përdorur blloqet ekzistuese dhe lidhjen e tyre me “Termokos”.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Unë do të propozoj pesë politika konkrete, të cilat së bashku me grupet e tjera parlamentare do të mund t’i përmblihdhim në një rezolutë të përbashkët, e që do të mund të ishte një rrugëtim, një plan yni se si të zgjidhim problemin e ndotjes së ajrit. Propozimi i parë, sipas një studimi që është bërë nga KAEFW me 24 milionë euro shtesë mund të dyfishohet kapaciteti i kogjenerimit nga 140 megavat energji termike që tash i përdorim, në 280 megavat energji termike. Ky dyfishim i kapaciteteve, i nderuar kryeministër, të nderuar kolegë, do t’i mundësonte “Termokos”-it që të bëjë lidhjen me 180 mijë konsumatorë. Pra, dyfishim i kapacitetit prej 90 mijë sosh sa i kemi tani. Kjo gjithsesi, nënkupton që potencialisht 90 mijë konsumatorë i kemi më pak të interesuar që të ngrohen me thëngjill apo me lëndë të tjera djegëse, të cilat mund të shkaktojnë ndotje të ambientit.

Besoj shumë që një vendim i tillë mund të merret dhe mund të ecet shumë shpejt përpara, po flasim për blloqet ekzistuese dhe dyfishim të kapaciteteve në një investim prej 24 milionë eurosh. Pra, prej 90 mijë konsumatorëve, në 180 mijë konsumatorë dhe këtu më duhet gjithsesi të potencoj që edhe Komuna e Obiliqit duhet të merret parasysh në këtë lidhje. Ata janë, si të themi, pranuesit më të mëdhenj të ndotjes që bëhet në Kosovë.

Propozimi i dytë, në komunat ku kemi këtë cilësi të ajrit dhe i përmendi edhe Kryetari i Kuvendit, duhet të shikohen me urgjencë dhe këtu besoj ministri i Financave gjithashtu mund të shohë hapësirën buxhetore, që për politika, për subvencionim të qytetarëve që nuk i kanë gjendjen ekonomike materiale të mirë dhe t’u ndihmojmë atyre që të lëvizin nga ngrohja me thëngjill në ngrohje të tjera, të cilat nuk shkaktojnë ndotje të ajrit. Nëse politikën e parë fillojmë së implementuari kërkesat për subvencionim do të zvogëlohet në mënyrë drastike në periudhën afatmesme, kogjenerimi, dyfishimi i kapaciteteve mund të bëhet një periudhë afatmesme dhe subvencionimi do të ndodhte për këtë periudhë, derisa t’i ndërtojmë kapacitetet shtesë.

Normalisht, që këto politika duhet të jenë përjashtuese për ata që qëndrojnë ekonomikisht mirë, e që e përdorin thëngjillin për ngrohje. Raste të tilla në komunën e Prishtinës kemi jashtëzakonisht shumë. Pra, për këta që përdorin thëngjill për ngrohje në banim individual dhe i kanë kushtet ekonomike mirë, për këta duhet të vendoset një taksë shtesë.

Propozimi i tretë, e pashë dje një takim të zonjës Apostolova me kryetarin e Kuvendit. Në këtë takim, në njërën prej tuitave të zonjës Apostolova ajo shprehu brengën për ndotjen e ajrit që e kemi në kryeqytet, dhe meqë është brengë për Komisionin Evropian, propozimi im i tretë për një ndihmë direkte prej donatorëve është që 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nëse secili prej tyre bën donacion prej 2 autobusësh, do të kemi flotë të re prej 56 autobusëve, që së bashku me flotën ekzistuese do të zgjidhte problemin e transportit publik për tri komuna: komunën e Prishtinës, komunën e Obiliqit dhe komunën e Fushë-Kosovës, dhe kështu do të reduktonim numrin e veturave që sillen nëpër komunat që po i përmendim, e që janë më të afektuarat nga ndotja që po e shohim këto ditë.

Kjo ndihmë e Komisionit Evropian, së bashku me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, së bashku me projektin e Berzhit që po implementohet sot nga Komuna e Prishtinës, do t'i mundësonte ndërmarrjes "Trafiku Urban" që së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës, komunat e përmendura të bëjnë zgjidhje të mirë edhe për bartjen e punëtorëve në zonat, të cilat tashmë janë industriale apo gjysmindustriale, ku pra është punësimi më i madh që ndodh ose ku ka të punësuar më së shumti.

Së bashku me programet që tash po implementohen nga Komuna e Prishtinës për ndërtimin e shtigjeve pedonale, për mbjelljen e fidanëve, parqe të reja, besoj që do të zvogëlojnë jashtëzakonisht shumë ndotjen në qytet. Pra, donatorëve u kërkohet ndihmë në renovimin e flotës së transportit publik në komunën e Prishtinës.

Propozimi i katërt, në strategjinë energjetike që keni prezantuar me sa e di javën e kaluar në Kuvend, keni shpërfaqur në atë dokument interesimin e investitorëve privatë që të investojnë në burime të ripërtëritshme të energjisë. Ndonëse nuk e konsideroj veten ekspert të këtij lëmi, me pak hulumtim e kuptova mbrëmë nga ueb faqja e ZRE-së që janë shpërndarë një numër i madh ose një numër i caktuar i licencave preliminare për ndërtimin e fermave të prodhimit të energjisë nga era. Gjithashtu, me një hulumtim jo edhe shumë të gjerë, e kuptova se në Kosovë ka lokacione ku janë bërë këto hulumtime dhe shihet që në këto ferma për prodhim të energjisë nga era shpejtësia mesatare e erës është prej 7,2 metra në sekondë, deri në 9.8 metra në sekondë.

Të nderuar deputetë, në krahasim me Republikën Federale të Gjermanisë, mesatarja është 6.4 deri në 6.9. Pra, potenciali për ndërtimin e fabrikave për prodhim të energjisë nga era në Republikën e Kosovës është i madh. Dhe, propozimi im është i thjeshtë, Qeveria së bashku me rregullatorët në këtë fushë të ecin sa më shpejt në pajisjen e investitorëve me dokumentacionin e duhur që të fillojnë të ndërtojnë kapacitetet e prodhimit të energjisë nga era. Potencialisht, sipas ueb faqes të ZRE-së, janë afër 200 megavat energji që mund të prodhohen vetëm nga era dhe besoj që kjo do të ndihmonte jashtëzakonisht shumë në reduktimin e nevojave për energji nga linjiti apo thëngjilli.

Propozimi i pestë, e që është afatshkurtër, që mund të bëhet menjëherë në bashkëpunim me komuna, në shumë qytete të Bashkimit Evropian si pjesë e mobilierisë urbane janë vendosur drunjtë artificialë inteligjentë që bëjnë pastrimin e ajrit. Propozoj që Qeveria së bashku me Komunën e Prishtinës, Kastriotit, Fushë-Kosovës dhe Mitrovicës me procedurë të prokurimit të përshpejtuar për shkak të situatës të bëjë furnizimin e këtyre komunave me këto pajisje dhe këto do të mund t'i zëvendësonim, për shembull, numrin e jashtëzakonshëm të bilbordeve që i kemi gjetiu nëpër të gjitha komunat dhe në vend të tyre të vendosim mobileri urbane, këta filtrues të ajrit, të cilët i zëvendësojnë 275 drurë. Kjo mund të duket ndoshta edhe ide paksa e tepruar për disa, por është ide që po zbatohet në shumë kryeqytete evropiane.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Ndonëse jam i vetëdijshëm që këto propozime mund të duken ambicioze, jam i bindur që me këto pesë politika duke mos u marrë me kritikën për se si kemi ardhur në këtë gjendje mund të tejkalojmë këtë situatë në periudhë afatmesme kohore.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem, prej grupit parlamentar e merr kohën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Pra, ndonëse jam i vetëdijshëm që këto propozime mund të duken tepër ambicioze, jam i bindur që me një qasje edhe të sinqertë, edhe serioze të të gjithë aktorëve mund të sigurohemi që vitin tjetër të mos kemi këtë lloj interpelance. Dhe, në fund, po propozoj që nëse edhe grupet e tjera kanë propozime të tilla, të mblidhen grupet ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe të përgatisim një rezolutë, një mocion të përbashkët, i cili do të japë edhe rrugën përpara për politikën që Qeveria e Republikës së Kosovës, së bashku me këto katër komuna, mund t'i ndërmarrë në periudhën kohore të domosdoshme për të tejkaluar këtë situatë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përgatitet zonja Evgjeni Thaçi-Dragusha nga Partia Demokratike e Kosovës.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka pranuar me shqetësim të madh njoftimin këto ditë, njoftimin e Institucionit Kombëtar të Shëndetit Publik për parametrat tejet të lartë të

ndotjes së ajrit në Prishtinë dhe rrethinën e saj bazuar në matjet ditore të cilësisë së ajrit që e realizon Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Bazuar në të dhënat zyrtare dhe situatën emergjente, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë në funksionin e nënkryetares së Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, më datën 29. 1. 2018 kam kërkuar nga komisioni parlamentar që të kemi takim urgjent me të gjitha institucionet relevante për ruajtjen e ajrit dhe mjedisit. Komisioni është pajtuar me kërkesën time dhe ne dje, më 30.01.2018, në ora 12:00 kemi ftuar këtë takim që ka zgjatur për disa orë. Para komisionit kanë raportuar ministrja e Ambientit, zonja Reshitaj, kryeshefi e Agjencisë për Mbrojtje të Ambientit, zoti Morina, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, zoti Ramadani, drejtori i KEK-ut, zoti Gjukaj dhe Avokati i Popullit, zoti Jashari.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur flasim për ndotjen e ajrit dhe të ambientit, atëherë vërtet duhet të ndihemi keq të gjitha institucionet, por edhe si shoqëri në përgjithësi. Në Kosovë nuk funksionon asnjë hallkë e institucioneve, e cila mbron ambientin. Ne kemi ajrin e ndotur, rrugët, qytetet e fshatrat e mbushura me mbeturina, lumenj të ndotur dhe të dëmtuar, kodra e male të dëmtuara dhe të shkatërruara nga prerja e pyjeve dhe gurthyesit, çdo gjë është jashtë kontrollit dhe ashtu si nuk duhet.

Është e vërtetë se problematika e ndotjes së ajrit dhe ambientit në përgjithësi nuk fillon nga sot, por ne së paku si shtet kemi bërë ligje të mira dhe të mjaftueshme, të cilat duhet të respektohen. Po ndalem vetëm te ndotja e ajrit, me theks të veçantë në Prishtinë me rrethinë, sepse çështjet mjedisore janë temë e gjerë. Kush është përgjegjës për situatën e patolerueshme? Kush janë ndotësit kryesorë? Cilat janë masat që duhet ndër marrë që ta kalojmë këtë gjendje dhe këtë fazë emergjente? Në bazë të raportimit që patëm dje nga institucionet relevante për këtë çështje pamë se asnjë institucion nuk ka fakte shkencore kompetente që së paku të bëjë radhitjen e ndotësve saktë. Ne pamë dhe konstatoam se nuk respektohen ligjet. Inspektorati nuk e kryen punën që obligohet nga ligji, ata kanë të drejtë, pra ligjore që ta mandatojnë gjobën, e jo të dërgojnë çështjet në gjykata ashtu si kanë vepruar. Sidoqoftë, me hamendje të institucioneve, të cilat supozojnë se ndotësit kryesor janë: KEK-u, automjetet dhe ngrohja ekonomike familjare, institucioneve publike dhe bizneseve, me produktet e pakontrolluara dhe të palejuara.

Në bazë të Ligjit për mjedisin, ndotësi i ajrit dhe i mjedisit paguan, atëherë shtrohet pyetja, sa është respektuar ky ligj? Po fillojmë nga KEK-u. KEK-u ka obligim ligjor që të vë elektrofiltrat mbrojtës, në të kundërtën Inspektorati duhet ta sanksionojë me gjoba deri në marrjen e licencës, gjë që asnjëherë nuk ka ndodhur.

Automjetet, vendimi që të ndalohet qarkullimi i automjeteve nëpër rrugët, edhe ashtu të mangëta të Prishtinës është skandalozë, i padrejtë dhe jologjor. Në vend se të merren masat në kontrollin e cilësisë së karburantit, në kontrollin teknik të automjeteve, Kosova është i vetmi shtet në rajon që ka monopol të homologimit të automjeteve, e që të gjitha këto e bëjnë që krimi i organizuar në mes të Doganës, agjencive të sigurimeve të veturave dhe homologimit të funksionojë. Në vend që të luftohet ky krim i organizuar me masat dhe instrumentet ligjore, ju merrni masat e vetme, të cilat i atakojnë qytetarët e pafajshëm dhe ua vështirësoni jetën, edhe ashtu të vështirë që e kanë.

Ngrohja me mjetet e palejuara dhe të rrezikshme për shëndetin, thuhet pra se vetëm 7% e Prishtinës me qytetet përreth ngrohen me ngrohje që nuk ndotin ambientin, kjo thotë shumë. Dua t'ju jap një shembull, se sa të papërgjegjshëm janë Inspektorati qendror dhe ato komunale. Një qytetar nga Klina dje më dërgoi këtë mesazh: Luigj Prenaj, ai thotë: “Jam një automekanik që punoj në Klinë. Jam shumë i shqetësuar për vajrat e vjetra mekanike, të cilat janë mbetje të rrezikshme për ambientin. Vetëm unë”, thotë ai, “në këtë punëtori të vogël grumbulloj deri në katër mijë litra në vit. Këtë vaj, vijnë kompanitë e caktuara që e grumbullojnë me një çmim të lirë nga ne dhe shitet për ngrohje”. Me mijëra tonelata të këtij vaji digjet nëpër shtëpitë tona dhe për vite të tëra zhvillohet kjo situatë.

Shtrohet pyetja: A e dinë institucionet tona këtë fakt dhe çfarë kanë ndërmarrë? Asgjë! Asnjë hap deri më tani.

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështjet mjedisore janë temë e gjerë, sikur që në Kosovë problemet mjedisore janë probleme të shtresuara me dekada. Çështjet mjedisore kanë kosto të lartë, po ne nuk guxojmë ta injorojmë problemin dhe nga papërgjegjësia institucionale të abuzohet me qytetarët, duke ua rrezikuar shëndetin dhe jetën. Qeveria duhet të ketë plan serioz afatshkurtër dhe konkret.

Zgjidhja e problemit të ndotjes së ajrit nuk është e pamundur. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për situatën aktuale është:

- Ndotja nga KEK-u të sanohet duke respektuar ligjet dhe të vendosen urgjentisht elektrofiltrat e cilësisë së duhur dhe në afat kohor të duhur. Pra, kjo duhet të ndodhë menjëherë!

- Të evitohet tërësisht ndotja nga ngrohja me materie të rrezikshme, duke bërë shtrirjen e ngrohjes qendrore nga KEK-u për Prishtinën, Obiliqin, Fushë-Kosovën, Podujevën dhe Lipjanin, në afat prej dy vjetëve.

- Të angazhohet Qeveria, KEK-u, komunat dhe projektet e IPA-s nga BE-ja që të shfrytëzohet avulli nga KEK-u dhe qytetarëve t'ua ofrohet ngrohje cilësore ekologjike dhe ekonomike.

Pra, Komuna e Prishtinës është shembulli më i keq, i cili nuk i ka kryer obligimet e veta për projektin e koogjenerimit dhe kemi ndërtesa në qendër të qytetit që nuk kanë ngrohje qendrore. Ndërsa, dje Komuna e Prishtinës merr vendime të papranueshme për ndalim-qarkullimin e automjeteve. Ky është abuzim me qytetarët e vendit dhe është vendimi më i lehtë i mundshëm.

Krahas veprimit emergjent të ndotjes së ajrit, duhet të vendosen të gjitha fushat e mbrojtjes së ambientit dhe pasurive kombëtare, siç janë pyjet dhe lumenjtë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Për fund, duhet t'i fillojmë projektet e gjenerimit të rrymës alternative dhe natyrisht që Lidhja Demokratike e Kosovës, tash, aktualisht dhe konkretisht, kërkon që të respektohen ligjet në fuqi, të cilat sikur të ishin respektuar nuk do të ishte gjendja çfarë është - alarmante në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Evgjëni Thaçi-Drăgusha e ka fjalën. Ndërkohë bëhet gati zoti Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

EVGJËNI THAÇI-DRĂGUSHA: Përshëndetje!

I nderuar kryetar i Parlamentit të Kosovës, njëherësh edhe iniciues i kësaj seance të jashtëzakonshme.

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Tema që diskutohet sot është një ndër më të rëndësishmet që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Në një parlament të një shteti demokratik dhe stabil janë pikërisht këto tema që e marrin shumicën e kohës së diskutimit.

Problemin e ndotjes së ajrit dhe të ambientit, në përgjithësi, e kemi të pranishëm me dekada. Situatën e rëndë e kanë alarmuar qytetarët tash e një kohë të gjatë. Banorët e Obiliqit, Fushë-Kosovës, Drenasit, Hanit të Elezit, Mitrovicës dhe qyteteve të tjera që u përmendën këtu, por edhe të Kosovës, në përgjithësi, e kanë ngrëhur zërin për një kohë të gjatë për këtë çështje, por ata kanë hasur në veshë të shurdhër.

Në fakt, nuk nevojitet të jemi ekspertë për ta kuptuar se në çfarë gjendjeje është ambienti në Kosovë. Mjafton të ngremë kokën dhe t'i shohim kulmet e shtëpive, që janë komplet të bardha nga pluhuri. Rrallë ndonjë familje në këto qytete që nuk është prekur nga sëmundje të rënda, si pasojë e ambientit të ndotur. Mirëpo, fatkeqësisht u desh që Ambasada Amerikane t'i vendosë matësit e ajrit dhe ne të shohim se çfarë ajri po marrim. Ajo që e bën edhe më tragjike dhe komike në të njëjtën kohë, janë deklaratimet e zyrtarëve të Komunës së Prishtinës, që të mos

bazohemi në matjet e ambasadës, sepse ajo është më afër termocentraleve në Obiliq, për këtë shkak gjendja në pjesën tjetër të qytetit nuk qenka edhe aq e keqe.

Sikur flasim për ndonjë qytet me përmasa të Çikagos, apo të Londrës. Paramendojeni se si ndihen banorët e Obiliqit kur i dëgjojnë këto deklarata, të cilët, përveçse bashkëjetojnë me termocentralet, çdo ditë rrezikohen edhe nga deponi të mbeturinave, siç është ajo e Mirashit, që dikush e ka quajtur edhe si “bombë mjedisore”.

Këta qytetarë, si të gjithë ne që jetojmë dhe punojmë në Prishtinë, janë si të gjithë ne. Nuk janë qenie imune ndaj çdo ndotësi të mundshëm. Me sa e di unë, shumica e familjeve në Obiliq gjatë dimrit ngrohen me qymyr, e kjo edhe për faktin se shumë prej tyre punojnë në KEK dhe nga ky i fundit e marrin një sasi të qymyrit dhe është pikërisht Obiliqi nëpër të cilin kalojnë gypat e ngrohjes, apo sistemi i koogjenerimit e vetë ky qytet nuk është i kyçur. Kjo është një padrejtësi shumë e madhe.

Nga ekspertë thuhet se pasojat e kësaj ndotjeje nuk vërehen menjëherë. Më e keqja është se ne kemi vite që i jemi ekspozuar këtij ajri dhe, në fakt, jemi viktimat të tij. Çështja është se a mund të sanohet dhe si të sanohet kjo gjendje dhe si të ndalohet ndotja?

Mendoj se masat e përkohshme janë të domosdoshme, njëjtë si edhe ato afatgjata. Duhet të hartohen politika afatgjate shtesë, të cilat e mbrojnë ambientin dhe të kujdesemi që ato të zbatohen. Duhet të fillohet me vetëdijesimin e qytetarëve, sidomos të gjeneratave të reja, lidhur me mbrojtjen e ambientit. Kjo mund të bëhet nëpërmjet fushatave në shkolla, ku rol të veçantë do të kishin prindërit dhe mësuesit.

Duhet të mendojmë për neutralizimin e ndotësve, të pyesim se në këtë moment a më lirë na bie të prodhojmë energji, apo ta blejmë atë, ndërsa energjia alternative të përkrahet më shumë dhe të krijohet strategji për të, në mënyrë që të dalim nga vartësia e energjisë nga termocentralet. Duhet të mendojmë se si ta zhvillojmë dhe modernizojmë trafikun urban. Të ndërtojmë më shumë parkingje publike. Me një fjalë, t’i mbajmë premtimet elektorale.

Ndalohet shitja e qymyrit, mirëpo qytetarët që kanë planifikuar ta përdorin veçse janë furnizuar me qymyr për gjithë sezonin e dimrit, kështu që kjo masë nuk çon peshë për sivjet. Ndoshta për vitin tjetër. Dhe, për këtë duhet të mendohet se si ata qytetarë të furnizohen me ngrohje. Pra, rrjeti i kogjenerimit duhet t’i përfshijë të gjitha lagjet, në mënyrë që ta ndalim përdorimin e qymyrit për ngrohje.

Flitet për mungesën e hapësirave të gjelbra si pasojë e ndërtimeve pa leje. E vërteta është se edhe ato ndërtime me leje nuk kanë lënë hapësirë të kënaqshme për parqe dhe gjelbërim. Nëse e sheh

Prishtinën nga njëra nga kodrat e saj, qyteti i ngjanë më shumë një greminë post-apokaliptike, sesa një qyteti. Gjithçka gri, beton, asfalt e pluhur.

Për herë të parë jemi renditur në vend të parë, ose në krye të listës, bashkë me qytete si ato të Indisë, të Kinës e tjera... Të gjitha këto qytete janë super të mëdha dhe të mbipopulluara me miliona banorë, janë qytete industriale ku ndotja ndodh krahas zhvillimit ekonomik. Po, Prishtina çfarë kërkon në atë listë? Komplet për fajin e neglizhencës njerëzore?

Në fund, meqenëse nga kjo gjendje prekemi të gjithë, sidomos më të çmuarit tanë, siç janë fëmijët, pleqtë, gratë shtatzëna e të tjerë, shpresoj në diskutim të sinqertë nga të gjithë dhe të dalim me një rezolutë, në të cilën jepen ide se si të zgjidhet problemi. Nëse arrijmë ta tejkalojmë këtë gjendje, falënderim të posaçëm duhet t'i bëjmë Ambasadës Amerikane, shoqërisë civile, qytetarëve, gazetarëve, të cilët po e ngrenë vetëdijen dhe po i mobilizojnë të gjithë për këtë katastrofë mjedisore që na ka kapluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën. Nga Lista serbe, nëse ka të interesuar të flasin? S'ka të lajmëruar.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Nxjerrja e një rezolute, e cila do të ndikonte në ndryshimin e gjendjes, sa i përket ndotjes së ambientit, është më se e domosdoshme, edhe pse tani momentalisht ne gjendemi në gjysmën e dimrit, kur nuk mund të ndërmarrim hapa konkretë, të menjëhershëm, për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Këtë e them për shkak se vite të tëra në këtë sezon gjithmonë ka pasur ndotje të ajrit, gjithmonë ka pasur probleme sa u përket edhe atyre që janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së ambientit, siç u përmend KEK-u, pastaj shfrytëzimi i lëndëve djegëse që krijojnë ndotjen, madje automjetet po ashtu, sidomos edhe cilësia e derivateve e cila nuk është në shkallën që duhet në Kosovë.

Krejt këto kanë bërë që ta kemi një alarmim, sidomos në këtë periudhë, por konsideroj se kjo do të mund të krijonte mundësi që në afatin sa më të shpejtë të ndërmerren masa, të cilat nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe nëpërmjet krijimit të mundësive, nëpërmjet inspektoratit dhe ndoshta edhe trupave tjera shtesë, të cilët do të fillonin të bënin një kontroll më të madh në të gjitha këto kapacitete të krijimit të defekteve që i kemi, sidomos në ndotjen e ambientit.

Një element që do të duhej të jetë prioritet, edhe i Qeverisë, edhe i organizatave të ndryshme që merren me ambientin, është shfrytëzimi i hapësirave për gjelbërim dhe këtë do të duhej bërë në masën sa më të madhe në Prishtinë, sepse mbipopullimi që ka ndodhur në kryeqytetin e Kosovës

ka bërë që të gjithë t'i shikojnë mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve pa ndonjë kontroll të mjaftueshëm, e që në të vërtetë ka ndikuar në ndotjen e ambientit.

Tash e tutje, përveç kësaj, do të duhej që të bëhej një hulumtim më i madh i mundësive të investimeve që krijojnë energjinë alternative, që do ta mundësonte një efikasitet më të madh të ruajtjes së ambientit dhe, po ashtu, unë sot e kam vërejtur edhe një gjendje në kryeqytet, e cila vërtet është çuditshme, sepse qendra e qytetit është ndaluar për automjetet që hyjnë në kryeqytet, por periferia, e sidomos lagjet përreth, ku nuk mund të vendosen policë në çdo çosh të rrugëve për t'i ndaluar automjetet, ka krijuar kaos në lëvizjen e automjeteve.

Prandaj, kjo është një strategji afatshkurtër, e cila nuk prodhon shumë efekt, por duhen mekanizma të tërë që të vihen në dispozicion, në mënyrë që të zbatohet ligji dhe të krijohet një ambient më i mirë në Kosovë. Kjo vlen për një strategji të ardhshme, që i përket Qeverisë së Kosovës dhe mekanizmave tjerë institucionalë në Kosovë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi nga Grupi Parlamentar “Nisma”.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Seanca e sotme, që është thirrur për të diskutuar për ndotjen e ambientit, sidomos në rrethinën e Prishtinës me komuna, dua të besoj se ka për qëllim më shumë ta shpërfaqë unitetin e të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvend se cilat masa duhet ndërmarrë për të dalë nga kjo situatë, sesa për të treguar se cilat janë shkaqet që kanë sjellë deri te kjo, sepse nuk besoj se ka deputet këtu apo ministër andej në Kabinetin qeveritar, që nuk e di se cilat janë shkaqet. Dhe besoj se e dimë të gjithë se në këtë gjendje kemi ardhur për faktin se i kemi neglizhuar për vite të tëra shenjat, nga të cilat në vazhdimësi e kemi parë se gjendja do të shkojë në përkeqësim të këtij niveli siç është sot.

Natyrisht që të gjithë e dimë që KEK-u, përkatësisht Termocentrali B, janë një nga shkaktarët kryesorë të ndotjes së ambientit, por të gjithëve na ka rënë nganjëherë të shkojmë në Obiliq dhe e kemi parë në çfarë gjendjeje ka jetuar ajo popullatë dhe përderisa nuk e kishim në Prishtinë, nuk shqetësoheshim shumë.

Të gjithë e dimë që numri i madh i veturave dhe cilësia shumë e dobët e derivateve është shkaktari tjetër, por kjo nuk na bënë të zgjidhim problemin nga momenti kur i numërojmë këtu të gjitha këto arsye, shkaqe, të cilat kanë ndikuar që ndotja e ambientit të jetë në këto përmasa.

Prandaj, duke pasur parasysh faktin që ndotja e ambientit kushton, të nderuar kolegë, duhet ta dimë, sidomos në vendet e Bashkimit Evropian nuk është se atje me vullnet dhe me ndërgjegjeje ka ndodhur ruajtja e ambientit.

Të gjithë e dimë që ka taksa të larta për të gjithë ata që ushtrojnë veprimtari biznesore, qofshin të mëdha, koncerne, qofshin të vogla apo qofshin të mesme.

Unë mendoj që për të arritur ndër vite, në vitet që vijnë, që do të zbresim nivelin e ndotjes së ambientit së pari duhet të dimë a jemi të gjithë dakord që çështjen e ambientit, pa marrë parasysh dallimet partiake, ideologjike, politike, ta shndërrojmë në prioritet numër një të shtetit, apo, thënë ndryshe, a jemi të gatshëm që të gjithë së bashku ndotjen edhe ndotësit e ambientit t'i shpallim armikun numër një të shtetit dhe të shoqërisë, apo nuk jemi dhe konform kësaj pastaj duhet të merren edhe masa.

Nëse në këtë seancë sot të gjithë i numërojmë shkaqet dhe e kritikojmë njëri-tjetrin për pengesën e marrjes së masave të nevojshme, në fund të mbrëmjes do ta miratojmë një rezolutë, të gjithë do të shkojmë nëpër shtëpitë tona, por ndotësit do të vazhdojnë ta kryejnë aktivitetin e tyre të ndotjes së ambientit dhe nuk do të kemi zgjidhje të problemit, do të mund pas një muajsh sërish dikujt t'i bie ndërmend të thërret edhe një seancë dhe kështu do të sillemi në atë rrethin vicioz, dhe do të sillemi në rrethin e mbyllur.

Mendoj që për të dalë nga kjo së pari propozimeve të kolegut nga "Vetëvendosja", të cilat sigurisht që shumicën e tyre me dy duar do t'i mbështesja, të zotit Sejdiu, t'ia shtoj pikë e parë apo numër një, prioritet çështja e mbrojtjes së ambientit apo e reduktimit të ndotjes së ambientit, prioritet nacional dhe konform kësaj të ndërtohet një strategji nacionale, me politika të caktuara, të cilat pastaj nuk do të mund askush t'i shmangë, pa marrë parasysh kush vjen në qeveri, sepse a po e shihni, kemi diçka, megjithatë, që nuk mund ta prodhojmë dhe ta shkarkojmë vetëm te njerëzit e pafuqishëm. Edhe njerëzit e fuqishëm do të vazhdojnë ta thithin këtë ajër, edhe njerëzit e fuqishëm, qofshin ata financiarisht a politikisht, do të vazhdojnë të jetojnë në këtë ambient të ndotur me përmasa alarmante.

Prandaj, unë në vend të numërimit të arsyeve, shkaqeve, pse kemi ardhur në këtë gjendje dhe në vend të numërimit dhe të rreshtimit të hapave që duhet të ndërmerren, sepse si folës i fundit, në emër të grupeve parlamentare nuk besoj që kam çka t'u shtoj shumë propozimeve që u thanë këtu, përpos asaj të parës, ejani së bashku të gjithë reduktimin e ndotjes dhe ndotësve të ambientit ta shndërrojmë në top prioritet të shtetit të Kosovës, të Republikës së Kosovës.

Nëse ne arrijmë të merremi vesh për këtë dhe konform kësaj t'i caktojmë politikat dhe të jemi të gatshëm ta paguajmë, mbi të gjitha, jemi të gatshëm të paguajmë, mbrojtja e ambientit kushton gjithmonë, diku kushton me ndërhyrje, siç u tha nga buxheti i Kosovës për të ndihmuar familjet,

të cilat gjatë sezonit të dimrit nuk kanë mundësi të blejnë derivate, të cilat nuk e ndotin ambientin, diku duke ndërprerë apo duke vendosur taksa ndaj bizneseve, të cilat kontribuojnë jashtëzakonisht shumë në ndotjen e ambientit.

Pastaj në çdo vend të Bashkimit Evropian kushton edhe mbajtja e veturës private, le të caktohet edhe një taks ambientale shtesë, e cila pastaj do të shkonte në funksion të përmirësimit të kësaj gjendjeje. Nëse arrijmë të gjithë së bashku, grupet parlamentare dhe deputetët, të marrim një vendim të përbashkët, qoftë rezolutë, qoftë përfundim, qoftë vendim, sido që ta quajmë, por ajo të shndërrohet mbi të gjitha në politikë, në strategji nacionale, jam i sigurt që menjëherë, nëse jo këtë vit, vitin e ardhshëm do të fillojmë të ndjejmë reduktimin e ndotjes së ambientit.

Përndryshe, masa emergjente të cilat janë marrë dhe mund të merren këto ditë më shumë i ngjajnë përpjekjes njeriut që është i zhytur në ujë, por nga frika e fundosjes kapet edhe prapa kashtës, kapet për kashtë, duke shpresuar se do t'i ndihmojë për të përballuar situatën në të cilën gjendet.

Mendoj që kjo çështje as nuk ka ardhur për një ditë, as për një vit, prandaj as nuk do të mund të eliminohet e as të zbutet as për një ditë, as për një vit.

Ndër vite kemi kontribuar për të ardhur në këtë gjendje, na duhet që ndër vite të kontribuojmë për të kthyer së paku në gjendjen të cilën kemi qenë para 10 vjetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni të ndaj me ju disa fjalë rreth arsyes për të cilën jemi mbledhur sot këtu.

Grupi Parlamentar "6+" me vëmendje e ka përcjellë situatën këto ditët e fundit si dhe dua të ndaj me ju shqetësimet për gjendjen e rritjes së nivelit të ndotjes së ajrit.

Kjo gjendje e krijuar këto ditë është një alarm i fundit për të gjithë ne, duke filluar nga ne, deputetët, Qeveria, Ministria e Ambientit, shoqëria civile dhe institucionet e tjera relevante.

Është një alarm i fundit, alarm ky i cili mund të ketë pasoja në të ardhmen e që besa do të kushtojë me jetë të njerëzve.

Prandaj, mendoj që është momenti i fundit që të tregohemi racionalë e të ndërmarrim hapa konkretë që ta kalojmë këtë situatë tepër shqetësuese për ne, fëmijët tanë e të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

KEK-u, përdorimi i thëngjillit të papërpunuar, derivatet jociësore, vetura të shumta, janë disa nga faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit. Por, pa dashur të fajësojmë ndotësit kryesorë dhe të vëmë gisht tek ata të cilët janë përgjegjës për krijimin e kësaj situatë alarmante, mendoj se krejt kjo situatë, kjo gjendje të cilën po ballafaqohemi sot, është si rezultat i një neglizhence dhe mohim i realitetit të ndotjes së ambientit dhe mosvendosja e problemit të nivelit të rritjes së ndotjes së ambientit si prioritet i institucioneve tona si dhe duke u fokusuar në probleme të tjera, me të cilën po ballafaqohemi.

Problemin e ndotjes së ambientit e kemi lënë anash edhe si institucione, por edhe si shoqëri në tërësi.

Ne sot si deputetë dhe përfaqësues të atyre që na kanë mundësuar të jemi këtu dhe na kanë besuar me votën e tyre, duhet të dalim me ndonjë zgjidhje sa më të shpejtë që të tejkalojmë këtë gjendje tepër serioze dhe të dëmshme për shëndetin e qytetarëve tanë, e më së shumti të fëmijëve tanë.

Por besoj që na duhet edhe një përkushtim i pazezervë i të gjithë neve, e sidomos i institucioneve direkte që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit.

Nevojitet një bashkëdyzim i të gjithë aktorëve relevantë që njëherë e përgjithmonë të dalim në krye të problemit të ndotjes së ambientit.

Mendoj që është momenti i fundit që të gjitha ligjet, strategjitë që kanë të bëjnë në mbrojtjen e ambientit të fillojnë të implementohen, e jo të mbesin vetëm në letër.

Të fillojë një herë e përgjithmonë shqiptimi i gjobave për ndotësit e ajrit.

Gjithashtu të gjendet mënyra për zëvendësimin e përdorimit të thëngjillit të papërpunuar si dhe filtrave të KEK-ut.

Në fund shpresojmë se nga ky debat parlamentar do të dalim me një rezolutë apo rekomandime, të cilat do të gjejnë implementim të menjëhershëm që do të përmirësojnë cilësinë e ajrit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Qeverisë, zonja Reshitaj, e dëshironi fjalën në emër të Qeverisë?

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Fillimisht ju falënderoj për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme që njëherësh dëshmon fillimin e një vetëdijesimi të skenës politike për mbrojtjen e mjedisit, respektivisht mbrojtjen e ajrit në Republikën e Kosovës.

Spektori i ajrit dhe përmirësimi i cilësisë së tij është një ndër prioritetet kryesore që kam si ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Pavarësisht se përmirësimi i cilësisë së ajrit është një sfidë e madhe rajonale e globale, unë nuk kam hezitur që të merrem direkt me këtë problematikë, që të gjenden shkaktarët dhe të marrjes së masave për të përmirësuar atë.

Në muajin e parë të mandatit tim Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka rihartuar planin e aktiviteteve për përmirësim të cilësisë së ajrit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë.

Varësisht prej gjendjes së ajrit jo vetëm në regjionin e Prishtinës, por si tërësi në nivel vendi Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shtuar gatishmërinë për marrjen e masave për përmirësimin, veçanërisht në këtë sezon ku shkarkimet e ndotjes janë më të larta.

Është krijuar grupi që ka bërë identifikimin e më shumë se 100 pika ndotëse që shfrytëzojnë thëngjillin, vajrat e përdorura apo lëndët e tjera ndotëse jomiqësore me mjedisin.

Kemi kërkuar nga komuna të hartojnë planet afatshkurtra të veprimit, ku duhet të përfshihen masat lidhur me qarkullimin e mjeteve motorike, ngrohje në amvisëri, biznese dhe në shërbime të tjera, me qëllim të zvogëlimit të shkallës së ndotjes së ajrit.

Me kërkesën time Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur për themelimin e një Task-force ndërministrorë që do të angazhohen në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Gjithashtu kam kërkuar nga ministrinë e linjës, të cilat kanë përgjegjësi brenda kompetencave të tyre, që të zbatojnë udhëzimet administrative në fuqi që kanë të bëjnë me kontrollimin, gjegjësisht me uljen e nivelit të ndotjes së ajrit.

Në koordinim me Komunën e Prishtinës dhe në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme kemi ndërmarrë planin e veprimit afatshkurtër, i cili sot ka nisur së zbatuari, ku përfshinë këto veprime:

Ndalimi i qarkullimit të automjeteve në zonën e parë të qytetit nga ora 6:00 deri në orën 22:00, transporti publik falas gjatë gjithë ditës për të gjithë qytetarët e Prishtinës, e cila është subvencionuar nga Ministria e Mjedisit, gjegjësisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, kemi fuqizuar Inspektoratin e Qendrës, Inspektoratin lokal dhe Policinë e Kosovës.

Ndalimi i përkohshëm i shitjes dhe përdorimit të thëngjillit në kryeqytet, të gjitha masa afatshkurtra emergjente, të cilat më shumë ndikojnë në ndërgjegjësim, vetëdijësim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht në këtë rast të Komunës së Prishtinës.

Si ministri jemi në përgatitje të instalimit të softuerit qendror për mbledhjen e të dhënave të cilësisë së ajrit nga 12 stacionet monitoruese dhe paraqitja e tyre në kohë reale përmes vetë aplikacioneve në smartfonët e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Do të përkrahen projektet dhe aktivitet që kanë për qëllim promovimin e energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë, si dhe rritjen e caqeve për energjinë solare të erës.

Më lejoni në pika të shkurtra të paraqes para jush planin e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe gjendjes së mjedisit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Tashmë ju e dini që ndarja e 34 milionë eurove nga Bashkimi Evropian për ndërrimin e elektro-filtrave për termocentralin Kosova B do të bëhet gjatë këtij viti.

Ne e dimë se njëri nga ndotësit e mëdhenj të nivelit të ajrit janë edhe termocentralet, gjegjësisht termocentrali “Kosova B”, i cili ka filtra të pandërruar që nga viti 1985.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka një projekt në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, projekti komplet, kostoja totale është 74 milionë euro, kurse 34 milionë euro janë nga Bashkimi Evropian.

Gjithashtu në masat afatmesme kemi kërkuar dhe i rekomanduar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ministrive të tjera që të zgjerojnë rrjetin e kogjenerimit në qytetin e Prishtinës dhe në qendrat e tjera të Kosovës ku ajo është e mundur. Faktikisht ky projekt kapital besoj që këtë vit do të realizohet.

Gjithashtu kemi kërkuar nga komuna që të riorganizohet transporti publik dhe të promovohet transporti publik me qendrat kryesore të Kosovës dhe në ato zona ku ndotja e ajrit është më e lartë.

Gjithashtu të finalizojnë komunat planet zhvillimore dhe harta zonale të komunave të Kosovës në përputhje me zonat dhe aglomeratet e caktuara.

Të zbatohet ligji për performansën e energjisë në ndërtesa, si masë për kursimin e energjisë.

Të themelohet fondi për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të shfrytëzimit të instrumenteve ekonomike për realizimin e projekteve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Pra, kërkojmë që të formohet eko-fondi, i cili do ta ndihmojë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të realizuar projekte të shumta, të cilat do të rrisin edhe hapësirat e gjelbra dhe do të japin mundësi për gjetjen e alternativave të tjera për ngrohje për qytetarët. Në këtë mënyrë për të na dhënë mundësi që të ndërpritet përdorimi i thëngjillit në ekonomitë familjare dhe në biznese të vogla, sa më shpejt që është e mundur.

Komunat të hartojnë planet afatshkurtra të veprimit, ku duhet të përfshijnë masat lidhur me qarkullimin e mjeteve motorike, ngrohjen në amvisëri, biznese dhe shërbime të tjera, me qëllim të zvogëlimit të shkallës së ndotjes së ajrit.

Gjithashtu të rishikohen politikat e përgjithshme mjedisore.

Të gjitha dokumentet strategjike në nivel qendror dhe lokal t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

Të ngrihen kapacitetet teknike dhe humane në menaxhimin e hapësirave të gjelbra publike dhe në parqet kombëtare.

Të rritet niveli i vetëdijesimit dhe edukimit mjedisor përmes hartimit të programeve të veçanta.

Nga masat afatgjata, të cilat i ka parashikuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë:

Të zbatohen masat e strategjisë për cilësinë e ajrit. Kjo strategji është hartuar dhe aprovuar nga Kuvendi tek në vitin 2013.

Të ruhen dhe mirëmbahen sipërfaqet e gjelbra në zonat urbane dhe ku është e mundur të shtohen ato si dhe të përfshihen në kuadër të hartave zonale.

Të ngrihet niveli i planifikimit urban në komuna dhe në nivel shteti me adresim në ruajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, tokave bujqësore dhe pyjeve.

Të përkrahen projektet dhe aktivitetet që kanë qëllim promovimin e energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë dhe të rriten caqet për energjinë solare dhe të erës.

Të lehtësohet procedurat e ndërtimit të kapacitete të reja energjetike me standarde dhe teknologji të avancuar, me qëllim të mbylljes së kapaciteteve të vjetra.

Në këtë rast, me ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” dhe modifikimin e termocentralit “Kosova B” si dhe mbylljen e termocentralit “Kosova A”.

Mbështetja financiare në realizimin e projekteve mjedisore që dalin nga dokumentet strategjike në sektorin e mjedisit, strategjia e mbrojtjes së mjedisit, strategjia e mbeturinave, strategjia e biodiversitetit, strategjia e ndryshimeve klimatike dhe planeve të veprimit që dalin nga ato. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë. Zonja Baftiu është në radhë, a është këtu Besa Baftiu? Jo! Shqipe Pantina është në radhë, nga “Vetëvendosja”, nëse doni listë me emra, këtu jam.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Problemi me ndotjen e ajrit në Prishtinë, por edhe në disa qytete të tjera të Kosovës, u përmend këtu Kastrioti dhe Fushë-Kosova, po hiq në gjendje më të mirë nuk është as Drenasi.

Nuk është problem i ri. Madje sipas raporteve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit ka një përmirësim të cilësisë së ajrit në krahasim, ta zëmë me vitin 2015, kur në të njëjtën periudhë kohore numri i ditëve, në të cilat ndotja e ajrit ka qenë shumë më e lartë, në përmasa çfarë prezantohet, ka qenë më i madh se sa në vitin 2016 dhe në vitin 2017.

Pra agjencia ka prezantuar përveç gjetjeve, edhe disa konkluzione dhe rekomandime në raportin përmbledhës të vitit të kaluar.

Dhe, t’ju them të drejtën, më erdhi mirë kur pash se raporti përmbante edhe rekomandime, përveç numrave që nuk kanë ndonjë kuptim për ata që nuk janë njohës të kësaj fushe.

Por, kur i lexon konkluzionet, rekomandimet, në fakt, duket pak si hajgare kjo punë.

Ja disa nga konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor.

Thuhet: “Nga analiza e rezultateve të lartpërshkruara, do të thotë rezultatet që matin ndotjen e ajrit, mund të përfundohet se përqendrimet e larta të PM 10 dhe PM 2.5 bëjnë që cilësia e ajrit në Prishtinë të jetë jo e kënaqshme.

Nën dy, kësaj gjendje i kontribuojnë shkarkimet e ndotësve nga burimet, siç janë industria, transporti dhe konsumimi i lëndëve të ngurta djegëse që përdoren për ngrohje, si dhe kushtet e pafavorshme për dispersionin e ndotjes që emetohet në ajër.

Gjatë këtyre muajve, për të cilat jemi duke shqyrtuar gjendjen, e bëhet fjalë pra për muajt nëntor, dhjetor dhe janar të cilësisë së ajrit në Prishtinë, ka mbretëruar një mot me mjegull të dendur, dukshmëri me 30 m dhe lagështi të ajrit mbi 85% si dhe mungesë e erës dhe kur këtyre kushteve u shtohen edhe shkarkimet e ndotësve në ajër, atëherë vije deri të krijimi i gjendjes së smogut, i thirrur smogu i Londrës që është karakteristik për paraqitjen e tij gjatë sezonit dimëror, pra nëntor, dhjetor, janar dhe i cili shkakton eksitim të bronkeve dhe kollitje. Në këto raste rekomandohet që kategoria e ndjeshme, do të thotë personat me probleme nga sëmundjet e organeve respiratorë, të mos qëndrojnë gjatë në ambiente të tilla”.

Këtu përfundon citati nga konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë.

Pra, këto janë konkluzionet e një ministrie, e cila ka një ministre, ka gjashtë zëvendësministra dhe në Kabinetin e ministres ka shtatë këshilltarë politikë dhe dy asistentë.

Në kuadër të kësaj ministrie po ashtu veprojnë Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat nuk e dimë, në fakt, se sa staf kanë.

Pra, me gjithë këtë numër të madh të njerëzve të angazhuar, si është e mundur që nuk kemi as edhe një analizë me shkaktarët e kësaj gjendjeje. Pasojat po i ndiejmë vetë, nuk ka nevojë për ndonjë analizë në këtë punë. Mjafton të dalësh në qytet dhe e ndjen sa po të marrësh frymë ndotjen që ekziston.

Duke ditur se ky është një problem i përsëritur çdo vit, pse nuk është diskutuar kjo gjendje qysh në shtator, ta zëmë, dhe pse nuk është propozuar asnjë masë konkrete që do ta parandalonte një situatë të tillë. Edhe vendimet e nxjerra dje nga Ministria e Mjedisit dhe Komuna e Prishtinës janë vendime të nxjerra at hoc, më shumë si reagim i presionit të publikut dhe mediave, por jo të bazuara në një analizë të gjendjes, ku vihet në përfundim se kush janë shkaktarët e vërtetë dhe cili do të ishte efekti qoftë edhe afatshkurtër që do kishin këto masa të ndërmarra.

Për shembull, a e dimë ne sot se në çfarë përqindjeje ndikojnë në ndotjen e ajrit qarkullimi i makinave në Prishtinë? A e zgjidh njëmend problemin ndalimi i qarkullimit të tyre, qoftë edhe për disa ditë?

Cilat janë masat afatgjata që duhet ndërmarrë edhe në lidhje, ta zëmë, me qarkullimin e makinave? A duhet të vendosim standarde për gjendjen e makinave që dalin në qarkullim?

Kosova është shndërruar në deponi, ku hedhin makinat që dalin nga përdorimi në Evropë dhe Qeveria nuk e ka pasur hallin aspak të ndotjes së ajrit, por si të sigurojë të hyra nga importimi i këtyre makinave.

Propozimi im për Qeverinë, duke ua shtuar propozimeve që i dha deputeti Sejdiu, për një sanim të menjëhershëm të gjendjes do të ishte si në vijim:

Të shkarkohen menjëherë 50 nga 70 zëvendësministrat e emëruar. Kjo do të thoshte edhe 50 makina më pak që do të qarkullonin në Prishtinë, e me paratë që tash janë paraparë për pagat e tyre dhe të asistentëve e shoferëve të tyre, si dhe karburantit që këta do të shpenzonin, ta zëmë, të mbilleshin drurë ose të bliheshin drunj të e mençur, për të cilët foli deputeti Sejdiu më herët.

Po ashtu, mund të mbilleshin drurë, të cilët qëndrojnë të gjelbër edhe gjatë kohës së dimrit.

E kur jemi te mbjellja e drurëve, në vitin 2010 organizata “Kosova United States Alumni” kishte bërë një propozim që secili qytetar i këtij vendi të mbillte nga një dru, të cilin do t’ia dedikonte qoftë vetes, qoftë anëtarëve të familjes. Pra, në këtë mënyrë do të mbilleshin rreth 2 milionë drurë, e të cilët me siguri do të prodhonin oksigjen më shumë, natyrisht gjatë verës do të kishte mundësi kreative që të gjendeshin bimë që prodhojnë oksigjen edhe gjatë dimrit.

Në një afat më të gjatë ministria dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të kryejnë punën e tyre siç duhet. Njerëzit që punojnë në këto ministri kanë zhvilluar dhjetëra, e ndoshta qindra trajnime e vizita studimore jashtë vendit. Besoj se diçka kanë mësuar nga këto vizita, edhe pse në masë të madhe kanë qenë vizita turistike. Është koha që krejt kjo përvojë e tyre, marrë nga trajnimet dhe vizitat studimore, ta përdorin për të bërë një analizë të detajuar se cilat substanca të rrezikshme e ndotin ajrin, kush e shkakton dhe në çfarë përqindje të pjesëmarrjes këtë ndotje dhe çfarë masa duhet ndërmarrë, si ato afatshkurtra apo edhe ato afatmesme, në mënyrë që kur të vijë nëntori apo dhjetori i vitit tjetër, të mos kemi të njëjtin diskutim.

E, kjo nuk duhet të vlejë vetëm për ndotjen e ajrit, po hiq në gjendje më të mirë nuk janë as lumenjtë në Kosovë. Pra, ne shumë shpejt, një diskutim të tillë do ta kemi edhe për ndotjen e ujit, ndonëse ne nuk kemi matës, të cilët do të na alarmonin siç po alarmohet për ndotjen e ajrit. Por, Ministria e Mjedisit duhet të bëjë edhe një plan se si ta parandalojë ndotjen dhe shkatërrimin e

lumenjve në Kosovë, sepse shumë shpejt do të mbesim edhe pa ujë të pastër, siç po vuajmë për ajrin e pastër në Prishtinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministrja e Ambientit, zonja Reshitaj e ka fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, e nderuar deputete!

Atëherë, ashtu siç ju thashë, unë kam marrë këtë përgjegjësi në një periudhë kur vetëm kemi hyrë në një fazë ku kushtet meteorologjike kanë qenë të disfavorshme dhe niveli i ndotjes së ajrit ka filluar. Dhe, për të bërë plane afatshkurtra reale ka qenë e pamundur. Prandaj, ne jemi mobilizuar si ministri të marrim aktivitet, gjegjësisht plane afatshkurtra emergjente, sepse nuk ka mundësi të trajtohet niveli i ndotjes së ajrit në një periudhë një muaj, dy ose tre muaj.

Prandaj, më shumë kemi punuar në atë që i kemi vendosur në një tavolinë të përbashkët të gjithë aktorët përgjegjës ndërministrorë, por edhe institucionalë, duke përfshirë edhe komunat, që të marrin përgjegjësitë, sepse me ligjet e Republikës së Kosovës kanë përgjegjësi për të ndikuar në nivelin e ndotjes së ajrit dhe atë kam ulur në një tryezë të përbashkët për herë të parë, prej se është formuar shteti i Republikës së Kosovës, të gjithë aktorët përgjegjës dhe kam kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës të fuqizojë Udhëzimin administrativ për shkarkimin e gazrave nga automjetet, sepse ekziston Udhëzim administrativ, i cili është i bazuar në ligj nga Ministria e Infrastrukturës.

Gjithashtu, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kam kërkuar që të rritet kontrolli i cilësisë së derivateve të naftës që importohen dhe shiten në Kosovë. Si dhe nga Ministria e Arsimit kam kërkuar që të marrë vendim për ndërprerjen e përdorimit të thëngjillit dhe lëndëve të tjera ndotëse, djegëse, të rrezikshme, por edhe që rrisin nivelin e ndotjes së ajrit në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, nga Ministri i Shëndetësisë kam kërkuar që të përkrahë Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik që të krijojë një sistem efikas të informimit të qytetarëve për pasojat e ndotjes së ajrit, e sidomos nga përdorimi i thëngjillit në veçanti. Prandaj, kam kërkuar nga ekspertët e ministrisë, si dhe kam krijuar grupin punues nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për të shikuar dhënien e informatave të sakta profesionale për nivelin e ndotjes së ajrit, kontrollimin dhe përcjelljen e informatave. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pesë stacione dhe nga këto, po flas vetëm në regjionin e Prishtinës, aty ku e kemi për momentin nivelin e ndotjes së ajrit më të lartë, dhe nga këto pesë stacione merren informacionet. Kam kërkuar që softueri, i cili vetëm ka qenë në plan të ndërtohet-krijohet, kam kërkuar të përshpejtohen procedurat dhe qytetarët ta kenë mundësinë që në smartfonët e tyre në kohë reale, në çdo sekondë, në çdo minutë ta përcjellin nivelin e rritjes së ndotjes së ajrit.

Kjo tregon transparencë dhe mundësi që edhe shoqëria civile, edhe organizatat e tjera të japin kontributin e tyre. Ju i dëgjuat masat afatmesme dhe afatgjata, mirëpo ajo që është më e rëndësishme për ne edhe si shoqëri, por edhe si institucione që ne të mësohemi të jemi

profesional. Ne duhet të dimë saktë, të gjithë ne po i dimë cilët janë ndotësit më të mëdhenj: termocentralet, makinat, transporti, makinat e vjetra, amvisëria, përdorimi i lëndëve djegëse, mirëpo ne qytetarëve të Republikës së Kosovës ua kemi borxh që t'i informojmë saktë dhe të dalim me konkluzione profesionale shkencore se cilët janë ndotësit më të mëdhenj dhe në cilat regjione të Republikës së Kosovës janë ndotësit më të mëdhenj, të cilët e rrisin nivelin e ndotjes së ajrit. Tek atëherë, pasi të zbulojmë saktë etiologjinë, ne mund të merremi me pasojat dhe të bëjmë plane, strategji të caktuara se si ta tejkalojmë situatën.

Thjesht, ne bazuar në përgjegjësinë institucionale dhe ligjet, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përgatitur planin e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe gjendjen e mjedisit. Ne kemi kornizën ligjore, kemi kornizën programore dhe institucionale, na duhet zbatueshmëri, transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë fillimisht dua të them dhe pajtohem se problemi i ndotjes është problem teknik dhe jo politik dhe do të mundohem ta trajtoj si të tillë, pa e lëshuar veten në detaje shumë, sepse ky diskutim në radhë të parë do të duhej t'u takonte ekspertëve të fushës, e që në këtë sallë të Parlamentit besoj që jemi shumë pak të tillë.

E dyta, problemi i ndotjes së ajrit është i shtresuar, pra i mbledhur nëpër vite të tëra, me siguri nga vitet e industrializimit të Kosovës e Prishtinës, pra nga vitet e '80-ta e këndeje, por njëkohësisht u takon vendimmarrësve të sotëm të marrin hisen e përgjegjësisë për të bërë zgjidhje, pavarësisht kohës kur ky problem buron. Dhe zgjidhja e problemit të tillë unë besoj nis me diagnostikimin e burimeve të ndotjes. Pra, po e kuptojmë që KEK-u, thëngjilli dhe veturat janë ndotës, por duhet të kuptojmë saktësisht përqindjes e pjesëmarrjes të secilit burim dhe çfarë ndodh me reduktimin e njërës prej tyre burimeve. Unë, thënë të drejtën, deri më tash kam marrë qëndrime kontradiktore brenda ministrave të Qeverisë. Në një paraqitje publike ministrja e Mjedisit thoshte se nuk e di saktësisht përqindjen e pjesëmarrjes së burimeve, por ministri i Zhvillimit Ekonomik na e dha një përqindje të ndotësve. Pra, është mirë që ju dy mes vete të flisni fillimisht dhe pastaj si Qeveri të keni një qëndrim dhe të na tregoni saktë kush, sa për qind e ndot. Po edhe të mos dihet nuk është keq, nuk është marre. Pra, në qoftë se nuk e dini, është mirë të nisim një studim, ta bëjmë matjen e saktë të burimit të ndotësve dhe pjesëmarrjen e tyre.

E dyta, ne duhet të bëjmë një hartë të ndotjes në Prishtinë, sepse unë nuk besoj që Arbëria është e ndotur njëjtë sikur Taslixhja. Njëra ka shumë afër KEK-un, tjetra ka shumë më afër Gërminë dhe qytetarët e Prishtinës duhet ta kenë të qartë hartën e ndotjes. Tash janë dy qasje që ne duhet t'i

ndërmarrin tani: e para, ndërlidhet me sanimin e pasojave, e dyta ndërlidhet me targetimin afatgjatë. Po besoj që diskutimin duhet ta bëjmë në këtë Parlament fillimisht me pasojat imediate. Dhe, pasojat e tanipërtanishme kërkojnë edhe masa të menjëhershme, sepse kur është ajri i rrezikshëm për jetë, është cilësim bukur i lartë dhe i frikshëm, dhe kur Prishtina rangohet e para në botë për nga ndotja e ajrit, ne duhet të marrim masa radikale dhe masë radikale është kufizimi i lëvizjes së lirë.

Tash, ministri i Arsimit shkoi, por unë i bëj thirrje publike ministrit të Arsimit, edhe kryeministrit që në ditët e rënda, kur Prishtina ka ambient të rrezikshëm për jetë së paku, fëmijët të mos i ekspozojmë nëpër shkolla, ta ndërpresim mësimin. Pra, si akt të parë në javët e tilla të ndërpresin mësimin. Po besoj që është më e lehtë që gjatë pranverës së vonshme ose verës së hershme të bëjmë kompensimin e mësimin të humbur në këtë kohë.

E dyta, e lus Ministrinë e Shëndetësisë që në ditë si këto të nisë shpërndarjen e maskave falas për qytetarët nëpër rrugët dhe sheshet e Prishtinës, le t'i shpërndajnë. Nuk ka për të blerë maska sot në Prishtinë, por le të ketë një shpërndarje falas dhe një vetëdijësim për qytetarët, t'i ruajmë qytetarët. Por, në qoftë se nuk mundemi me politika si këto, atëherë themi që duhet të ndërpresim edhe lëvizjen e sektorit publik dhe privat. Të marrim një masë njëjavore të pushimit nacional, nuk është se humbim kush e di sa, sidomos në kohë të ajrit të ndotur, sepse kjo periudhë nuk zgjat gjatë gjithë vitit.

Tash, si masë imediate është ndërprerja e qarkullimit të automjeteve. Edhe unë, ndonëse e shoh si lëvizje të mirë, po shpreh rezerva me masën e tanishme, të sotshme, ku qarkullimi sanksionohet në një qendër të vetme. Nuk e di s a e dinë mirë Prishtinën vendimmarrësit në fjalë, po ju them që sot secila rrugicë anësore e Prishtinës ka ngarkesë shumëfish më të madhe se sa ditëve të tjera. Pra, unë e aprovoj masën e ndalesës së automjeteve, por them se kjo tash s'po bën efekt. Tash secili që e njeh mirë Prishtinën, e di se një qarkullim i lirë prej Arbërisë, Kodrës së Trimave, Taslixhes, Lagjes së Muhaxhirëve, Aktashit, Bregu i Diellit, e prapë në Emshir dhe në Arbëri, është po aq prodhues i ndotjes sa secilën ditë. Pra, ne nuk e kemi ndaluar fluksin e automjeteve në qoftë se kemi menduar këtë ta bëjmë. Por, besoj që ka masa më efikase të reduktimit të fluksit të automjeteve, qoftë nëpërmjet seleksionimit të targave të automjeteve, qoftë nëpërmjet ndërprerjes së pjesshme të vizitave nga jashtë.

Pra, edhe një herë, them që vendimi i ndalesës së automjeteve është i duhur, nuk po besoj që kjo e tanishme po kryen punë, sepse sinqerisht nuk po besoj që një automjet ose një fluks i madh i automjeteve në Arbëri prodhon ajër më pak të ndotur, i cili nuk e kalon hekurudhën për të dalë disa metra më poshtë në qendër. Ajri s'funktionon ashtu. Domethënë, ajri është rreth e rreth unazës së brendshme të Prishtinës.

Dhe, kur jemi te veturat besoj se ndotja e ajrit e ka shpërfaqur një defekt shumë serioz të sistemit kontrollues të veturave. E para, është evidente se kontrolli teknik i veturave bëhet në Prishtinë dhe Kosovë sa për sy e faqe. Pa asnjë matje të ndotjes së tyre. Pra, kontrollet teknike, e që janë monopol në Kosovë sot, i kapërcejnë veturat si rutinë, s'ka kurrfarë kontrolli. Në qoftë se sot ka shtet në Kosovë, kontrollet e tilla teknike do të mbaheshin përgjegjësit kryesorë për shkeljen flagrante të procedurave të kontrollit. Kjo është formë klasike e keqpërdorimit korruptiv, pra të fuqisë. Ndalen sot një veturë të thjeshtë në rrugë, një veturë që funksionon si tymtar, jo si veturë normale, shikojani dokumentet e kontrollit, do t'i ketë krejt në rregull, është shumë lehtë të bëhet ndërlihdja e një veture të tillë me një pikë kontrolluese të tillë dhe është shumë lehtë, madje propozoj që në rezolutë të futet edhe penalizimi i pikave të kontrollit që kanë lëshuar automjetet e tilla si në rregull kur s'janë.

Pra, të ketë ndjekje edhe financiare, dënim financiar, por edhe vepër penale. Dhe, si masë afatgjate, për t'iu kthyer pjesës së fundit të diskutimit, unë konsideroj se ndërprerja e shitjes së thëngjillit në fillim të zonës ka shumë më shumë kuptim se sa në fund të saj. Nuk besoj që sot dikush e blen thëngjillin në fund të dimrit, domethënë kushdo që është furnizuar me thëngjill, e ka kryer atë para vjeshtës dhe në qoftë se duam ta ndalojmë thëngjillin, duhet bërë në kohë, ose ta ndalojmë gjatë gjithë vitit për të pasur efekt imediat.

Në fund fare, ne duhet t'i kthehemi “elefantit të madh”, KEK-ut, ndotësit më të madh në vend, dhe duhet kthyer faktit se pa investime multimilionëshe në KEK, në fabrikën e filtrave dhe pa mbylljen e “Kosovës A” nuk do të ketë përmirësim substancial në Prishtinë, ndotësi më i madh “Kosova A” është veç 3 km larg Prishtinës.

Por, ditë si këto ndoshta do të duhej të shërbejnë edhe si sinjal për të gjithë ata po që po e kritikojnë mosrritjen e çmimit të energjisë elektrike, sepse ne disi po e paguajmë këtë energji të lirë elektrike, atë që është, sepse KEK-u po prodhon pa u brengosur për ambientin dhe po të ishte detyruar të brengosej për ambientin, do të duhej të bënte investime, e më pas këto investime do të reflektonin edhe në çmim të energjisë elektrike. Është lehtë të mbahet çmimi i energjisë tash, por ka kosto shëndetësore që na kthehet më vonë.

Në fund fare, bëj thirrje që edhe Komuna e Prishtinës të jetë më aktive në sistemin e ngrohjes, por edhe Qeveria të japë më tepër fonde në zgjerimin e këtij sistemi. Besoj që është bërë pak në këto vitet e fundit për të zgjeruar rrjetin e ngrohjes, duhet të kujtojmë se pjesa më e madhe e konsumit të energjisë bëhet pikërisht në ngrohje.

Meqenëse u kthye ministri i Arsimit, propozova që në ditë të rënda si këto të bëhet ndërprerja e mësimin në shkolla fillore që së paku fëmijët tanë në Prishtinë t'i kursejmë prej një ambienti të tillë dhe besoj që është shumë lehtë të kompensohet ky mësim në javë më të vonshme, kur ajri është edhe më i pastër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti ministër...

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Më tepër desha të jap informata lidhur me problemin apo fillin e problemit që e kemi me ndotje, sidomos në referencë të një studimi që është duke ndodhur tani dhe që ka ndodhur edhe në vitin 2015 nga Banka Botërore për termocentralin “Kosova e Re”, por gjithashtu edhe impaktin e termocentralit “Kosova A” dhe “Kosova B” në mjedis, pra si impaktin në mjedis dhe shoqëri.

Sipas këtij studimi, kur janë matësit për ndotje, siç është, për shembull, matësi që po i referohemi gjatë tërë kohës për grimcat e pluhurit pra PM 10 dhe PM 25, ky studim e parasheh që në Prishtinë, specifikisht në Prishtinë termocentrali “Kosova A” dhe “Kosova B” ndikojnë me vetëm me 1 deri në 9% ndotje nga ndotja totale. Po flasim gjithmonë për këto grimca. Ndotës më i madh është “Kosova B” se “Kosova A”, sepse në “Kosova A” filtrat janë ndryshuar në vitin 2011, kurse “Kosova B”, e tha edhe ministrja më herët që nga viti 1985 nuk ka ndërruar asnjëherë.

Ndotësi më i madh, sipas të njëjtit studim, në Prishtinë mbeten shtëpitë që djegin thëngjill të papërpunuar. Pra, ajo është një thëngjill i patrajtuar më herët është ndotësi më i madh dhe është ndotës jashtëzakonisht i madh, sepse ka squfur jashtëzakonisht shumë, pluhur jashtëzakonisht shumë dhe normalisht edhe dioksid karbon. Pjesa tjetër mbetet trafiku, i cili ka një pjesëmarrje rreth 12%, pra trafiku i makinave rreth 12% kontribuon në ndotjen totale të ajrit në Prishtinë. Nëse i krahasojmë pra, për shembull, janë pesë pika matëse gjithsej që menaxhohen edhe nga KEK-u, edhe nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, pra në Prishtinë i kemi dy pika, deri në 9% maksimumi kontributi i “Kosovës A dhe B”, rreth 84% kontributi i shtëpive dhe i bizneseve në djegie të thëngjillit, si dhe rreth 12% i makinave apo trafikut. Këto janë të dhëna zyrtare nga Raporti i Bankës Botërore, të cilat priten të dalin edhe publike në muajin qershor të vitit që vjen.

Sa i përket gjithashtu kogjenerimit, sa për informatë KEK-u, “Kosova B” ka krijuar kapacitet të kogjenerimit rreth 140 megavat energji termike që i ka në dispozicion, kurse janë duke u shfrytëzuar vetëm 80 megavat për momentin, kështu që ka hapësira akoma për investime dhe shpresojmë që këto investime të ndodhin në rrjetëzime të “Termokos”-it në Prishtinë, në mënyrë që ta hapim sa më shpejt qasjen në energji termike.

Këto janë vetëm informata, nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Infrastrukturës, zoti Lekaj e ka fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Me të vërtetë është gjendja shqetësuese sa i përket ndotjes së ambientit që ka impakt te shëndeti i qytetarëve dhe ne si Qeveri jemi të përkushtuar që t'i qasemi me kritere, me ligje që kjo gjendje të ndryshojë. Me vëmendje e dëgjova deputetin e nderuar Abdixhikun, që me të vërtetë e preku një segment që ka impakt negativ te ndotja e ambientit, që janë automjetet, por që kjo gjendje nuk mund të zgjidhet brenda dite, brenda muaji, apo brenda vitit, por ne si Ministri e Infrastrukturës jemi duke përpiluar udhëzimet administrative që i rrisin kriteret, e sidomos te qendrat e kontrollit teknik të automjeteve.

Në Kosovë ekzistojnë 128 qendra të kontrollit teknik të automjeteve, që për mua mendoj është e pakuptimtë dhe po të shihen kriteret, të cilat janë, është për t'u çuditur dhe në këtë drejtim ne vetëm duke u bazuar në ligjin e miratuar do të nxjerrim Udhëzimin administrativ që do t'i rrisë këto kritere. Me të vërtetë ata që investojnë, do të kenë tamam edhe licencë, por jo të tjerat, sikur trafika, çdo kund dhe ne të japim leje, qofshin ato për dostat apo dikë tjetër. Të jeni të bindur që kjo do të rregullohet shumë shpejt dhe shpresoj që brenda javës së ardhshme do të nënshkruhet Udhëzimi administrativ që i rrit këto kritere. Sa i përket kontrollit teknik, mendoj që në Kosovë janë diku 332 mijë e 975 automjete që i nënshtrohen kontrollit teknik, ndërsa mesatarja e vjetërsisë të këtyre është 16,46% dhe kjo është bukur për qindje e madhe. Me ligjin e miratuar në vitin 2015 kjo për qindje, meqë ka ardhur dhe ligji që ua lejon automjeteve deri në 10 vjet, do ta ndryshojë gjendjen, por ne jemi të përkushtuar që me të vërtetë kjo gjendje të ndryshojë pozitivisht dhe në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Ambientit do t'i koordinojmë edhe udhëzimet e tjera administrative. Ne kemi edhe shumë faktorë që kanë impakt negativ, nëse nisim nga deponitë, të ngurta a të lëngëta, kudo i sheh, nëse nisim edhe nga gjërat e tjera që u përmend, thëngjilli që përdoret nëpër shkolla që urgjentisht duhet të ndërpritet, termocentralet e shumë e shumë të tjera elemente që kanë impakt negativ.

Por, ajo që unë e them sot me të vërtetë që duhet t'u kërkojmë falje qytetarëve, ka pasur jo fort qartësi në rrugë, të cilat janë ndaluar, por unë pajtoj edhe me deputetët që e përmendën që Prishtina nuk është vetëm qendra. Në periferi jetojnë shumë më tepër se sa në qendër, prandaj është një diskriminim: ose të ndalen të gjitha veturat në hyrje të Prishtinës, ose të mos bëjnë seleksionim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mexhide Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra, ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Vendi ynë po përballet me ndikime shumë serioze, sociale dhe ekonomike nga aktivitetet ndotëse që menaxhohen dobët dhe do të përfitonte shumë nga veprimet korigjuese për të mbrojtur dhe restauruar cilësinë e mjedisit.

Cilësia e ajrit të mjedisit mund të përmirësohet dukshëm dhe të zbutet ndikimi në shëndet nëse ndotësit kryesorë respektojnë ligjet dhe standardet për emetimet në ajër. Ndotja e ajrit llogaritet se shkakton 835 vdekje të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 shtrirje në spital dhe 11 mijë e 600 vizita në emergjencë çdo vit.

Të nderuar qytetarë dhe kolegë deputetë, ministrja paraprakisht e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor paraqiti para nesh se është duke e përditësuar strategjinë kosovare të mjedisit, planin shtetëror të veprimit për mjedisin, si dhe strategjitë. Të gjitha këto strategji dhe planet e veprimit po i identifikojnë prioritetet rreth politikave për ajrin, ujin, mbeturinat, kemikalet, biodiversitetin dhe mjedisin në përgjithësi.

Ndër të tjera, unë konsideroj se vendi ynë ka mungesë të menaxhimit të duhur të mbeturinave, pothuajse të gjitha llojet e mbeturinave të ngurta nga ekonomitë familjare, industriale, kujdesin shëndetësor dhe materiet e rrezikshme. Mungon klasifikimi, riciklimi dhe sistemi i trajtimit, si dhe infrastruktura për mbeturina komunale. Deponitë ilegale dhe deponitë e ndërtuara dhe të menaxhuara në mënyrë të padrejtë janë në numër të madh, mungojnë kapacitet e ndërtuara dhe në funksion për mbeturinat e rrezikshme. Unë nuk kam njohuri që Kosova ka kapacitet të licencuar për djegien e mbeturinave të rrezikshme. Këto mungesa shkaktojnë ndikime të rënda shëndetësore dhe mjedisore nga deponitë e pakontrolluara apo të kontrolluara dobët, ose në veçanti në viset rurale ekzistojnë sasi e madhe e mbeturinave të pambledhura, të hedhura në deponitë ilegale, shpeshherë afër lëmenjve, e kështu shkaktojnë rreziqe të tjera mjedisore, apo mbeturinat ndizen.

Sasi të mëdha të hirit të thëngjillit nga termocentralet e linjtit dhe mbeturinat nga minierat, gjithashtu hidhen për çdo vit pa kurrfarë mase të riciklimit. Për hedhjen e hirit të thëngjillit, supozohet se ai hi, sikur në shumë shtete të BE-së, mund të shfrytëzohet pjesërisht për t'i zëvendësuar materialet kryesore ndërtimore, siç është çimentoja dhe zalli. Mund të supozohet se praktika e tashme e menaxhimit të mbeturinave do të çojë në nivele të larta të ndotjes së ajrit dhe të ujërave nëntokësore nëpërmjet emetimeve të metanit, gazrat nga deponitë, por edhe grimcat e imëta gjatë djegies.

Për t'i eliminuar ndikimet mjedisore të djegies së mbeturinave nëpër oborre, trajtimin e padrejtë dhe kontrollimin e dobët të deponive, kërkohen investime në rehabilitim të deponive, apo ndoshta duhet të ndërtohet një apo dy deponi shtesë dhe kërkohen investime në pajisjet për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, si dhe rritja e nivelit të shërbimit të popullsisë në mbi 90%. Tarifat e tashme për grumbullimin e mbeturinave të ekonomive familjare prej 3-4 euro

në muaj për ekonomitë familjare mund të jenë të mjaftueshme për t'i mbuluar kostot familjare dhe operacionale të sistemit themelor, por të pranueshëm për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

Të nderuar deputetë, unë do t'i paraqes para jush disa rekomandime:

- Qeveria mund ta shqyrtojë mundësinë e hartimit të planit master strategjik për vitet që vijnë në vijim, për menaxhimin e mbeturinave, përfshirë mbeturinat e rrezikshme, që duhet t'i marrë parasysh nevoja për investime në faza për afat të gjatë, duke i analizuar kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes.

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet ta shtojë numrin e inspektorëve, si dhe t'u sigurojë inspektorëve pajisje për monitorim dhe inspektim dhe përmirësim të regjistrimit të emetimeve nga industritë më të mëdha.

- Duke ditur barrën e madhe të humbjes së nivelit të inteligjencës të fëmijët e ekspozuar ndaj plumbit, duhet të zbatohen me ashpërsi lirimet nga karburantet që përmbajnë plumb.

Po ashtu, u përmend se edhe në objektet apo institucionet shkollore duhet të ndërmerret urgjentisht ndërprerja e procesit të ngrohjes me qymyr, duhet të bëhet përgatitja e planit strategjik për sektorin e furnizimit me ujë, me synim që 90% e popullsisë të ketë qasje në ujësjellës, përfshirë menaxhimin e pellgjeve të lëmenjve, kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave.

Një plan i veprimit mund të përgatitet për të mbrojtur pyjet kundër prerjeve ilegale dhe restaurimin e pyjeve të degraduara nëpërmjet regjenerimit natyror, si dhe më 22 prill, me rastin e Ditës së Tokës, të mbillen fidanë dhe lule me moton "Mbill një fidan, shpëto Tokën", me qëllim të ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e natyrës, si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndajë për qytetarët informatat mjedisore dhe të dhënat nga monitorimi nëpërmjet raporteve mbi gjendjen e mjedisit dhe nëpërmjet treguesve, që maten dhe përditësohen me lehtësi. Dhe, duke e ditur barrën e rëndë të sëmundjeve nga ndotja e ajrit, duhet përmirësuar sistemin e regjistrimit të pacientëve për sëmundjet që lidhen drejtpërdrejt me ndotjen e ajrit, e që kjo mënyrë e regjistrimit do të ishte njëherësh edhe matës i ndikimit të degradimit mjedisor në shëndetin tonë dhe do ta nxiste përkrahjen publike për ndryshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Ju përshëndes juve, kolegë të nderuar deputetë,
Kabinetin Qeveritar!

Më lejoni që fillimisht ta vlerësoj tej mase seriozitetin dhe angazhimin e ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, për angazhimin e saj dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me Komunën e Prishtinës.

Sigurisht më shumë se kurrë ka nevojë për këtë, duke pasur parasysh se kjo çështje që nga paslufta deri më sot nuk është marrë me seriozitet, duke pasur parasysh se çdo vit është duke u rënduar ajri dhe shëndeti i qytetarëve. Unë mendoj që vetëm Ministria e Ambientit apo një ministri nuk mund ta ndërmarrë këtë hap. Në këtë rast, edhe sot, edhe tutje, duhet që të bashkëpunojnë të gjitha dikasteret për eliminimin e ndotjes së ambientit, pasi vetëm një dikaster nuk mund ta rregullojë këtë çështje.

E përshëndes iniciativën e ministres për formimin një task-force që të bëjë një planifikim afatgjatë dhe funksionimin e saj. Natyrisht, kisha dashur ta përshëndes punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që sot ka qenë në detyrë dhe gjithë procesin e kanë përcjellë pa asnjë vërejtje dhe ka funksionuar mirë. Por, sot ndotësit e ambientit janë jashtëzakonisht të shumtë, natyrisht se është KEK-u, janë dikasteret tjera, marrja e qymyrit nga vendet që nuk janë të autorizuar dhe shitja ilegale. Kjo është jashtëzakonisht shqetësuese dhe unë u bëj thirrje të gjitha atyre institucioneve përkatëse që t'i ndërmarrin masat, pasi ne duhet ta ndërrojmë strategjinë. Duhet ta ruajmë vendin tonë, duhet ta përmirësojmë jetën e qytetarit, e në veçanti ta ruajmë shëndetin e qytetarit.

Ka shumë dikastere, është qymyri që përdoret, janë filtrat e KEK-ut, që sot është një ndotës jashtëzakonisht i madh, është moskontrollimi i naftës, ngase nuk kontrollohet, dhe nafta e dobët sigurisht që krijon probleme, pastaj është homologimi i makinave. Është e çuditshme si bëhet homologimi në veturat e reja, që nuk e kam dëgjuar asnjëherë në asnjë vend diku tjetër, përpos në Kosovë, e duhet të kontrollohen ato që janë të nevojshme për këtë çështje.

Dua t'i përgëzoj për këtë plan që kanë bërë tani, por kjo duhet të vazhdojë tutje. U bëj thirrje edhe kryeministrit dhe ministrave përkatës që ta përkrahin dhe të bëhemi unikë, pasi Kosova nuk është vetëm e një kryeministri apo e një ministri, por është e gjithë qytetarëve të Kosovës, është edhe e jona si parlamentarë dhe ta çojmë këtë strategji përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Me rëndësi është kur identifikohen problemet dhe shkaktarët që po e shkaktojnë këtë ndotje të ajrit, dhe unë e përshëndes gatishmërinë e Qeverisë për të gjitha këto masa që i ka ndërmarrë në një afat të shkurtër dhe normalisht, bashkërisht Qeveria e ministritë, dikasteret, Prishtina, Obiliqi, Fushë-Kosova, të gjithë bashkë, edhe ne si deputetë dhe si institucione të Kosovës duhet të

mobilizohemi, sepse ky është një problem i madh, është një problem i cili na përket të gjithëve që të merremi dhe ta trajtojmë ashtu siç duhet.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka dhënë numrin e vdekjeve në botë nga ajri i ndotur. Sipas këtyre të dhënave, janë më shumë se 3 milionë njerëz që vdesin nga kjo dukuri. Prej tyre, 80% vdesin nga sulmi në zemër dhe 20% vdesin nga sëmundjet e organeve të frymëmarrjes. Niveli mesatar i ndotjes nëpër vende të tjera është nga 4-12 herë më shumë sesa niveli i cilësisë sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Transporti dhe energjia me burime të ripërtëritshme do të ndikonin që të zvogëlohej niveli i ndotjes së ajrit. Ndotje të ajrit ka pasur edhe disa dekada më parë, por në atë periudhë nuk kishte aplikacione të tilla të telefonave, që do t'i siguronin shifrat e gjendjes së ajrit, siç po ndodh sot nga projekti i Ambasadës Amerikane. Shkaktar i ndotjes mund të jetë pluhuri, por ky nuk është faktori i vetëm. Shkaktari i dytë i ndotjes është trafiku me makina, të cilat kanë më shumë se dhjetë vjet. E shkaktari i tretë në sezonin dimëror mund të jenë edhe ekonomitë familjare, amvisëria, bizneset që djegin dru. Nga këta shkaktarë kemi edhe termocentralet në verë, por kemi edhe makinat e shumta, të cilat gjatë sezonit të verës shumohen.

Ambasada Amerikane e ka realizuar një aplikacion, që tashmë po u shërben të gjithëve nëpërmjet telefonit. Nuk asgjë e re kjo situatë, ka qenë edhe për të paktën 30-40 vjet më parë, por atëherë nuk e kishim një aplikacion që dëshmonte diçka të tillë. Ndryshimi e situata klimatologjike, që do të thotë gjithçka është në qetësi, ajri i ftohtë dominon. Miliona njerëz vdesin në vit nga ajri i ndotur.

Si do të duhet të mbrohemi nga sëmundjet që mund të shkaktohen? Është paksa e vështirë t'i bindësh njerëzit të vetëdijesohen për gjendjen momentale të ambientit në botë, derisa kjo gjendje fillon të ndikojë tek ata personalisht.

Ditëve të fundit, ndotja e ajrit ka bërë që Prishtina të jetë e para në botë me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit, gjë e cila është vërtet shqetësuese. Po përse është shqetësuese? Cilat janë efektet e ndotjes së ajrit në shëndetin e qytetarëve dhe çfarë sëmundjesh mund të shkaktojnë këto? Fillimisht po njoftohemi me llojet e ndotjes së ajrit. Së pari duhet ta kemi parasysh se ekzistojnë tri lloje të ndotësve të ajrit, të cilët shkaktojnë problem në ambient dhe në shëndet, materiet e partikulave, këto grimca të rrezikshme të ndotjes së ajrit, mund të penetrojnë thellë në mushkëri dhe në enët tona të gjakut. Grimcat i keqësojnë sëmundjet e zemrës dhe të mushkërive, ndërsa janë përgjegjëse për vdekjen e 29 mijë njerëzve në vit vetëm në Mbretërinë e Bashkuar. Dioksidi i nitrogjenit është gaz toksik, të cilin shpeshherë mund ta vëreni si mjegullim të verdhë mbi qytet. Nivelet e larta të dioksidit të nitrogjenit mund ta keqësojnë shëndetin e personave që vuajnë nga astma dhe gjithashtu mund të shkaktojnë probleme me frymëmarrje dhe me kollë, e të tjera.

Ozoni në nivel të tokës, niveli tokësor apo keq i ozonit krijohet nga reaksionet kimike ndërmjet oksidit të nitrogjenit dhe përbërësve organikë të guolatit. Në praninë e ditës së diellit, mund të shkaktojë acarim të syve, hundës dhe fytit.

Si ndikon saktësisht ndotja e ajrit në shëndetin tuaj? Për shembull, në sëmundjet që ndikon ndotja e ajrit është kanceri. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka deklaruar se ndotja e ajrit mund t'i përfshijë edhe veturat me naftë, që janë kancerogjene për njerëzit dhe gjenden në grupin e parë të rrezikut, njëjtë sikur pirja e duhanit. Astma - shumica e njerëzve me astmë deklarojnë se kualiteti i dobët i ajrit ua përkeqëson shëndetin. Kjo, sipas ekspertëve shëndetësor, i rrezikon ata të kenë sulme të astmës. Sulm zemre dhe në tru, sëmundjet e zembrës, diabetit dhe shumë sëmundje të tjera, të gjitha këto janë shqetësuese. Andaj edhe një herë, Qeveria, Ministria e Ambientit, Komuna... të gjithë duhet të bëhemi bashkë, në mënyrë që ta luftojmë këtë fenomen, i cili është shqetësues për qytetarët e Kosovës, sidomos për qytetarët e Prishtinës, Obiliqit dhe Fushë-Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Shyqyr kryetar, se më ke bërë nervoz, më ke huq pak, unë moti e kam kërkuar fjalën.

Dëshiroj ta filloj fjalimin tim me një diçka, meqë po më duket krejt debatet e sotme i ngjajnë një grumbulli të minjve që kanë thënë "duhet ngjitur cingaren maces, po kush guxon ta bëjë këtë?" Dhe kurrkush s'ka guxuar, ai miu që ka shkua te macja, macja e ka hëngër.

Ne i dimë shkaktarët, po shkaktar i krejt shkaktarëve të kësaj që po ndodh, e që nuk është e vërtetë që gjendja është alarmante e ndotjes së ajrit, as sot, as qe një javë, as qe dy javë, por qe 16 vjet, me të njëjtët parametra. Shkaktar i krejt kësaj është mosfunksionimi i shtetit.

Ministrja jonë dhe deputetë këtu, edhe Timja, edhe Islami, që po i lavdëron, edhe Pali që po del të flasë, edhe Lumiri që po i jep këshilla ministrit të Arsimit, Qeveria është veç të na dëgjojë, Qeveria është të marrë vendime, Ekzekutivi është të marrë vendime. Cili do të ishte vendimi i ministres?

Shkarkimi i atij dordolecit atje, që e ke në agjenci, që merr para prej danezëve qe 7-8 a 10 vjet, e ai është përgjegjës për të t'i bërë ty politikat për mbrojtjen e ambientit, se ministri i përcakton politikat, ai nuk mund të shqyhet në të gjitha anët, çka të bëjë këndeje ose andej. Tash një pjesë mundohet ta paraqesë gjendjen alarmante, sa ne po u dashka t'i mbyllim shkollat. I kanë ndalë makinat e shkreta, fukarenjtë e shkretë pa asnjë hak. Kjo është masë për ta terrorizuar qytetarin e Kosovës.

Në qoftë se ministrja thotë, dhe që është shumë e vërtetë thënia e saj, që prej vitit 1985 nuk janë ndërruar filtrat në termoelektranë dhe ne e dimë që nuk janë ngjitur filtrat në “Ferronikel” në Drenas, atëherë dikush e ka hëngër kulaçin këtu pse nuk janë ngjitur ata filtra. Dikush është i korruptuar këtu. Atëherë, Qeveria duhet ta shkarkojë drejtorin e KEK-ut, ministrja duhet të ndërmarrë masa ndaj atyre të cilët kanë qenë përgjegjës në legjislaturat e kaluara për ndërtimin e politikave dhe masave paraprake për mbrojtjen e ambientit.

Kush i shkatërroi lumenjtë? Kush i shkatërroi pyjet? Kush po e bën gjithë këtë ndotje të ambientit? Mosfunksionimi i shtetit.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, Qeveria është për të ndërmarrë masa, jo t’i terrorizojë kujt t’i teket, të çohet në Komunën e Prishtinës, “jo po i ndalojmë ne makinat...”, e kush e han? E han ai qytetari i shkretë! Ne deputetët hyjmë aty, ata biznesmenët hyjnë... prandaj kjo ka qenë masa më e keqe, më shkelëse e të të drejtave direkte të njeriut, sepse këto masa, këta parametra janë tash e 16 vjet.

Unë dua të dal edhe në një segment tjetër. Pika më e ndjeshme për të diskutuar sot në Parlament është qendra e trurit, që quhet talamus. Po të ndodhë të të bëjë dikush operacion në talamus, është sikur të shkelësh në mina me sy mbyllur. Krejt kontrolli i naftës, krejt mafia këtu është e përzier rreth kontrollit të derivateve. Ne e dimë se ka pasur një kompani serbe, unë me fakte ua tregoj deputetëve kush e ka bërë kontrollin e naftës, sepse ka qenë një Aleksandër Gjorgjeviq, ja këtu e kam dokumentin, dhe ky njeri ka paraqitur në Ministrinë tonë të Tregtisë dhe Industrisë se gjoja ka laborator dhe ai laborator nuk ka ekzistuar fare. Ky e ka bërë kontrollin e naftës.

E posedoj një dokument tjetër, ku “Okta” e Shkupit vetë në konferencën e Vjenës ka deklaruar se ka futur në Kosovë derivate të naftës me sulfur 2%, e në parametra, ose në rregullore, ose në ligj, ka qenë vetëm 1%. Ekziston dokumenti këtu. Ekziston një dokument tjetër, ku një laborator, i cili e ka licencën për kontrollin e tekstilit, ka lëshuar certifikata për kontrollin e naftës dhe të benzinës.

Prandaj, në qoftë se ekzistojnë... shikojeni dosjen këtu, 2000 faqe është, këtë dosje e kam marrë prej EULEX-it. Në qoftë se shumë ministra tonë të Tregtisë dhe të Industrisë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë nën hetime, në qoftë se asnjë ministër nuk arrestohet, atëherë pse të frikohet ky ministri ynë, Bajram Hasani? Kurrkush..., thotë “pasi ata para meje s’e kanë hëngër, s’e ha as unë!”

Prandaj, në qoftë se do të funksiononte shteti, atëherë do të duhej të arrestohej dikush që është përgjegjës për këtë ndotje kaq të madhe të ambientit. E posedoj një dokument këtu, zoti kryesues, kur më 25. 12. 2012 është bërë kontrolli i një sasive të madhe të naftës, e në realitet malli ka hyrë në Kosovë më 16. 2. 2013. Imagjinojeni! Kontrolli, certifikata është lëshuar para se

të hyjnë nafta dhe benzina në Kosovë. Edhe vetë zoti Xhavit Haliti, më kujtohet, një herë ka folur me shqetësim për këtë punë, për arsye se në Kosovë hyjnë çdo ditë qindra kamionë, të cilët në Doganat tona shkruhen si mazut, e në realitet nuk është mazut, por është benzinë.

Ne ua kemi deleguar me një urdhër administrativ kontrollin e naftës e të benzinës Doganave. Ku ndodh kjo në botë? Në cilin vend të botës ndodh që Dogana ta kontrollojë kualitetin e naftës dhe të benzinës? Kjo ndodh veç në Kosovë!

Dogana nuk ka laborator. Laboratori i "Okta" në Shkup e ka bërë kontrollin e derivateve të naftës, e Kosova ka blerë naftë dhe benzinë prej "Okta"-s së Shkupit. Prej Shqipërisë hyjnë brenda ditës nga 50-70 cisterna, që vijnë direkt prej Greqisë.

Prandaj, le ta dijë ky popull i shkretë që derivatet e naftës, derivatin e benzinës, mazutin, këtu e kontrollojnë Greqia, Serbia dhe Rusia. Këtu ekzistojnë dokumente, nuk jam duke folur përralla të Nasradin Hoxhës. Po, ku t'i prek derivatet e naftës, që unë e kam thënë edhe një ditë, që shumë njerëz kanë interesa të drejtpërdrejta pikërisht në këtë mafiozllëk. Prandaj, që ta përfundoj këtë fjalë. Ai njeri që nuk i ka vënë filtrat e duhur në termoelektranë, ose qoftë në KEK, duhet të shkojë në përgjegjësi dhe Parlamenti i Kosovës, po u bëj thirrje të gjithë deputetëve, ta bëjë një komision hetimor, i cili do t'i hetonte të gjithë laboratorët dhe të gjitha vijat dhe mënyrat se si është kontrolluar derivati i naftës, i benzinës dhe i mazutit në Kosovë. Pastaj keni për ta parë ju tmerrin se çfarë ka ndodhur në këtë vend plot 16 vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Në çështjet që lidhen me ndotjen dhe përgjithësisht me problemet e mjedisit, këtu pati fjalime të ndryshme dhe informacione jashtëzakonisht interesante, ide të mira, me shumicën prej të cilave pajtohem. Ajo çka do të doja të shtoj është çështja e planifikimit.

Pra, komplet çështjet e mjedisit janë çështje tejet komplekse. Nuk mund të thuhet vetëm që ne duhet të drejtohem në një drejtim, të kemi një drejtim, pra çështjen e inspektoratit, apo te nafta, apo diku... Të gjitha këto janë në rregull. Por, në përgjithësi është edhe një element tjetër që duhet pasur parasysh, që është çështja e planifikimit hapësinor, ku komunat tek ne kanë planifikim në mënyrë të veçantë dhe në njëfarë mënyre kontrolli qendror nga Instituti i Planifikimit, ose nga ministria, është bukur i dobët, si të them, është mjaft i pjesshëm dhe ndikimet e ndryshme të interesave në planifikim kanë qenë tejet të mëdha.

Unë sot mund të them që të gjitha komunat në Kosovë ua kanë nënshtruar jashtëzakonisht shumë planifikimin interesave të pronarëve të tokave bujqësore në zonat periferike të qyteteve, të cilat prona bujqësore kanë qenë për një kohë të gjatë objekt transaksionesh apo privatizimesh dhe

përnjëherë, për shkak të rritjes së leverdisë dhe interesit dhe profitit, të gjitha këto toka janë kthyer në zona ndërtimi, janë kthyer në toka ndërtimore dhe, rrjedhimisht, qytetet e Kosovës, e në veçanti Prishtina, janë shndërruar në qytete me zona tejet të gjera urbane.

Kjo është tejet joeficiente, është tejet në kundërshtim me politikat e planifikimit dhe të qëndrueshmërisë urbane, pra planifikimit të qëndrueshëm në përgjithësi të qëndrueshmërisë urbane.

Ne duhet të synojmë qytete unike, të cilave lehtë ua çojmë shërbimet edhe të transportit publik, edhe kështu me radhë.

Në komunën e Prishtinës, mund të themi që në vitet e fundit është bërë përpjekje që të punohet në këtë drejtim. Janë mbjellë ta zëmë 12 mijë drurë, është bërë kogjenerimi dhe janë përfshirë 60 mijë banorë në rrjetin e kogjenerimit, e tash “Termokosi” nuk ka nevojë ta përdorë mazutin dhe të kemi ndotje. Normalisht, nga këta 60 mijë mund të shtohet shumë shpejt në 120 mijë banorë dhe të kemi zgjerim të rrjetit.

Të gjitha këto mund të bëhen, por nëse këtë ia mbështetim vetëm Komunës së Prishtinës do të kemi një lëvizje tejet të ngadaltë të zhvillimit në këtë drejtim, edhe pse ajo çka është bërë për vitet e fundit ka qenë mjaft ambicioze dhe mjaft e shpejtë.

Prishtina, ta zëmë, është duke e bërë planin e mobilitetit dhe nëse këtë e ndërlikim me çështjen e autobusëve të blerë dhe me mundësinë e ardhjes së autobusëve të rinj, atëherë shumë thjesht në Prishtinë mund të kemi ndryshim të madh, ku do të ishin krijuar trasetë e veçanta për trafikun urban dhe kjo do ta kishte sjellë një rezultat tamam të plotë.

Unë sot kam parë vetura më pak në Prishtinë. Këtu që është shkelur e drejta e lëvizjes së lirë. Unë në këtë rast në Komunën e Prishtinës, po ashtu edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë i përgëzoj për aksionin që e kanë ndërmarrë.

Sot kemi pasur rast të shohim një Prishtinë shumë më të qetë, me më pak vetura dhe megjithatë po jetohet në të.

Kush janë qytetarët të cilët kanë prioritet në lëvizje të lirë? Janë këmbësorët, por nuk mund të themi që po ua cenojmë lirinë atyre që kanë vetura. Nëse ata që kanë vetura do ta dominojnë në vazhdimësi në vitet që vijnë qytetin, atëherë me këtë do t’ua cenojmë lirinë atyre që janë këmbësorë të thjeshtë.

Nëse ne do të shkojmë nga ideja vetëm e zgjerimit të rrugëve për të krijuar shirita të ri për makina, nuk do të bëjmë zgjidhje. Do të kemi gjithnjë e më tepër makina. Duhet të synohen

zgjdhje të reja alternative, e të cilat në Prishtinë janë duke u bërë nëpërmjet planit të mobilitetit urban. Dhe, kjo natyrisht që do të ketë nevojë për ndihmën e institucioneve qendrore, që të intervenohet edhe në kryeqytet.

Po ashtu, çka duhet të kemi parasysh, e përmendi ministra dhe mua më bëri përshtypje jashtëzakonisht të mirë, është që e përmendi regjionin e Prishtinës, regjionin e Prishtinës në vazhdimësi.

Pra, nuk mund të trajtohet Prishtina si e vetme, kur flasim për planifikim, e kur flasim për të gjitha lëmitë që lidhen, sidomos me mjedisin, nuk mund të mos i trajtojmë edhe komunat rreth e përqark, sidomos meqenëse kemi të bëjmë me kryeqytetin, trajtimi i çështjeve mjedisore dhe i planifikimit në nivel regjioni, duke e përfshirë këtu edhe komunën e Drenasit, edhe komunën e Fushë-Kosovës, edhe komunën e Kastriotit, të Besianës e të Lipjanit, atëherë thjesht nuk do të kemi ndonjë sukses të mirëfilltë.

Për sa u përket masave konkrete urgjente që duhet t'i ndërmarrim tani për tani në terren, atëherë duhet ta kemi parasysh që nëse në Termocentralin Kosova A, pas intervenimeve që janë bërë sot, imetimi i gazrave dhe i pluhurit është brenda kufijve të normales, shumë thjesht ne e paskemi shembullin e mirë kur në një termocentral të vjetër është intervenuar dhe kemi sukses. Kur do të bëhet intervenimi në Kosovën B? Kur do t'i kemi filtrat në Kosovën B? Nëse Kosova A e ka emetimin e gazrave nën 50 mikron në metër kub, që është brenda kufijve të pranueshëm, dhe Kosova B në këtë rast e ka mbi 380, kur do ta kthejmë Kosovën B brenda këtyre kufijve?

Tjetra? Po flasim për naftën, po flasim për qymyrin, për shitjen, për ndalimin e shitjes e krejt. Për të gjitha këto ekziston një zinxhir i tërë i aktiviteteve, të cilat ndikojnë në mjedis. Nuk mund të kapet vetëm një hallkë dhe thuhet të godasim në këtë hallkë dhe ta ndalojmë shitjen e karburanteve ose të kemi kujdes te makinat. Është komplet një zinxhir i tërë i aktiviteteve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mjedis, ku nga e para deri te e fundit, pra nga vendet ku nxirret ai qymyr ilegalisht e deri te shitja e tij e furnizimi që bëhet në mënyra të ndryshme duhet të kemi kujdes.

Po ashtu duhet ta kemi parasysh importin edhe ilegal të derivateve të ndryshme që sot përdoren për ngrohje dhe natyrisht duhet patjetër të kalojmë edhe te format alternative të ngrohjes.

Përpos kogjenerimit, që duhet të shtohen në vazhdimësi, kapacitetet e ngrohjes në qytetin e Prishtinës, duke përfshirë edhe ekonomitë familjare, për shkak se te ekonomitë familjare rreth 80% e tyre ngrohen me stufa, atëherë kur ta kemi parasysh ngrohjen, duhet ta kemi parasysh jo vetëm te ndërtesat kolektive, por edhe te ndërtesat individuale dhe duhet ta futim idenë e ngrohjes me gaz natyror, e cila është përmendur vazhdimisht dhe përmendet kudo nëpër

dokumente që i kemi ne për format alternative të ngrohjes, por asnjëherë asnjë hap konkret nuk është ndërmarrë.

Po ashtu duhet të kemi edhe aplikim më konkret të formave alternative të krijimit të energjisë, të ngrohjes, e kështu me radhë. Mendoj që Prishtina, e po ashtu edhe Kosova i ka mjaft të mira të gjithë komponentët që do të mund të realizoheshin këto.

Unë nuk do ta kisha zgjatur më tepër, por ajo vetëm çka do të doja të shtoj është që hapat që sot po i ndërmerr Ministria jam dakord me ta, vetëm se normalisht kjo duhet të thellohet shumë më tepër me përfshirje të të gjitha institucioneve me inspektim të rregullt dhe, natyrisht, me politika të drejta, të cilat do ta kenë gjithmonë në pah qytetarin, se politikat e deritanishme e kanë pasur gjithmonë vetëm profitin në fokus.

Nëse do ta kemi vetëm profitin në fokus, do ta kemi këtë Kosovë çfarë e kemi sot.

Nëse do ta kemi qytetarin dhe politikat e qëndrueshme para vetes, atëherë do të kemi ndryshim të situatës.

Ajo që ka ndodhur sot në Prishtinë, uroj që të ndodhë në vazhdimësi dhe besoj që shpejt ne do ta kemi shtetin me transport publik edhe më mirë të organizuar, me trase të ndara, me vetura më pak. Le të ketë garazhe më tepër, le të ketë parkingje më tepër në periferi, por brenda qytetit le të ketë sa më shumë këmbësorë e çiklistët, e sa më shumë trafik urban.

Sot në Prishtinë ka pasur më pak vetura, po dua të jua përkujtoj që të gjithë autobusët e trafikut urban kanë qenë të mbipopulluar. Nuk ke ka pasur ku të hipësh në autobus, se kanë qenë tejet të mbushur. Pra, paska mundësi. I kemi pasur autobusët me udhëtarë jashtëzakonisht shumë, që nuk kanë mundur as t'i zënë, e pse të mos vazhdojmë në këtë mënyrë? Kjo është mënyra pra që besoj të ardhmen edhe qytetarët e Prishtinës do të kenë mundësi që të jetojnë në mënyrë sa më të mirë dhe të kenë jetë sa më cilësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Këtu u fol shumë për ndotësit e ndryshëm, të cilët janë ndotës në gjithë Kosovën, siç janë karburantet, siç është qymyri, por ne duhet ta themi hapur dhe saktë që ndotësi kryesor i Prishtinës dhe i rrethit të Prishtinës janë termocentralet, është mihja sipërfaqësore.

Ne këto ditë e kemi aprovuar edhe strategjinë energjetike, e cila gjithashtu e përcakton atë strategjinë tonë të shfrytëzimit të qymyrit në gjenerimin e energjisë dhe nuk ka ndonjë perspektivë të mirë për ambientin, ndonjë perspektivë për ruajtjen e ajrit në Kosovë dhe veçanërisht në qytetet përreth termocentralit.

Derisa shtetet evropiane dalëngadalë janë duke u larguar nga termocentralet dhe shumica nga ju besoj që jeni në dijeni që shtetet evropiane nga viti 2025 do t'i mbyllin termocentralet, ndërsa Franca vetëm e ka marrë këtë vendim për mbylljen e termocentraleve, ne e kemi shkruar edhe kontratën me "Controul Global", e cila në 20 vjetët e ardhshme do ta shfrytëzojë në mënyrë të pamëshirshme tokën, do ta shfrytëzojë nëntokën, por do t'i plasojë edhe këto ndotje të ajrit.

Ju e dini që kjo ndotje, jo vetëm që e bën ndotjen e ajrit nga termocentralet, por ka ndotje edhe të ujërave, edhe të tokës.

Kemi ujëra të cilat bëhen acidike, lirohet sulfuri, lirohen metalet e rënda, të cilat e dëmtojnë edhe tokën bujqësore. Kemi oksidin e sulfurit, kemi oksidin e azotit, merkurin, monoksidin, pastaj termocentralet shkaktojnë edhe ngrohje globale, duke e emituar edhe CO₂, dhe të mos e horrojmë edhe dëmin e tokës nga hiri, nga gropa e madhe që shkaktohet në vendin ku bëhet ajo mihje, duke e degraduar tokën, duke i degraduar edhe ujërat nëntokësore.

Krejt kjo, kur ia shtojmë që fatkeqësisht në mënyrë gjeografike ky termocentral do të ndërtohet afër qytetit më të madh, apo thënë më ndryshe afër gjysmës së banorëve të Kosovës, atëherë ne nuk mund të presim një perspektivë të mirë të përmirësimit të ajrit në këtë vend, edhe përkundër asaj që mund t'i marrim disa masa të cilat mund të jenë dobiprurëse.

E vërteta është që ne jetojmë mbi qymyr dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë aset tonin të falur edhe nga Zoti, edhe natyra, por kostoja e këtij shfrytëzimi do të jetë e madhe në aspektin ambiental, por edhe shëndetësor.

Prandaj, ndoshta ne nuk do të mund ta ndalim në tërësi, por unë pajtohem me shumë propozime shumë të mira të shumë kolegëve deputetë që i dhanë këtu, që ne sado pak ta zvogëlojmë dëmin e këtij termocentrali, i cili do t'i ndotë mushkëritë e qytetarëve tanë.

Normalisht ky përmirësim mund të vijë me përmirësimin apo me fillimin e një strategjie më të madhe të futjes së energjisë ripërtëritshme.

U përmend që kemi mundësi për energji nga era, nga dielli dhe i kemi edhe këto pasuri, të cilat mund t'i shfrytëzojmë dhe me futjen së paku të 30% të shfrytëzimit të energjisë nga era dhe nga dielli, ne mund ta zvogëlojmë sadopak edhe ndotjen.

Normalisht një prej mundësive është edhe futja e energjisë nga gazi, i cili te ne ende nuk ka depërtuar, ndërsa në vendet evropiane veçanërisht për ngrohje dhe për amvisëri është duke u përdorur me shumicë të madhe dhe shpresoj që edhe Kosova në të ardhmen do të lidhet me ato arterie të gazit dhe sado pak në amvisëri ta heqim qymyrin dhe ta fusim gazin si një alternativë për shfrytëzim.

Normalisht që mund të bëhet edhe më shumë duke i ndaluar edhe makinat e vjetra por duke u mundësuar që nëpër qytete tona të qarkullojnë edhe autobusët elektrikë, sepse edhe autobusët e vjetër dhe makinat e vjetra po shkaktojnë dëmtime.

Një prej mundësive të mëdha është forcimi i shtetit ligjor. Forcimi i shtetit ligjor nëpërmjet inspektorateve, të cilat do t'i dënojnë ndotësit ilegalë, do t'i dënojnë ata që po e shkatërrojnë ambientin gjithandej, lumenjtë e tokat, duke i shfrytëzuar edhe deponitë ilegale, pastaj duke e bërë edhe shfrytëzimin e gurëve në mënyrë ilegale.

Normalisht duhet të investohet shumë edhe në edukimin e qytetarëve për mbrojtjen e ambientit, por edhe për ruajtjen nga ndotja.

Pajtohem shumë që Kosovës gjithsesi i duhet të vendoset një taksë ekologjike. Kjo taksë ekologjike mund të vendoset edhe nga penalizimet që do t'u bëhen ndotësve, dhe kryesisht ndotës kryesor që është KEK-u, por edhe makinave të cilat duhet ta paguajnë atë taksë ekologjike.

Kjo taksë ekologjike pastaj të shfrytëzohet në të mirë të ruajtjes së ambientit dhe një prej tyre është krijimi i gjelbërimit më të madh dhe unë kisha propozuar një gjerbim, i cili do ta përfshinte pjesën rreth Obiliqit deri në Prishtinë, që do të ekzistonte si një lloj filtri i ardhjes së grimcave nga mihja sipërfaqësore.

Normalisht një prej propozimeve është që kjo taksë ekologjike të shfrytëzohet edhe për shëndetësi. Sepse kjo ndotje po i dëmton shumë pacientët tanë duke shkaktuar sëmundje të ndryshme kardiovaskulare, cerebrovaskulare, të mushkërive, alergjive e të tjera.

Me anë të kësaj takse ekologjike ne mund ta ndërtonim pse jo edhe një qendër apo një spital rehabilitues në vendet malore që i kemi shumë të mira dhe shumë të pastra dhe në këto qendra rehabilituese ta transferonim një pjesë edhe të spitaleve tona, veçanërisht spitalet e sëmundjeve të mushkërisë dhe të zemrës, dhe në këtë mënyrë edhe do t'i mbronim pacientët, por edhe do të mundësohet një rehabilitim më i mirë i këtyre pacientëve në vendet, siç janë Brezovica, Shala e Rugova e tjera, dhe në këtë mënyrë se sadopak do ta ulnim dëmin që po e shkakton kjo ndotje.

Mendoj që ka shumë propozime të cilat ne mund t'i marrim, por e di që Kosova jeton mbi qymyr, por ne duhet ta shfrytëzojmë qymyrin, e në të njëjtën kohë të mos ua nxijmë mushkëritë qytetarëve dhe të marrim masa sado pak që ta zvogëlojmë dëmin e kësaj dhe dëmi i qymyrit dhe i ndotësve tjerë që janë ndotës plus kësaj mund të bëhen me masa, të cilat duhet të fillojnë sa më shpejt dhe një prej masave që duhet të shikohet të intervenohet më së pari te KEK-u dhe ndërrimi i filtrave, që nuk janë ndërruar që nga krijimi i tyre në vitet e '80-ta, ndërsa në Kosovën A ishin ndërruar në vitin 2012. Kosova B këta filtra që nga fillimi nuk i ka të ndërruar dhe menjëherë duhet të merren masa që aty sado pak të zvogëlohet dhe të fillohet me masa tjera që erdhën edhe nga kolegët tjerë, në mënyrë që sado pakë ta zvogëlojmë dëmin që po shkakton te qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Meqenëse kur vjen fjala më vonë, disa tema dhe disa ide konsumohen.

Fillimisht më lejoni ta përshëndes vullnetin politik të krejt grupeve tona politike për të marrë pjesë në një seancë të tillë dhe të gjitha ato informacione që i dëgjova prej kolegëve do të jenë sigurisht të vlefshme për ne këtu, e veçanërisht po konsideroj për Qeverinë dhe ministrën e nderuar.

Gjendja e alarmit mbi ndotjen e ajrit e krijuar ditëve të fundit në vendin tonë, veçanërisht në komunën e Prishtinës, na e dha sot arsyen që të mblidhemi për të diskutuar si rrallëherë për një çështje, pra për ambientin, ne si Kuvend për hapat që duhet ndërmarrë Qeveria dhe ne si ligjvënës.

Prishtina ditëve të fundit është bërë qyteti me ajrin më të ndotur në botë dhe qytetarët me të drejtë po kërkojnë që çështja e ndotjes së ambientit të merret shumë më seriozisht nga Qeveria, nga Pushteti Lokal dhe nga ne deputetët, nga Kuvendi.

Indinjata ndaj veprimeve të ngadalta dhe mungesa e informacioneve kredibile nga institucionet shtetërore ka bërë që këto ditë në popullatë vërtet të shtohet edhe një lloj paniku për faktin e së vërtetës nëse shëndeti ynë është rrezikuar vërtet dhe nga kush. Pra, cilët janë shkaktarët e vërtetë?

Meqenëse kisha dëshirë të shtroj pyetje, unë përgjigjet i mora nga ministrja e nderuar për të gjitha aktivitetet, të cilat ajo i ka iniciuar, edhe pse në këtë moment e konsideroj se ndoshta është në fazë të ambicieve për t'i rregulluar këto probleme, por unë jam e bindur që çështjet që i shtroi

ministrja do t'i marrë shumë me seriozitet, e gjithashtu edhe rekomandimet që do t'i shtrojmë ne si deputetë.

Ne sot kur diskutojmë zyrtarisht nuk kemi një komunikim, ose s'kemi letra në dorë si deputetë për ndotësit më të mëdhenj të ambientit në vendin tonë.

Konsideroj se në rastet të tilla kemi nevojë që të kemi një komunikim shumë më të mirë të Qeverisë me deputetët, sepse jo shpeshherë edhe e kemi një konsensus të tillë që të flasim për tema që, siç e tha kolegja ime e nderuar, Evgjenia, në Evropë në parlamentet evropiane janë tema me prioritet shumë të lartë.

Gjithë këto ditë, qytetarët më shumë u informuan nga mediat dhe morën instruksione si të mbrohen, sesa nga ne dhe nga institucionet.

Ka pasur mundësi që pa asnjë kosto financiare të krijohet një platformë e komunikimit online me qytetarët, sepse këtë sot e mundësojnë shumë lehtë rrjetet sociale dhe një ndër rekomandimet që unë propozoj të jetë, e nderuar ministre, të vendoset menjëherë një platformë e komunikimit online me qytetarët, ku do të jepen informacionet e drejta, të vërteta e zyrtare për gjendjen e krijuar, pa krijuar panik, por të kemi pra informacione të sakta.

Njëkohësisht që në këto informacione të përfshihen edhe masat e ndërmarra me mundësi të tilla. Pra ne të jemi ata si institucione që të japim instruksione dhe informacione dhe jo ne t'i marrim pa të keqe nga gazetarët, sepse ne jemi informuar për gjendjen edhe vetë si deputetë vetëm nga mediet. Nganjëherë ka shkuar edhe në ekstrem informacioni, domethënë nuk ka pasur krejt të vërteta, por megjithatë kur qytetarët dëgjojnë edhe informacione të tilla, si për shembull nga një kryetar komune, e komuna e Fushë-Kosovës është një ndër komunat që përfshihet në ambientin më të ndotur dhe kryetari i komunës del e thotë se mund të jetë një temë e shpikur, sepse nuk ekziston, kur kjo është një e vërtetë, sepse jemi duke e përjetuar të gjithë deputetët, atëherë çka kemi për të menduar e çka mendojnë qytetarët? Pra, ka nevojë urgjente për komunikim zyrtar të ministrisë me qytetarë në një platformë, kur dihet që sot përdorimi i rrjeteve sociale është jashtëzakonisht masiv.

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj që ne kemi nevojë që t'i marrim më me seriozitet ngjarjet e tilla, sepse nuk jemi mësuar me emergjenca të tilla, mund të na ndodhin edhe raste tjera, larg asaj, me tërmete e me gjëra të tilla, e po shihet që emergjencat ende nuk e kemi komoditetin t'i kuptojmë dhe kemi nevojë të marrim praktika prej vendeve tjera.

Po ashtu më lejoni që të përshëndes edhe propozimet e kolegëve të mi deputetë për rekomandimet, veçanërisht rekomandimi edhe i Lumirit, që pse jo, meqenëse ministri i Arsimit

nuk qenka këtu, për një kohë, ndoshta një javë ose deri sa të kalojë kjo fazë, pse jo edhe të ndërpritet vijimi për nxënësit e ciklit të ulët në mësim.

Po ashtu, kryeministri nuk është këtu, por unë desha t'i them që ndoshta është rasti që afinitetin sportiv ta përdorë këtë herë, pra të dalë bashkë me ministrat në terren, dhe pse jo, t'i shohë cep më cep vetë Qeveria ndotësit, t'i shohë problemet dhe neve të na orientojë pastaj nëse ka nevojë të ndryshojmë diçka te rregullativa ligjore.

Duke e falënderuar për gatishmërinë secilin koleg deputet për informacionet që morëm, sigurisht që do të bashkëngjitemi si grup me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Muharrem, a deshe të flasësh, je paraqitur pak më herët, apo e ke tërhequr fjalën?

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Në fakt, idetë edhe debatet për temën kam përshtypjen që u thanë shumica.

Unë kam një pyetje për zonjën ministre, do të doja të ishte edhe ministri i Policisë. Pyetja ime është: Kush e morri vendimin për kufizimin e qarkullimit të makinave në Prishtinë, kufizimin që të vijnë nga qytetet tjera? Në cilin ligj e keni bazuar këtë vendim? A e dini, për shembull, që kjo masë është segregacion? Unë do të doja për shembull që të na jepni një sqarim, sepse e kam përshtypjen që keni bërë një vendim shumë problematik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A dëshiron që të japë përgjigjen ministrja Reshitaj. E ka fjalën.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit për pyetjen deputet!

Faktikisht, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë në vazhden e planit dhe aktivitetit afatshkurtër atë që e kemi quajtur emergjent ka menduar edhe subvencionimin e transportit urban në të gjitha komunat, përkatësisht aty ku niveli i ndotjes së ajrit është më i lartë. Kjo ka qenë fazë dhe masë emergjente në këtë situatë, ose nevojë.

Prandaj, me rritjen e nivelit të ndotjes së ajrit në regjionin e Prishtinës dhe shqetësimin e madh të qytetarëve të këtij regjioni, ne i kemi rekomanduar Komunës së Prishtinës që nëse ne arrijmë t'ua subvencionojmë transportin urban që në pikat e nivelit më të rritur të ndotjes së ajrit në intervale kohore të caktuara, të bëjë një zgjidhje që të paktën të kemi mundësi që automjetet si pjesë ndotëse ndër ndotësit e ambientit të reduktohen në ato zona në të cilat niveli i ndotjes së ajrit është më i lartë.

Prandaj, ky vendim është marrë nga Komuna e Prishtinës dhe ne kemi e kemi subvencionua transportin urban.

Ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me siguri, nëse ministri do, mund ta marrë fjalën, mirëpo rekomandimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka qenë që të reduktohet transporti urban dhe atë në intervalet kohore në pikat më ndotëse të kryeqytetit.

Ne tani e disa muaj, grupi punues është duke bërë identifikimin e pikave ndotëse në kryeqytet, meqë Komuna nuk ka qenë e konsoliduar, sepse është përgjegjësi e saj, dhe mbi 100 pika ndotëse, 130, 135 janë deri tani të identifikuar.

Kemi menduar që me subvencionim të transportit urban, mund të reduktohet niveli i ndotjes. Ky do të duhej të ishte një projekt afatgjatë dhe i qëndrueshëm i Komunës së Prishtinës për të promovuar transportin urban në kryeqytet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse ia bërë një pyetje, ministri është i gatshëm të përgjigjet. Zoti Sefaj, e keni fjalën!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues,

Faleminderit për pyetjen. U përgjigj edhe kolegja, vendimi është marrë nga komuna, patjetër që ne duhet të asistojmë dhe të jemi prezentë në këto raste. Por, po kyçem në temë, është e rëndësishme, është nacionale, kombëtare. Duhet ta kemi një orientin nacional rreth zgjedhjes së çështjes së ndotjes atmosferike. Mendoj që iniciativa që është marrë nga Komuna e Prishtinës mund të duket si iniciativë antipopullore dhe mund të ketë një konotacion të tillë, por është një vendim i guximshëm dhe është një hap konkret, i cili është marrë dhe e ka rëndësinë e vet, sepse është një fillim.

Mendoj se çështjet aq të mëdha nacionale duhet ta kenë një fillim, dikush duhet të fillojë një proces. Kishte një veprim konkret, ata që ishin në qytet e panë që qyteti ishte pa makina, kishte më shumë këmbësorë. Natyrisht, e dimë që kjo ka shkaktuar edhe ndoshta pakënaqësi në pjesë të tjera, për këtë arsye është angazhuar policia dhe besoj në mënyrë mjaft të suksesshme ka orientuar ngasësit e makinave, nuk ka pasur të drejtë të sanksionimit të tyre, sepse sanksionimet parashihen me ligj. Por, le të themi që kjo iniciativë ndoshta minimalisht ka ndikuar edhe në mentalitetin tonë, por ndoshta në uljen e ndonjë përqindjeje në sasinë e mikrogrimcave në ajër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i dëgjova kolegët, dëgjova ministrat, kishte propozime shumë të mira, jashtëzakonisht të mira, gëzohem për këto propozime, por kjo dëshmon domethënë se çështja e ndotjes në përgjithësi është një çështje me të cilën ne nuk jemi marrë seriozisht asnjëherë. Salla e Kuvendit, prania e Qeverisë e dëshmon këtë.

Sidoqoftë, unë po dua të tregoj që krejt kjo çka ka ngjarë, nuk është e rastësishme. Jo që nuk është tërhequr vërejtja, vërejtja është tërhequr së paku që 7 vjet, unë e di. Këtu i kam të gjitha raportet e Avokatit të Popullit prej vitit 2010. Një nga një, edhe hapeni cilindro prej tyre, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, edhe lexojini, ju lutem, shikoni çka është thënë në këto raporte për gjendjen alarmante. Unë po ju tregoj, çfarë vlerash statistikore, edhe pse statistikat rrejnë, sepse është vetëm një premisë për krahasim, çka domethënë 220 edhe 430, askush nuk e di. Por, unë po ju them kështu, vitin e kaluar në periudhën tetor-dhjetor 2016, ky pragu i alarmit që po përmendet ka qenë 430, më i lartë se këtë vit. Mirëpo, shyqyr që na ka ardhur Ambasada Amerikane e i kemi miqtë e fortë, e kur të na i tërheqin veshët ata, bëhemi si pulat dhe i marrim gjërat seriozisht. Unë po them se jam shumë i lumtur që e kemi atë ambasadë këtu, edhe dinë të na e tërheqë vërejtjen, mandej ngritën të gjithë, kryetari i Kuvendit, kryetari i Qeverisë, ministrat, sepse Zoti ua ka tërhequr vërejtjen, kjo është e drejtë. Shyqyr që Zoti na është afruar kaq shumë, përndryshe kishim mbaruar krejt.

Unë po dua të lexoj vetëm një pjesë të raportit të vitit 2012, që kjo që po thuhet sot, edhe po themi ne është rastësi, e nuk është rastësi. Ndotja e vazhdueshme e mjedisit, edhe këtu janë disa, ajri është njëra nga to. Domethënë, ndotja e ajrit vjen nga praktika e djegies së gomave, djegies së hamulloreve, edhe në verë ne kemi ndotje të madhe, nuk kemi veç dimrit, më 1 Maj digjen gomat në pjesë të ndryshme të Kosovës nuk kalohet prej erës. Lërin këto pjesë domethënë, KEK-un, “Sharr-Cem”-in, “Ferronikelin”, edhe automjetet. Por, ne kemi dëmtim të burimeve edhe ndotje të ujit. Në komunën e Gjilanit, që e njoh mirë, por jo në komunat e tjera, është gjendja e njëjtë.

Asnjë burim natyror, asnjë rrjedhë natyrore e ujit në komunën e Gjilanit nuk është e pandotur, këtë duhet ta kemi parasysh. Ndotja e tokës, zhurma, krejt këto janë çështje për të cilat tërhiqet vërejtja tani e dhjetë vjet ose më shumë. Unë pajtohem me atë që pasojat nuk janë dhe ndotja nuk është vetëm e këtyre viteve, por nxjerrja e zhavorrit i shkatërron lumenjtë, nxjerrja e gurëve për ndërtimin e rrugëve, dhënia e lejeve edhe shkatërrimi i ambientit, rrëshqitja e dheut nëpër vende të ndryshme janë alarmante, janë gjëra për të cilat tërhiqet vërejtja së paku tani e dhjetë vjet në mënyrë ligjore. Ekziston një institucion, për të cilin tani paguhen 1 milion e gjysmë në vit buxhet për t’i prodhuar këto raporte. Unë s’jam më në atë pozitë dhe gëzohem që s’jam. Paguhen rreth 60-70 njerëz të punojnë për të tërhequr vërejtjen, askush nuk i merr parasysh.

Vjen zoti ambasador amerikan, e tërheq veshin, del në rrugë, të gjithë alarmohen. A po tregohemi pak servil, pak të pafytyrë, pak që s'kemi asnjë respekt për institucionet që i paguajmë vetë. Thotë dikush: nuk kemi strategji, nuk kemi ligje. Ne e kemi Ligjin për shëndetësinë publike, ky ligj parasheh një institut që thotë se hulumton shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit dhe që dëmtojnë shëndetin publik, si dhe propozon masa mbrojtëse. Cilat janë masat mbrojtëse? Cilat janë raportet? Cilat janë hulumtimet e këtij institucioni? Ku i kemi? A merren parasysh ato? Jo, kurrë hiq! Asnjëherë!

Ne kemi një ligj prej 2010-ës për mbrojtjen e ajrit, ky ligj nuk është më i miri në botë, por i ka disa nene shumë të mira, cakton kush kontrollon dhe thotë që është një Inspektorat që mund të vërë gjoba mandatorë pa i dërgua në gjykatë. Ato gjoba nuk janë të ulëta, por janë relativisht të mëdha dhe në bazë të dëmtimit që e bëjnë subjektet e ndryshme në Republikën e Kosovës. Sa gjoba i ka vënë ky Inspektorat? Unë pajtohem me fjalën e zotit Zeka, që flet për krimin që bëhet, e ky krim bartet me pasojat në ndotjen e ambientit tonë, qoftë nafta, qoftë shitja e thëngjillit, qoftë dëmtimi i lumenjve, qoftë dëmtimi i natyrës, nxjerrja e gurëve, mirëmbajtja ose keqmbajtja e deponive të bërllokut që i kemi nëpër Kosovë.

Unë nuk po dua ta lexoj ligjin, sepse ligji ekziston, ligjin e kanë edhe ministrinë. Po, më habiti pak edhe qasja e ministres, unë po dua t'i them diçka. Zonja ministre, edhe ju ministra, edhe kryeministri, i keni do obligime ligjore ndaj institucioneve të tjera. Një obligim ligjor juaji është t'i përgjigjeni në kërkesa dhe letra Avokatit të Popullit brenda 30 ditësh. Unë këtu e kam një letër që jua ka dërguar Avokati i Popullit ex officio, të datës 24 nëntor 2017, asnjëherë s'ka marrë përgjigje për çështje të ambientit, për çështje të ndryshme. Mbajeni në mend e mos u thirrni mandej në ligjin dhe në respektimin e tij, sepse ju jeni e para, bashkë me kryeministrin, por sidomos me kryeministrat e tjerë që nuk e respektoni këtë ligj.

Kemi dy letra të tjera që i janë dërguar ministrit të Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ivan Teodosijeviq, më 19 dhjetor dhe më 25 korrik 2017. Kurrë asnjë përgjigje s'e kam marrë. Janë të gjitha këto raporte me rekomandime. Rekomandimet janë të obligueshme për institucionet e Republikës së Kosovës. Kurrë asnjë rekomandim, asnjëherë, në lidhje me ambientin, s'po flas për gjëra të tjera, nuk është marrë parasysh. Në të gjitha rastet, në të vërtetë kur ka ardhur radha për të folur për ndotjen e ambientit, për shkatërrimin, degradimin e ambientit në Republikën e Kosovës, Avokatit të Popullit nuk është lejuar të flasë, i është marrë fjala. Asnjë anëtar i Qeverisë, në asnjë rast kur ka folur Avokati i Popullit, ka paraqitur raportet, këto raporte janë këtu, merrni me rekomandime, unë jua tregoj edhe faqet që kanë nga 3,4,5, 6 faqe për shkatërrimin e ambientit në Republikën e Kosovës, në mesin e tyre edhe ndotjen e ajrit, dhe kurrë nuk janë marrë seriozisht. Mos thoni sot, dje. Sot jua ka tërhequr veshin Ambasada Amerikane, shumë mirë ka bërë, unë ia di për nder, edhe shumë mirë që e kemi marrë seriozisht. Po shpresoj që kjo ambasadë edhe ambasadat e tjera e tërheqin veshin pak më shpesh, e ne bile së paku një herë në Parlament, se Qeveria jo se jo, dëshmojmë një herë prej zorit se e kemi

ndërmend të bëhemi solidarë me gjeneratat e ardhshme. Fjala e fundit, po flas për këtë gjeneratë, ne jemi duke u dëshmuar si gjenerata më josolidare në historinë e vendit tonë. Ne ua kemi shkatërruar ambientin gjeneratave të ardhshme, ujin, ajrin dhe tokën, kjo është e tmerrshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Sami! Zonja Reshitaj, po shkurt, janë 30 e sa deputetë të paraqitur.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

Atëherë, shumë shkurt dua t'i përgjigjem deputetit. Në të kaluarën është shumë e vërtetë që ka munguar një bashkëpunim dhe ulje në një tavolinë të përbashkët për të diskutuar për çështje kaq madhore dhe kaq etike, siç është edhe mbrojtja e mjedisit. Problemi është me vetëdijesimin institucional, por edhe të shoqërisë tonë sa i përket rëndësisë që ka investimi në mbrojtje të mjedisit.

Derisa shtetet e tjera në çdo kontratë, shtetet e zhvilluara që e nënshkruajnë ndajnë deri në 30% fond që i shkon mjedisit, në Kosovë kjo është diku 0.8%, nëse s'gaboj. Ndërsa, sa i përket Avokatit të Popullit, i nderuar deputet, nuk ka nevojë Avokati i Popullit të na dërgojë vetëm letra. Unë e kam takuar Avokatin e Popullit dhe ne i kemi dëgjuar të gjitha këshillat e tyre, por edhe i kemi dhënë sugjerimet tona dhe kemi krijuar një bashkëpunim, i cili nuk ka nevojë vetëm të mbetet në letra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Imet Rrahmani e ka fjalën, përgatitet Faton Topalli.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Të nderuar qytetarë,

Natyrisht që sot po diskutojmë për një çështje shumë me rëndësi për qytetarët e Kosovës, por duhet të theksoj, si theksuan edhe disa parafolës, që nuk mund të trajtohet ndotja e ajrit ndaras nga ndotja e ujit, e tokës dhe në përgjithësi e ambientit. Ndotja e ambientit, si rrjedhojë edhe e ajrit është dukuri shumë e shprehur në botën moderne. Edhe në vendet ku masat e mbikëqyrjes së ndotjes janë shumë rigorozë, ka opinione shumë shqetësuese se ambienti po degradohet dhe se e ardhmja po rrezikohet seriozisht. Kosova jo që nuk bën përjashtim në këtë të keqe të përgjithshme, por sipas të dhënave të viteve të fundit, është prijëse në regjion.

Pra, fatkeqësisht jo që kemi program për mbrojtje të ambientit që zbatohet me rigorozitet, po shpesh masat e ndërmarra janë aq sipërfaqësore dhe joadekuate sa që në esencë nuk prodhojnë asgjë. Hiq këtu angazhimin e profesionistëve të shëndetit publik dhe disa iniciativa nga shoqëria civile, masat e ndërmarra nga instancat e ndryshme qeveritare, sikurse po ndodh edhe tash, kanë ardhur gjithmonë vetëm kur gjendja e ndotjes ka marrë përmasa alarmante. Pra, përpos

deklaratave shumë herë vetëm politike, hartimeve të planeve dhe strategjive të mira në dukje, nuk ka aksion dhe vendosmëri që problemit t'i shkohet deri në fund. Ndryshe, si mund të shpjegohet kjo gjendje e frikshme për shëndetin publik, e krijuar në Prishtinë dhe jo vetëm në të, sepse hiq më mirë nuk është gjendja as në shumicën e qyteteve të tjera në Kosovë.

Emetimi i gazrave dhe i grimcave të dëmshme nga termocentralet në Obiliq, emetimi i gazrave dhe i grimcave të dëmshme nga oxhaqet e shtëpive, si pasojë e djegies së thëngjillit dhe materialeve drusore që nuk kontrollohen nga askush, emetimi i gazrave nga djegia e naftës me cilësi të kontestuar prej automjeteve në gjendje të tillë teknike gjithashtu të kontestueshme, që në rrethana të tjera dhe në vende të tjera nxirren nga qarkullimi mu për shkak të mbrojtjes së ambientit, deri te sjellja aspak pozitive në kuptim shëndetësor të individit, kanë bërë që ne sot të kemi një situatë alarmante dhe të jemi të detyruar të ballafaqohemi me vendime aspak popullore dhe të kontestueshme.

Pra, sot ne nuk duhet të angazhohemi shumë për të kuptuar se si e kemi gjendjen e ajrit dhe ambientit, sepse këtë me vite po na e thonë ekspertët e shëndetit publik dhe kohët e fundit, edhe matja e Agjencisë së Ambasadës Amerikane. Por, ne duhet të angazhohemi që ambienti dhe problematika e ruajtjes së tij të trajtohet shumë seriozisht dhe duke ditur kompleksitetin që ka nga të gjitha anët dhe nga të gjithë aktorët. Angazhimi i të gjithë neve, Qeverisë, shoqërisë civile, ambientalistëve, profesionistëve të shëndetit publik, duhet të prodhojë një plan veprimi që do të mundësojë daljen nga kjo situatë emergjente dhe njëkohësisht ky plan veprimi të jetë brenda një strategjie afatgjate për ruajtjen e ambientit dhe sanimin e dëmeve që kemi shkaktuar deri tash. Edhe më herët, po nga këto ulëse këtu të Kuvendit, shumë deputetë para neve kanë paraqitur me të drejtë shqetësimet jo vetëm për potencialisht ndotësin më të madh, termocentralet, por edhe shqetësimet për dëmtimin me përmasa kriminale të pyjeve, ndotjen e lumenjve dhe shkatërrimin e rrjedhave të tyre. Dëmtimin e tokave bujqësore deri te asgjësimi i materialeve të dëmshme në mënyrë joprofesionale dhe në ambient të hapur.

Përpos ndotësve kampionë, të themi, që u cekën deri më tash, unë jam kureshtar të di se sa është numri i gomave të automjeteve që importohen brenda një viti. A ka ndonjë kontroll se ku dhe si përfundojnë të vjetrat. Disa thashetheme që dëgjohen këto ditë janë shumë shqetësuese, se si përfundojnë dhe ku përfundojnë ato goma. Pastaj, asgjësimi i mbetjeve organike, si për shembull, mbetjet kockore në bizneset që tregtojnë mishin, deri te asgjësimi i materieve kimike, barnave dhe vajrave motorike, me procedura dhe ambiente të dyshimta, paraqesin burim potencial të ndotjes shumë serioze.

Natyrisht, nuk dua të përsëritëm, sepse kolegët e mi thanë shumë nga ajo se çka paraqet si rrezik dhe çka është burim i ndotjes, unë dua vetëm të nënvizoj disa nga propozimet që mendoj se janë të rëndësishme dhe nuk duhet të anashkalohej. Masat e propozuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik duhet të mbështeten pa asnjë rezervë. Unë këtu habitem se si nuk u ngrit

asnjëherë nevoja e kthesës së madhe në implementimin e Ligjit për kontrollin e duhanit. Propozoj që ai eko-fondi që u përmend, ose akciza ekologjike, të cilën e paguajmë, të fillojë të shfrytëzohet krahas vendosjes së një akcize të veçantë për produktet potencialisht të dëmshme, si duhani, nafta, benzina, alkooli, gomat, vajrat motorike e tjera, për shëndetësi dhe për ruajtjen të ambientit. Ky buxhet shtesë, këto fonde shtesë, natyrisht që do të mund të përdoren për krijimin e kapaciteteve për eliminimin e pasojave të ndotjes, por edhe për parandalimin e ndotjes në tërësi. Gjithashtu, mendoj se individit luan rol shumë me rëndësi në krejt ciklin e ruajtjes së ambientit, respektivisht të ndotjes së tij.

Prandaj, propozoj që në shkollat tona, në të gjitha nivelet, domosdoshmërisht të zhvillohen programe nga fusha e shëndetit publik. Në televizione dhe në gazeta të mundësohet hapësirë ku do të promovoheshin aktivitete edukative parandaluese, pse jo edhe denoncime të keqbërësve, pa dallim. U fol edhe se fusha, respektivisht veprimtaria e gurthyesve dhe kompanive të ndryshme që i shfrytëzojnë rrjedhat e lëmenjve dhe fushat për nxjerrjen e rërës dhe materialeve tjera për ndërtimtari, është njëri nga ndotësit. Prandaj, unë propozoj që edhe një herë në strategjinë që do të hartohet, po shpresoj, të rishikohen lejet dhe të shihet se sa këto veprimtari ndikojnë në ndotjen e ambientit, në përgjithësi.

Ndërprerja e prerjeve të pyjeve të drurëve jo vetëm që duhet të vihet në spikamë që tash menjëherë, por unë mendoj se duhet të ndëshkohen të gjithë ata që e kanë lejuar një masakrim të tillë të pyjeve tona. Në çfarëdo mase, amnistia e të gjithë atyre që kanë qenë kompetent për parandalimin e prerjes së pyjeve, besoni do të na paraqesë probleme për të ardhmen. Unë dua t'i jap vetëm dy shembuj sesi shtetet tjera kanë shkuar deri në imtësi në mbrojtjen e ambientit dhe në eliminimin e ndotjes së ajrit.

Shumë shtete e kanë rregulluar, për shembull, përdorimin e qeseve të najlonit ose plastike nëpër markete dhe biznese të ndryshme tregtare. Atje nuk lejohet të jepen falas këto qese, sepse mund të shërbejnë si burim i ndotjes. Prandaj, pse të mos e bëjmë edhe ne. Shumë shtete e kanë të rregulluar edhe daljen në komunikacion të automjeteve të rënda, të cilat punojnë në punishte të ndryshme ndërtimore, ose kyçjen në komunikacion të automjeteve bujqësore. Atje nuk mund të kyçesh në vende serioze, ku mendojnë shëndosh dhe seriozisht për ambientin, me goma të papastra, sepse ajo rrit masën e pluhurit dhe rrjedhimisht edhe ndotjen.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të mos harrojmë se Kosova e ka popullatën më të re në Evropë. Si rrjedhojë, do të duhej edhe sëmundshmërinë, pothuajse për të gjitha sëmundjet, ta kemi më të ulëtën. Por, është e kundërta, ne për shumë sëmundje e kemi më të lartën në Evropë. Pra, të mundohemi që sëmundjet që ndikohen direkt nga ambienti t'i zvogëlojmë me krijimin e një ambienti të pastër, të këndshëm dhe mbi të gjitha të shëndetshëm, duke i luftuar dukuritë negative, së pari tonat si individë, e

pastaj edhe të komunitetit. Sot kemi shembuj të tillë ku komuniteti ka ecur para shtetit dhe Qeverisë. Unë po i përmend vetëm tri fshatra në komunën e Gjilanit, fshatin Dobërçan, Pogradjë e Velekincë e Vjetër. Ju ftoj që nga kureshtja t'ju vizitoni këto fshatra dhe ta shihni që vullneti i mirë dhe komuniteti çfarë mund të bëjnë dhe bëjnë shumë më shumë se Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e thirra Faton Topallin. Fatoni nuk është, hiqe prej listës. Driton, urdhëro!

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Kam përshtypjen që nga alarmimi që është krijuar, nga urgjenca e kësaj situatë, po kemi pak shmangie nga ai perceptimi i drejtë i realitetit, si me masat që po propozojmë t'ju ndërmarrim, ashtu edhe me vlerësimin e situatës ndoshta si tepër urgjente në Komunën e Prishtinës, e duke mos marrë parasysh që jetojmë në një vend shumë të vogël dhe pashmangshëm secila komunë dhe secili cep i Republikës së Kosovës është i prekur nga ky fenomen.

Prandaj, po dua që për një moment ta zhvendos këtë perspektivë dhe ta trajtojmë, ose ta shohim Republikën e Kosovës nga një vend tjetër normal, ashtu siç duhet të duket realisht. Pra, një vend i vogël me vetëm 1,7 milion banorë, me një sipërfaqe të vogël, para 18 vjetësh i dalë nga një okupim, dhe me parakushte ideale për një ndotje të vazhdueshme dhe dëmtim të vazhdueshëm të shëndetit, si pasojë e kësaj ndotjeje dhe një elitë politike që merr përsipër qeverisjen e këtij vendi dhe një eksperiment me këtë vend dhe me ndotjen që ndodh këtu. Zakonisht këto eksperimente bëhen në kafshë, mirëpo parakushtet ishin shumë të mira që ta shmangim këtë hap dhe në vend se ta bëjmë siç bëhet me rrugë shkencore, të eksperimentojmë me 1,7 milion qytetarë të kësaj Republike. Të eksperimentojmë se çfarë do të thotë për shëndetin një ngarkesë e tillë me dioksid të sulfurit, me monoksid të karbonit, me grimca të madhësive të ndryshme, me arsen, me merkur, me plumb dhe me metale të tjera të rënda.

I kishim burimet, i kishim dy termocentrale shumë të vjetra, të dëshmuara si shumë të dëmshme për shëndetin, vazhduam me importimin pa kurrfarë vlerësimi, kurrfarë rigoroziteti të naftës, me djegien e materialeve të ndryshme, duke pasur mjaftueshëm informata që janë tepër të dëmshme për shëndetin dhe këtë e bëjmë deri më sot.

Bota i kishte këto informacione dhe nuk kishim nevojë që ne të bënim eksperiment me qytetarët tanë. Në vitin 2013, Banka Botërore na tha që ky eksperiment është interesant, bëhet për herë të parë në planet, mirëpo këto kafshët eksperimentale po ju vdesin shumë. Thanë i keni 852 qytetarë që po ju vdesin si pasojë e kësaj ndotjeje, pra 852 qytetarë për çdo vit. Ky është raport i vitit 2013. Mirëpo, asnjë veprim nuk ndodhi. Përkundrazi, në vitin 2015 e hoqëm edhe kufizimin për moshën e makinave, duke pasur makinat për 8 vjet më të vjetra se mesatarja në Bashkimin Evropian. Asnjë masë tjetër deri në vitin 2018, kur u desh që një ambasadë, pra Ambasada

Amerikane, Komuna e Prishtinës, me disa matës t'i alarmojnë vetë këto objektet e eksperimentimit, që ishin qytetarët e Republikës së Kosovës. E si pasojë e këtij alarmimi, të alarmohen edhe institucionet, e të alarmohen edhe krye-eksperimentuesit me qytetarët tanë. Këtu mendoj për Partinë Demokratike të Kosovës, që bart përgjegjësinë më të madhe me qeverisjen në dhjetë vjetët e fundit dhe me kryetarin e saj, i cili e thirri këtë seancë, por siç e pamë e thirri vetëm formalisht sa për ta treguar një alarmim dhe e lëshoi që nga fillimi i saj.

Kur qytetarët trajtohen kështu, si kafshë eksperimentale, natyrisht që edhe reagimi është improvizues, është kaotik dhe nuk përputhet me nevojat emergjente. Pra, u përmendën disa masa. Unë mendoj që ka shkarje serioze në mënyrën sesi është trajtuar ky problem. Duhet marrë parasysh rrethanat socio-ekonomike, kur një qytetari i themi se nuk guxon të djegësh thëngjill. Nëse thëngjilli zëvendësohet me masë drunore, nuk kemi arritur gati asgjë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Është pak a shumë e njëjta gjë. Është shumë e dobishme që të kemi rritje të hapësirave të gjelbra, por më duhet të ju kundërshtoj të gjithëve që propozuat si përgjigje në situatën aktuale, se ndotja me të cilën po ballafaqohemi nuk ka të bëjë me hapësira të gjelbra. Pra, nuk është Kosova vend që do ta shërojë planetin nga ngrohja globale, kemi të bëjmë me grimca prej 2,5 dhe 10 mikronë, të cilat nuk thithen prej gjetheve dhe prej drunjve.

Një masë që nuk u përmend, e përmenda dje në Komisionin për Mjedis dhe Bujqësi, që ka dhënë sukses në shumë vende, është efikasiteti i djegies së materialit për ngrohje. Pra, ajo që është treguar si produktive ka qenë subvencionimi i stufave, të cilat janë në gjendje që me efikasitet ta djegin edhe qymyrin, edhe drurin. Kjo do të mund të ndodhte me një iniciativë dhe do të ishte e përballeshme nga Ministria e Mjedisit dhe nga komunat tjera.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë nuk mendoj se jemi në mesin e ekspertëve. Unë i dhashë disa gjëra që besoj se janë të rëndësishme në rrugën që duhet ta ndjekim dhe të cilat nuk janë propozuar deri më tani. Kjo çështje duhet t'u lihet në dorë ekspertëve, duhet të kemi një hulumtim, të cilin nga mbledhja e komisionit dje e pashë që nuk e kemi. Ministria e pranon, besoj që është më e drejta këtu kur thotë që nuk e dimë se cilat janë masat, ose cila është renditja e ndotësve. Kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit thotë që 30% janë termocentralet, 30% transporti, 30% djegia për ngrohje. Drejtori i KEK-ut na tha që termocentralet nuk ndikojnë fare në grimcat që emetohen dhe që vijnë në komunën e Prishtinës. Ministri iu referua një punimi tjetër me të dhëna tjera, prandaj mendoj se e para që duhet të bëjmë është një hulumtim serioz në lidhje me ndotjen, jo vetëm në komunën e Prishtinës, por edhe në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Për fund duhet thënë se gjithçka e ka një kauzalitet, ashtu siç fëmijët vdesin nga kequshqyerja, qytetarët vdesin nga trajtimi i mangët shëndetësor. Edhe në rastin kur 852 qytetarë vdesin në vit, ka një kauzalitet në mes të keq-qeverisjes, nivelit të lartë të korrupsionit, insentivës për ta marrë një mandat për t'u pasuruar për 4 vjet pa asnjë reflektim se çka prodhojmë për qytetarët dhe për

cilësinë e jetës së tyre, natyrisht se e sjell edhe te rasti jonë një lidhje të drejtë ndërmjet të qeverisjes, sidomos në dhjetë vjetët e fundit dhe kësaj tragjedie që ndodh me qytetarët me gjithë këto humbje të jetës për çdo vit. 852 qytetarë që vdesin, duhet t'ua themi të gjithë qytetarëve, janë 852 qytetarë që vriten nga ndotja. Kur një gjë është e parandalueshme dhe nuk ndodh, kjo nuk mund të trajtohet ndryshe veçse si një krim ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë i përshëndes ata qytetarë që e kanë gjetur gatishmërinë për të dalë dhe për të protestuar. Mendoj se një gjë e tillë duhet të ndodhë edhe më tutje, duke e njohur mënyrën sesi këto institucione e neglizhojnë këtë problem pas kalimit të krizës. Mendoj se presioni publik është i vetmi që mund të sjellë një trajtim serioz dhe një ndalje të këtij krimi që po ndodh me qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Është e vërtetë që janë thënë shumë gjëra dhe ndoshta fjalimi im do të përsërisë një pjesë të diskutimeve, që i thanë kolegët. Mirëpo, dua në radhë të parë ta përshëndes iniciativën që sot të diskutojmë lidhur me këtë temë, po ashtu edhe vullnetin e mirë të atyre që sot kanë protestuar në shenjë solidariteti, duke kërkuar nga institucionet që të merren masa.

Dua të pajtohem me një pjesë të kolegëve, të cilët sot thanë që vendimi i ministres, realisht i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, për ta ndaluar qarkullimin e veturave ka qenë, për mua, i ngutshëm për faktin se gjatë gjithë ditës së djeshme jam munduar të dëgjoj ekspertë të shumtë që kanë diskutuar lidhur me këtë vendim. Mendoj se masat e ndërmarra nga ministria e komuna për kufizimin e automjeteve nuk ka qenë të bazuara në ligj dhe kjo u tha edhe nga kolegu Nitaj, që sot diskutoi këtu. Mendoj se në situata të tilla duhet të kërkohet shpallje e gjendjes së jashtëzakonshme me vendim formal, e pastaj të përcaktohen veprimet. Ndonëse Prishtina ka qenë sot pa makina, një pjesë e rrugëve të qytetit nuk e kanë zbatuar këtë vendim të ministrisë dhe kur merren vendime të tilla, kërkoj nga ministrja, që është sot këtu, të mos merren vendime pa u analizuar mirë situata dhe vendime ad hoc, të cilat mund edhe të shkaktojnë tollovi.

E kemi parë gjatë ditës që qytetarë të shumtë kanë pasur tollovi, qoftë në trafik, meqë nuk kanë qenë shumë të përgatitur për vendimin e sotëm. Prandaj, në rast se institucionet marrin vendime të tilla është mirë që vendimet të jenë mirë të analizuara, në mënyrë që të mos shkaktojmë telashe për qytetarët e vendit. Kemi parë varg të madh të qytetarëve që kanë pritur që të futen në transportin publik. U tha edhe sot që transporti nuk ka mjaftuar për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve që të futen dhe të kryejnë obligime, qoftë të shkojnë në punë, qoftë t'i kryejnë obligimet gjatë ditës.

Në rastin konkret mendoj se e gjithë barra bie mbi qytetarin për të mos e përdorur makinën në qytet si masë mbrojtëse, ndërsa shteti nuk jep llogari për kualitetin e karburanteve që i ofron qytetarit, meqë nuk ka pasur asnjë kontroll paraprak të karburanteve në përdorim. U tha që alarmi është dhënë më herët për ndotjen e ajrit dhe ne vetëm sot, në fakt gjatë ditëve të fundit, po diskutojmë për pasojat që janë marrë gjatë këtyre ditëve ka pasur një alarm dhe Komuna e Prishtinës do të mbajë një seancë të jashtëzakonshme. Është e saktë që brenda Klinikës Universitare ka pasur një rritje enorme të të sëmurëve, sidomos më të moshuarit, që kanë kërkuar trajtim shëndetësor. Mendoj se burimet e ndotjes janë ato që u thanë edhe më herët, do të thotë nga ngrohja e përdorur gjatë dimrit, nga automjetet e vjetruara, pastaj nga djegia e shtuar e karburanteve, nga mungesa e hapësirave të gjelbëruara e shumë e shumë telashe në planifikimin urbanistik, të cilat sot janë përmendur nga kolegët deputetë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në rast se ne sot do ta nxjerrim një rezolutë, sepse u tha paraprakisht që në fund të diskutimeve Kuvendi do të votojë një rezolutë, unë i kam dilemat e mia nëse kjo rezolutë do të arrijë që të implementohet dhe të zbatohet në tërësi, meqë në të kaluarën ky Kuvend ka votuar legjislacion që kërkon mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Është legjislacioni që është miratuar në vitin 2010 dhe që nuk është zbatuar asnjëherë në këtë situatë të krijuar, përkatësisht nëse ndalemi të neni 24, në 9 dispozitat e rregullon veprimin e institucioneve dhe përgjegjësinë që kanë. Për më tepër, në dy dispozitat e fundit po ashtu përcaktohen detyrimet edhe të operatorëve ekonomikë që ndotin ambientin, prandaj mendoj që në rend të parë duhet të shtohet përgjegjësia e autoriteteve publike për zbatimin e ligjit.

I njëjti ligj përmban edhe dispozita ndëshkuese për operatorët ekonomikë që e shkelin ligjin dhe këto dënime sillen prej 15 mijë deri në 50 mijë euro. Ajo që realisht ndodh në praktikë është se këto inspektorate që funksionojnë në kuadër të ministrisë nuk i zbatojnë asnjëherë ndëshkimet. Dhe, është e kotë nëse ne sot diskutojmë këtu dhe ministria nuk ndërmerr masa që këta inspektorë që janë në terren t'i zbatojnë ndëshkimet karshi atyre që e ndotin ambientin.

Nëse pyetemi për numrin e rasteve, që realisht kanë shqiptuar gjobë, vërehet një dështim i zbatimit të Ligjit për ndëshkimin e operatorëve ekonomikë. Inspektoratet zakonisht e bëjnë, të them, një lojë juridike për kinse dërgimin e çështjeve në Gjykatën për Kundërvajtje dhe gjoja për ta krijuar përshtypjen se kanë iniciuar procedurë, por ligji i autorizon inspektoratet për të shqiptuar gjobë, e pastaj, nëse pala ka ankesë mund të drejtohet në gjykatë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë pres që rekomandimet që do të dalin nga seanca e sotme, në fakt rezoluta që do të votohet sot në seancën e Kuvendit të Kosovës, t'i ketë edhe masat e saj dhe këto masa të implementohen seriozisht nga institucionet. Po ashtu, kërkoj edhe një herë nga ministrja dhe ministri i

brendshëm, që e kemi këtu, që për situata të tilla të informohen pak më detajisht dhe mundësisht që të mos merren masa ad hoc, si në rastin e sotëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Blertë! Të nderuar deputetë,
Ka kërkesa për ta ndërprerë seancën. Por, lista është tepër e gjatë, na shkojnë edhe gati pesë ore diskutime në këtë formë. A po doni ta lëmë për nesër, e kthjellemi më mirë? E lëmë pra vazhdimin për nesër, në orën 10:00.

* * *

E enjte, 1 shkurt 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 31 janar 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Si duket tymi është hequr dhe interesimi për debat ka rënë. Po fillojmë aty ku e kemi lënë dje.

Sot në listë për të diskutuar është paraqitur, edhe dje ka mbetur pa e marrë fjalën zonja Baftiu. E keni fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar, i cili nuk është i pranishëm,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk është i rastësishëm ky reagim i vonuar i institucioneve qeveritare sa i përket ndotjes së ajrit, sepse në çdo fushë e shohim të njëjtën dukuri, indiferencën dhe papërgjegjshmërinë, derisa pasojat kthehen në fatale.

Qeverisjet e deritanishme i kemi parë shumë herë pas presionit të madh publik të merren me pasojat, në vend që të merren me parandalimin e rasteve apo fenomeneve.

Si pasojë e mosmarrjes së masave adekuate në mbrojtjen e ambientit, ne jemi sot përball katastrofave ambientale.

Ndotja e ajrit në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë, Fushë-Kosovë, Kastriot, Gjilan, kapin normat e jashtëzakonshme, pasoja të mëdha për shëndetin.

Vetëm për shkak se prej pak kohëve të dhënat e një matësi po bëhen publike dhe qytetarët po e shohin me shifra normën e ndotjes, institucionet qendrore të Republikës së Kosovës po mundohen t'i marrin disa masa plotësisht ad hoc për të ulur sadopak nivelin e ndotjes së ajrit, masa këto të mirëseardhura, por jo të mjaftueshme.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor jo vetëm këtë vit, por prej ekzistencës së saj ka pasur si detyrim ligjor të hartojë dhe të kujdeset për zbatimin rigoroz të politikave të mjedisit. Ne jemi dëshmitarë që kjo as për së afërmi nuk ka ndodhur.

Po të shohim buxhetin për këtë fushë për vitin 2018, është rreth 53 milionë euro dhe për Departamentin e Mjedisit nga ky buxhet janë ndarë vetëm 2.2 milionë euro, shifër jo vetëm e pamjaftueshme, por edhe e pashoqëruar nga ndonjë plan masash, qoftë afatshkurtër apo afatmesëm.

Qytetarët tanë po ballafaqohen me sëmundje të llojeve të ndryshme, sidomos të organeve që direkt preken nga ndotësit e ajrit, siç janë ato të frymëmarrjes, të zemrës, grupet me rrezik, si foshnjat edhe të moshuarit apo nënat shtatzënë janë ato që po përballen direkt me këto pasoja shëndetësore.

Ndonëse nuk kemi të dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike për numrin e të sëmurave me kancer, një gjë është e ditur, se kjo sëmundje është gjithnjë në rritje e sipër.

Por nuk jemi të njohur që rastet nuk paraqiten të gjitha dhe për to nuk ka shënime sistematike nga institucionet e Kosovës.

Institucionet private nuk kanë raport të rregullt dhe historiku i pacientit nuk është askund i shënuar zyrtarisht, në një arkiv digjital që të shërbejë për studime e masa parandaluese.

Njëjtë edhe me pacientët e shumtë të Kosovës, të cilët tashmë shërohen në një masë të madhe jashtë vendit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka klasifikuar ndotjen e ajrit si një ndër shkaqet kryesore të kancerit.

Në Agjencinë ndërkombëtare të kërkimeve mbi kancerin pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë thuhet, po e citoj: “Tashmë e dimë se ndotja e ajrit është jo vetëm një risk për shëndetin në përgjithësi, por është një ndër shkaqet më të rëndësishme mjedisore të vdekjeve nga kanceri”.

U diskutua dhe u bë shumë publicitet për ndotjen e ajrit në Prishtinë, mirë që u bë, sepse po merren masa emergjente.

Por, prej vitesh qeveritë e Kosovës kanë qenë dhe ende vijojnë të mbeten të verbra e të shurdhëta për ndotjen e ajrit në komunat e tjera të Kosovës.

Nuk dallon për nga ndotja e ajrit as komuna e Gjilanit, e cila po ashtu u radhit ndër qytetet më të ndotura në botë.

Ndonëse në Gjilan nuk kemi termocentrale me qymyr, shumica e ekonomive familjare nuk përdorin thëngjillin, nuk kemi industri të rëndë, sepse e dimë me privatizimin neoliberal janë shndërruar në qendra tregtare apo restorante, sërish qytetarët e Gjilanit jo vetëm që rrezikohen nga ndotja e ajrit, por janë në çdo stinë të vitit të kërcënuar nga sëmundjet, madje edhe epidemi, si pasojë e gjendjes jashtëzakonisht të keqe të ambientit që ka krijuar deponia rajonale, ku nuk

plotëson asnjë kusht apo standard minimal. Kjo deponi veçanërisht është shumë e rrezikshme për banorët që janë afër saj.

Po ashtu gjendje e degraduar vërehet edhe nga deponi të tjera nga mbetjet inerte. E kulmi arrin me çështjen e ujërave të zeza, të cilat janë dhe dalin mbi sipërfaqe të patrajtuara dhe të pambuluara.

Për gjithë këto vite të pasluftës, e këto vite që jam prezent edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, nuk kam vërejtur asnjëherë mobilizim të Ministrisë së Shëndetësisë apo inspektorateve që kujdesen për ambientin dhe shëndetin publik që të bëjnë një thirrje që të dorëzojnë raporte e rekomandime me masa urgjente, që të kërkojnë të ndalin koordinimin me ministrinë e linjës burimet e ndotjes së ajrit.

Që të paraqesin raporte të detajuara për publikun e gjerë nga Klinika e Pulmologjisë, nga Onkologjia e Klinika e Kardiologjisë, ku paraqiten probleme në popullatë të adresimi i shkaqeve si preventivë kryesore.

Një ministri e heshtur për parandalimin , një ministri e zëshme vetëm për tenderime barnash e aparaturash, një Ministri e Shëndetësisë e heshtur përball kancerit dhe ndotjes, po e merr edhe jetën e qytetarëve të Kosovës po ashtu në heshtje.

Masat afatshkurtra në sektorin e shëndetësisë dihen, ato duhet të ndërmerren.

Nuk kam parë më herët vullnet, mirëpo nuk po shoh as sot vullnet, të paktën Ministria e Shëndetësisë të ngre nivelin e urgjencës, t'i thërrasë specialistët e shëndetit publik dhe t'ua paraqesë gjendjen qytetarëve se ku jemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për deputetët dhe ministrat prezentë,

Së pari të flasim për ndotjen e ajrit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si deputetë të Kuvendit, e nuk jemi në gjendje ta mbajmë ajrin e pastër brenda në sallën e Kuvendit.

Në Parlament ndotet hapësira e përbashkët çdo ditë nga pirja e jashtëligjshme e duhanit, domethënë këtë sot çka po e bëjmë ne është në fakt absurd, mund të merret si këshillë nga ministrja ose nga Qeveria, masa mbrojtëse, por së pari ne na ka humbur kredibiliteti të flasim për ajrin e pastër, përderisa rrimë në një hapësirë të kontaminuar atje lart dhe përderisa të njëjtën e ndiej edhe korridoreve të Parlamentit të Kosovës që tregon se edhe nëpër zyra kohë pas kohe thyhet Ligji i duhanit ose pihet duhani.

Së dyti, po merremi gjithmonë me masa reaktive dhe jo proaktive. Unë prej tash mund t'ju paralajmëroj që ndoshta duhet të mblidhemi në prill bashkë për sezon të jashtëzakonshëm ose për seancë të jashtëzakonshme në sezonin e pranverës për vërshimet që do ta marrin Kosovën ose qytetet që kanë lumenj në Kosovë dhe kërjt këto nuk ndodhin për faktorin klimatik, siç nuk po ndodh as ndotja e ajrit në Kosovë, po për faktorin njeri.

Ironia është se organet kompetente që duhet të merren me parandalimin, jo rrallë janë pjesë përbërëse e shkaktimit të problemeve.

Sot, në ekzekutiv, pa pasur nevojë të kemi seancë të jashtëzakonshme, janë një mori masash që mund të ndërmerren drejtpërdrejt dhe të bëjnë parandalimin, ose të fillojë pastrimi dhe mbajtja në rregull e ajrit.

Prishtina renditet si njëra nga vendet më të ndotura, edhe pse është larg të qenit vend industrial.

Burimet, siç ju tha shumë dje këtu, termocentralet në Obiliq, numri i madh i makinave të vjetruara si dhe kualiteti i dyshimtë i derivateve, trendi i lartë i ndërtimeve të pakontrolluara, transporti publik joefikas, mungesa e infrastrukturës dhe planifikimit rrugor, mirëmbajtja e dhe mospastrimi i rrugëve, duhet të ceket se prej se kemi filluar debatin ose ka filluar debati që disa javë, nuk e di se a janë pastruar rrugët, të paktën jo në Prishtinë.

Shumica e automjeteve sot përdorin naftën si lëndë djegëse. Në Evropë, përderisa ne nuk kemi statistika të mirëfillta, vlerësohet se tymrat e naftës nga automjetet janë 40% përgjegjës për emetimin e gazrave të rrezikshme, dioksidit të azotit. Pasi që nuk disponojmë me të dhëna që tregojnë emisionet për emetimin e dioksidit të azotit, mund të supozojmë se kjo përqindje është e njëjtë edhe në Prishtinë.

Ministrja dje foli për 12 stacione monitoruese nëpër Kosovë, si dhe planin për softuerin e përbashkët në konsolidim të dhënave.

Çka ministra nuk na tregoi ose nuk i kanë treguar që sistemet në këto 12 nënstacione nuk janë kompatible njëra me tjetrën. Për arsye se në kuadër të këtyre nënstacioneve ka teknologji japoneze, teknologji evropiane dhe amerikane.

Domethënë, duhet të tregohet edhe plani se cili është i pari për vendosjen e një kompatibiliteti në këto 12 nënstacione dhe, së dyti, pastaj për investime të mëtutjeshme në softuer.

Për “Kosovën B” e kemi parë, unë nuk mendoj se është mungesa e teknologjisë, te rasti i “Kosovës B” dhe menaxhimi i KEK-ut e kemi tërësisht mungesën e transparencës dhe

menaxhimin ose keqmenaxhimin e investimeve, të cilat me vite të tëra janë bërë në këtë ndërmarrje.

Ministri i Infrastrukturës dje tha se ministria e tij po punon në një udhëzim administrativ. Ia rikujtoj ministrit ose t'i pyesë stafin atje se në vitin 2016 Qeveria e ka shfuqizuar Udhëzimin administrativ numër 03/2011 për normat e lejuara të shkarkimit në ajër.

Rrjedhimisht, Udhëzimi i ri 08/2016 është i gatshëm që përcakton normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme tokësore, automjetet rrugore.

Mirëpo dispozitat kalimtare, neni 22 i këtij udhëzimi, i japin karakter eksperimental gjashtëmujor, me mundësi të vazhdimit edhe gjashtë muaj të tjerë. Vazhdimin për kohëzgjatjen e bën Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht bazuar në propozimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës.

Mirëpo deri më sot nuk është bërë, unë shpresoj që të ndërmerret si masë sa i përket ekzekutimit të menjëhershëm dhe mosshkaktimit të kaosit në trafik. Përndryshe nuk i mbështes masat të cilat janë ndërmarrë për automjete, mendoj se vetëm kur t'i shohim edhe ministrat me biçikleta ose në këmbë, edhe automjetet zyrtare, atëherë mund të shohim sa seriozisht e kanë ndërmarrjen e masave të ndalimit të automjeteve, se në këtë rast po heqin vetëm qytetarët e thjeshtë, ose ata të cilët më së paku janë përgjegjës për situatën në të cilën jemi për momentin.

Një sektor tjetër që pak u përmend, ndërtimi, bazuar në hulumtimet nga institutet ndërtimore në Angli dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sektori i ndërtimit kontribuon deri në 23% ndotje të ajrit, 50% ndryshime klimatike dhe 40% ndotës të ujit të pijes, ndërsa në kuadër të mbeturinave janë 50% të mbetjeve inerte.

Një element tjetër që duhet të përgjigjet Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht ministritë përkatëse është: pse në Kosovë, edhe me shtrirjen e kapaciteteve të ngrohjes qendrore dhe me rritjen e masave të efijencës është rritur importi i rregullt i vajit për ngrohje?

Në vitin 2016 në Kosovë janë importuar 25 milionë litra vaj për ngrohje, ose vaj i rëndë, i cili sulfurin e lejuar e ka deri 300ppm, ndërsa në vitin 2017 importi i vajit për ngrohje është rritur për 5 milionë litra, ose ka arritur në 30 milionë litra.

Nuk është problemi vetëm i kontrollit në kufij i cilësisë së naftës, problemi është i kontrollit të rafinerive dhe çfarë po ndodh sot me cilësinë e naftës.

Gjithashtu këtu me veti kam edhe dokumentacion, i cili tregon se nga dokumenti unifikues doganor, vaji i ngrohjes që është importua nga Bullgaria raportohet me certifikatën që e ka sjellë

për kualitet që mban vetëm 6ppm, përderisa vlerësimi që është bërë veçantë tregon shumëfishin e kësaj sasia, apo 20 herë më tepër sulfur.

Domethënë, përderisa ne po flasim këtu, sot ky vaj nga laboratorët tanë bile as nuk i matet sasia e sulfurit, dhe po ndodh një përzierje ose një doganim i rrejshëm i vajit për ngrohje. Do të thotë, në kuadër të situatës, e cila është pjesë e drejtpërdrejtë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet të bëhet ndalja dhe kufizimi strikt i përdorimit të vajit për ngrohje, si një prej ndotësve kryesorë.

Të bëhet afati strikt, këtu u tha që gjatë këtij viti do të vendosen filtrat në “Kosovën B”, përderisa drejtori i KEK-ut deklaroi që presin mjetet e IPE-s në vitin 2019-2020 që të vendosen filtrat në “Kosovën B”. A mund të kemi një konsistencë në deklarime mes ministrave të Qeverisë dhe drejtorëve ose drejtorit të KEK-ut, në këtë rast.

Ngritja e numrit dhe kompatibiliteti i nënstacioneve matëse. Ndryshimi emergjent i normave të ndërtimit me kushtëzim të masave edhe energjisë efiçiente, edhe të hapësirave të gjelbra. Sot shohim që shumë ndërtohet, po shumë pak në kuadër të ndërtimit, në kuota ka hapësira të gjelbra. Pastrimi i rrugëve në qytet ose nëpër qytete. Lirimi i linjave të veçanta për autobusët urbanë. Nuk është mjaftueshëm që vetëm të vihen në dispozicion autobusët, përderisa ndoshta në një distancë 2 km autobusi bën 40 minuta, ndërsa nëse ka linja të veçanta, atëherë mund të përgjysmohet ose të shkurtohet më tepër koha në të cilën njerëzit e kanë nëse e marrin autobusin.

Kufizimi i shpejtësisë së automjeteve nuk u diskutua në hapësirat e banuara, shpejtësia e madhe e automjeteve, tregon gjithashtu se është drejtpërdrejt ndikues në ndotje.

Zbatimi i vendimit të Qeverisë të Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Infrastrukturës. Rritjen edhe zgjerimin e sistemit të ngrohjes, edhe kjo nuk u diskutua, nuk e di sa keni provuar në formën zyrtare dhe të drejtpërdrejtë të kërkoni leje për kyçe në “Termokos”, procedurat burokratike edhe zgjatja e kohës, bile-bile shpesh edhe korrupsioni janë pjesë që karakterizohen me marrjen e lejes ose kyçjen në proces.

Pak është bërë në ndërtimin e shtigjeve të biçikletave dhe sigurisë në trafik, jo më pak se 2-3 vdekje vetëm që janë asociuar në qytetin e Prishtinës, për ata të cilët kanë qenë ngasës të biçikletave dhe nuk e kanë as sigurinë minimale.

Prapë, po them është shumë e rëndësishme për gjithë ne që prej fjalëve këtu të kalojmë në vepra, veprat janë pjesë e ekzekutivit që duhet t'i ndërmarrë. Ndërsa ne deputetët nuk do të ishte keq që me shembullin personal të tregojmë se e kemi seriozisht këtë punë. E përderisa e ndotim ambientin ku rrimë, nuk e di për çka tjetër mund të flasim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të gjithë po pajtohen që situata me të cilën po përballemi nuk është një situatë e krijuar sot apo brenda një kohe të shkurtër.

Kjo situatë ka ardhur definitivisht për shkak të mungesës së angazhimit serioz për të zhvilluar plane dhe strategji afatgjata.

Neglizhenca e institucioneve përgjegjëse, në njërin anë, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mungesa e informimit, në anën tjetër, ka ndikuar që qytetarët t'i ekspozohen rrezikut permanent shëndetësor dhe ky rrezikim i shëndetit të qytetarëve është vërtet një krim.

Shteti nuk bëhet duke improvizuar, s'e ka bërë askush dhe as ne nuk do të mund të bëjmë një shtet të improvizuar.

Sa herë që ndodhemi para situatave, të cilat veç fillojnë të dalin nga kontrolli, ne këtu po dëgjojmë mençuri mbi mençuri se si t'i tejkalojmë, por ne nuk kemi nevojë të zbulojmë rrotën. Mjafton apo ka mjaftuar të shohim se si i kanë evituar shtetet e tjera këto probleme dhe, të paktën, të fillojmë të ndërmarrim hapat e nevojshëm. Hapa, të cilat nuk janë marrë asnjëherë.

Asnjëherë nuk janë bërë analiza objektive se sa persona mund të kenë pësuar për shkak të kësaj ndotjeje.

Asnjëherë nuk është informuar qytetari se cilat sëmundje mund të vijnë nga kjo ndotje. Dhe jam e sigurt se shumë qytetarë kanë pësuar dhe janë përballur të vetëm me fatin e tyre, sepse as në anën tjetër, në fushën e shëndetësisë, nuk kanë arritur të krijojnë kushte të nevojshme për trajtim.

Jemi në shekullin XXI dhe aty ku ekziston vullneti, zgjidhjet gjithmonë janë të mundshme. Mjafton angazhimi serioz.

Në vendin tonë kjo nuk ndodh, përkundrazi, edhe kur një institut apo një individ apo një grupim, kushdo qoftë, e në rastin tonë edhe një ambasadë e huaj ngre zërin dhe alarmon, reagimi i parë i përgjegjësve është që ky zë të minimizohet apo të shuhet fare.

Ia kemi dalë me sukses që 20 vjet. Por, tani kur situata vërtet nuk mund të mbulohet më, me parulla boshe tentohet që përmes zvogëlimit të komunikacionit të ndikohet në përmirësimin e ajrit.

Veturat nuk janë shkaku kryesor i këtij kontaminimi. Veturat nëse duam t'i përmendim, janë në vendin e tretë apo të katërt. Prandaj nëse synohet zgjidhja e mirëfilltë e këtij problemi, duhet të luftohet shkaku në rrënjë për të vazhduar pastaj me adresa të cilat ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes.

Është mirë që paraprakisht para se të merrej vendimi për ndaljen e veturave të bëhen të qarta edhe shumë gjëra të tjera për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët sot në trafikun e Prishtinës sillen si të hutuar.

Autobusët vonohen me minuta të tërë, duke u dhënë sqarime qytetarëve se cili autobus nga cila linjë shkon.

Autobusët asnjëherë nuk ndalen nëpër stacione të cilat duhen të ndalen po ndalen në vend e pa vend, duke krijuar edhe kështu tollovi në trafik dhe duke hutuar qytetarët.

Në asnjë stacion të autobusëve në Prishtinë ne nuk e kemi të paktën një letër A4, e cila do të sqaronte mirë destinacionin e autobusit dhe gjithashtu oraret kur autobusi nis.

Unë besoj që këto gjëra është dashur të bëhen që moti, sepse nuk janë të shtrenjta ashtu si filtrat e termocentraleve, për të cilat vajtojmë ne sot këtu.

Problemi kryesor dihet nëse janë termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", filloni të gjeni një zgjidhje, e cila do të zvogëlonte emetimin e helmeve nga kjo adresë.

Na tregoni se çka keni ndërmarrë në këtë drejtim, e vërteta është se jo që kemi humbur një minutë për të menduar në këtë çështje, por përkundrazi, ne po na shtohet edhe një emetues i ri.

Jemi 20 vjet pas luftës, 10 vjet shtet, secili është përgjegjës, sepse nuk luhet me jetët e njerëzve.

Të fillojmë ta gjejmë një alternativë për ngrohje dhe alternativa për të shkarkuar trafikun, implementoni kontrollet e rrepta për karburantet që shiten në vend, por mos improvizoni, sepse improvizimet po na ngufatin çdo zhvillim.

Ne si popull dhe si qytetarë të Republikës së Kosovës e banorë të Prishtinës nuk jemi të interesuar për planet tuaja emergjente, të cilat edhe ashtu janë sa për konsum publik. Unë jam e interesuar të shoh se po zhvillonin një strategji afatgjate që ajri që e thithin qytetarët e Kosovës nuk është thjesht helm. Jam e interesuar të shoh reforma të thella, jo vetëm në këtë drejtim, por edhe në shumë drejtime të tjera, sepse sot përballemi me këtë situatë emergjente, nesër do të përballemi me një tjetër dhe pasnesër me një tjetër. Thjesht, leni improvizimet dhe të merrni përgjegjësitë që u takojnë.

I nderuar kryeministër,

Ministra, edhe pse kryeministri dhe shumica e ministrave edhe sot e neglizhojnë seancën, duke mos qenë prezentë dhe unë mendoj që kur të thirret një seancë e jashtëzakonshme, një seancë për një çështje kombëtare, unë mendoj që të gjithë ministrat do të duhej sot të ishin këtu dhe të dhënë mendimet dhe alternativat e tyre se çka mund të bëjmë për parandalimin e kësaj gjendje. Edhe Kuvendi si organi më i lartë legjislativ duhet të jetë më rigoroz në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes në këtë vend. Ata të cilët në vend të angazhimit ofrojnë neglizhencë, mosinteres dhe mosaftësi, duhet të largohen menjëherë nga postet, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit tonë. Dy dekada shpresë mjaftojnë, një shtet që rrezikon me vetëdije shëndetin e banorëve të tij, nuk e di nëse ia del të mbijetojë, fajin këtu nuk e di se kujt do t'ia hedhim pastaj, por një gjë e di se do të përgjigjemi historikisht para popullit dhe vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj e keni fjalën, është mirë të mos dalim nga tema që e kemi në diskutim.

ALBULENA BALAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Ju kolegë deputetë,

Dje dhe sot po diskutojmë për një çështje mjaft shqetësuese dhe shumë të dëmshme për të gjithë ne në Kosovë, por veçanërisht për pjesët urbane, sidomos Prishtinën dhe qytetet e tjera, si Mitrovica, Drenasi dhe Obiliqi.

Prishtina sidomos rrezikohet nga centralet dhe trafiku i dendur, sepse niveli i emetimeve në ajër nga termocentralet është më i lartë se sa lejohet në direktivën e Komisionit Evropian për impiantet me ndezje të mëdha, po ashtu nga numri i madh i makinave dhe bizneseve që si lëndë djegëse përdorin thëngjillin. Prandaj, kjo dukuri është e theksuar në stinën e dimrit. Kompanitë që kanë ndikim negativ në cilësinë e ajrit, si KEK-u dhe të tjera, obligohen të monitorojnë emetimet në ajër nga puna e tyre dhe t'i dorëzojnë këto raporte te Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Por, këto informata nuk janë publike dhe kjo është njëra nga të këqijat e para të këtij fenomeni. Po ashtu, nga stacionet e monitoruara për përcaktimin e cilësisë së ajrit punojnë vetëm dy sosh të instaluar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, ndërsa të tjerat janë instaluar nga Instituti i Shëndetit Publik, por nuk punojnë. Të gjitha këto të dhëna janë një përgjigje për shumicën e rasteve me sëmundje kronike, por edhe më të thella në vendin tonë, duke e ditur se ajri i pastër është më i domosdoshëm për shëndetin tonë.

Bazuar në rezultatet e fundit, sidomos ndotja në kryeqytet ka shënuar një ngritje deri në dhjetë herë më të lartë se shifrat normale. Është mjaftë shqetësuese për të gjithë qytetarët dhe ne si përfaqësues të tyre menjëherë duhet të fillojmë me zgjidhje, duke i zbatuar planet e parapara nga ministria përkatëse dhe, edhe nga rekomandimet që po i japim ne, sidomos duhet orientuar në zgjidhjen e dy termocentraleve duke bërë një sistem të ri të futjes në shfrytëzim të djegies që

bëhet aty. Po ashtu, sa më shumë zona me gjelbërim, duke filluar edhe me ndonjë projekt, si për shembull, “Pema e jetës sime”, secili nga ne të mbjellim nga një fidan të ri, ku do të kishim rreth 2 milionë fidanë të reja për një ambient të gjelbëruar dhe të shëndetshëm, kontroll të domosdoshëm, mbindërtimet, sidomos në Prishtinë, ku çdoherë e më shumë rënohen hapësirat e gjelbëruara.

Ndryshimi duhet të fillojë tani dhe në mënyrë të përsheptuar që ne të kemi një vend me ajër të pastër dhe një jetë më të shëndetshme. MTI tashmë veçse ka bërë një hap shumë me rëndësi lidhur me këtë shqetësim të qytetarëve, duke bërë kontrollimin e kualitetit të derivateve, një hap ky drejt zgjidhjes, e që do pasuar edhe nga të tjerët, sepse kjo dukuri ka zgjidhje, vetëm duhet të punojmë më shumë në këtë aspekt. Meqë dje u propozua që të bëhet një grup punues për këtë dhe t’i marrin rekomandimet nga ne deputetët, atëherë unë po propozoj dhe po jap një rekomandim që do të doja që në secilën shkollë, ngrohjet që i kanë me thëngjill t’i shndërrojnë menjëherë në ngrohje me produkte të tjera, të cilat nuk do të dëmtonin dhe ndotnin ambientin. Për shembull, në Komunën e Prizrenit janë gjithsej 57 shkolla, ku shumica e tyre janë me thëngjill, nëse i shndërrojmë ato, del se çmimi i tyre përafërsisht, pra, për një shkollë, edhe pse varet edhe nga kapaciteti që shkollat që kanë, pra del se çmimi i tyre është nga 10 deri në 20 mijë euro maksimumi, e që për 57 shkolla i bie të jetë një mesatare rreth 700 mijë euro në komunën e Prizrenit.

Pra, kjo të fillohet fillimisht në komunën e Prishtinës, pastaj edhe në komuna të tjera. Jam e sigurt që komunat, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, mund ta bëjnë këtë, sepse kanë kapacitet dhe besoj që ministri, së bashku me drejtorët komunalë të drejtorive të arsimit, do ta fillojnë këtë iniciativë sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje të nderuar qytetarë,

Dje e bëra një hulumtim të shpejtë e të vogël, domethënë ne jemi vendi i fundit në PISA, ndërsa vendi i katërt sa i përket ndotjes në botë, kjo ishte interesant.

Ministria për Punë të Brendshme, ajo e Mjedisit, pra, u ka shpallur luftë dy ndotësve të ajrit, veturave si ndotës të madh dhe heqja nga tregu i shitjes së thëngjillit, si ndotës minor, kolateral, kurse e kanë amnistuar kryendotësin apo vrasësin e ajrit në Prishtinë dhe rrethinë, pra termocentralet “Kosova A” dhe, në veçanti, termocentralin “Kosova B”. Atmosfera në qytetin e Prishtinës ka pësuar ndryshime cilësore të përbërjes së saj natyrore, për pasojë ka ndodhur dukuria e ndotjes së ajrit, e dëmshme për shëndetin e njeriut. Janë institucionet shkaktarë të kësaj gjendjeje, sidomos në agjendën e institucioneve shtetërore, mjedisi për fat të keq radhitet si prioritet i fundit.

Prandaj, është momenti i fundit që të kujdesemi për shëndetin e qytetarëve tanë, duke radhitur mjedisin jetësor në mesin e prioriteteve për interes të veçantë. Në gjendjen alarmante të ajrit në qytetin e Prishtinës kanë ndikuar shumë faktorë: komunikacioni i ngarkuar me automjete të vjetruara, termocentralet me thëngjill, pa standard mjedisor, hidro-karburantet e naftës dhe gazit natyror që janë kancerogjene, benz-Pirena, ngrohja nga amvisëritë familjare me thëngjill, djegia e mbeturinave krijon toksinë, pra kimike, industria me teknologji të vjetruar, e të tjera, e të tjera. Të gjithë këta shkaktarë emetojnë në atmosferë tipa të ndryshme të grimcave në gjendje suspension, në formë tymi, pluhuri, rëre dhe avuj me përbërje kimike nga oksidet e sulfurit, oksidet e azotit, oksidet e karbonit, hidrokarburet, e tjera.

Në këto kushte të emetimit të lartë të ndotësve, motit me mjegull dhe rrymimit të dobët të ajrit me lagështi, formohet ndotësi i quajtur “smog”, pra tym-mjegull, kështu mund të konstatohet gjendja momentale e ajrit në qytetin e Prishtinës. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se me nivelin e lartë të ndotjes së ajrit në Kosovë, e veçmas në Prishtinë, efektet afatshkurtra na çojnë drejt rritjes së numrit të sëmurëve me astmë bronkiale, bronkitet kronike, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive të moshat e shtyra, rritjen e numrit të pranimeve spitalore nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato respiratore, kancer, shkurtimin e jetës dhe rritjen e shkallës së mortalitetit.

Instituti thotë se në sezonin e dimrit qyteti i Prishtinës është zhytur në smog, që paraqet ndotje të kombinuar të ajrit me gazra dhe aerosolë, i cili vërehet gjithandej. Sipas të dhënave të Agjencisë të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ambasadës Amerikane, efektet afatshkurtra të ndotjes së ajrit nga partikulat, sipas shumë të dhënave na çojnë drejt rritjes së numrit të sëmurëve me astmë bronkiale, bronkitet kronike, sëmundje kronike obstruktive të mushkërive të moshat e shtyra, rritjen e numrit të pranive spitalore, e të tjera, e të tjera. Ne duhet të ndërmarrim të gjitha masat, duhet të fusim nën kontroll nivelin e ndotjes së ajrit, por edhe duke e bërë këtë, duhet të jemi të kujdesshëm të mos e ndotim prapë ajrin në Prishtinë.

Pra, po i bllokojmë veturat, njerëzit me çka do të udhëtojnë? Po bëj disa pyetje: po e ndalim qymyrin, njerëzit me çka duhet të ngrohen? Po i ndalim termocentralet, por kush do të paguajë importin me kostot 3-4 herë më të lartë se çmimi që paguajmë. Zgjidhje ka, kjo është disiplinë, por duhet gjetur. Pra, mund të kemi edhe disa propozime, disa të përsëritura edhe nga kolegët, por që edhe unë do të jap disa prej tyre. Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet strategjik mjedisin, nëse deri tash nuk e ka pasur, por tash e tutje duhet ta bëjë, sepse nëse sot po ndotet Prishtina, sigurisht që në të ardhmen do të kemi ndotje edhe në qytetet e tjera të Republikës së Kosovës dhe se Prishtina nuk do të jetë qyteti i vetëm, i cili do të ketë ndotje.

Së dyti, shkarkimi komunikacionit në qytetin e Prishtinës, vendosja e filtrave bashkëkohorë në termocentralet, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje, këtu u përmend nga disa kolegë që të fillohet nga shkollat, ku ata përdorin thëngjillin, ta ndërrojnë atë me mjete të tjera, më pak të

dëmshme për ndotjen e ajrit dhe plotësimi i standardeve mjedisore gjatë proceseve industriale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë të ngufatur, në kuptimin e plotë të fjalës, I nderuar kryesues, Të nderuar kolegë deputetë, Më vjen shumë mirë që këto ditët e fundit zbulova sa shumë ekspertë të ndotjes së ajrit kemi në Kosovë, përfshirë edhe këtu në këtë Kuvend. Me gjithë këta ekspertë, çuditërisht Prishtina e Kosova sot nuk e kanë ajrin e Zvicrës apo të Zelandës së Re.

Sido qoftë, këto ditë jam interesuar për të mësuar më shumë lidhur me ndotjen që po na e dëmton seriozisht shëndetin, veçanërisht shkaktarët e kësaj ndotje. Dhe ekspertët e vërtetë të këtij lëmi kanë potencuar se ndotësit kryesorë të ajrit të Prishtinës janë kryesisht KEK-u, në masë tepër të madhe, e kontribuues më të vegjël janë edhe veturat dhe djegia e thëngjillit për nevoja të amvisërisë. Së pari, mendja më shkoi të interesohem lidhur me zgjidhjet që duhet ofruar dhe zgjidhje ka shumë, dhe me rezultate që garantojnë ajër të pastër për të gjithë ne. Por, zgjidhja e këtij problemi është më e rëndë se sa duket në shikim të parë, sepse problemi ndërlidhet me diçka shumë më të thellë. Të flasim për secilën.

Në lidhje me veturat. E vërtetë është që veturat kontribuojnë në ndotje, por a ndalet ndokush të pyes, pse? Më lejoni t'ju tregoj: sepse, kontrollimi teknik i veturave është procedurë e kotë veç sa për t'i zhvatur qytetarët dhe rrënjësisht e korruptuar. Sikur të kryhej si kërkohet me ligj, veturat më të dëmshme për ambientin tonë nuk do të ishin në qarkullim fare. Por kjo nuk ndodh!

E kush e ushqen këtë aferë korruptive, natyrisht përveç pronarëve të qendrave të kontrollimit teknik, e ushqen ekzekutivi ynë i paaftë për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit, përfshirë këtu edhe administratën militante, të përzgjedhur sipas përkatësisë partiake e familjare, e jo sipas meritës. Shtytës janë edhe një rrjet me indicie kriminaliteti i kompanive të sigurimit, industri që me vite eviton kolapsin total vetëm duke u futur edhe më thellë në afere të dyshimta dhe duke abuzuar me qytetarin e Kosovës. E kemi BQK-në, për ta falënderuar për një pjesë të kësaj. E si rezultat i tërë kësaj që thashë, kemi vetura, autobusë e kamionë që qarkullojnë lirshëm në rrugët tona, edhe pse ish dashtë moti të shiten për hekur.

Përkundër faktit që veturat janë vetëm një ndotës i vogël i ajrit, disa qeverisës, pa asnjë analizë, nga qeveria qendrore dhe lokale, vendosin të torturojnë qytetarët duke ndërmarrë masën totalisht ad-hoc të ndalimit të veturave për qarkullim në qendër. Pra, qëllimi i krejt kësaj afere është thjesht të duket që po bëjmë diçka, asgjë tjetër!

Kjo masë nuk bën asgjë për zvogëlimin e ndotjes, po e larguaka ndotjen nga veturat disa qindra metra nga disa rrugë të qendrës, por ajri nuk ndahet sipas rrugës, ai qarkullon. Përveç asaj, edhe një fëmijë e kupton që veturat që do të qëndrojnë me orë të tëra në kaosin e shkaktuar, do të krijojnë më shumë ndotje se sa kur qarkullojnë lirshëm për të arritur në destinacionin përkatës. Jemi lodhur me tentativa të kota, ku një mëngjes shefi qohet edhe thotë “e kam një ide gjeniale”, këshilltarët ia rrahin krahët, duke i thënë “bravo, shef, je shumë i mençur” dhe që bëhet veç sa për të krijuar përshtypjen se jemi duke bërë diçka. Ju lus, ndërpritni këtë abuzim të qytetarëve menjëherë!

Kemi po ashtu ndotjen nga ngrohja e qytetarëve me thëngjill. Në aspekt sipërfaqësor, duket si masë e duhur, por a mos është pak vonë kjo masë, tash kur pothuajse të gjithë ata që përdorin thëngjill e kanë kryer blerjen ose marrjen nga KEK-u. Pra, a është kjo zgjidhje, apo edhe një veprim i radhës fasador? Më duhet të potencoj, se projekti i kogjenerimit, sikur të kryhej sipas planit që ka ekzistuar, sot, pjesa dërmuese e Prishtinës me rrethinë do të ngrohej pa shpenzuar as rrymë, as dru, e as thëngjill. Por, paaftësia dhe grindjet e kota politike në nivel lokal e qendror nga politikanë të papërgjegjshëm, e sollën qytetarin në këtë situatë ku duhet të ngrohet me burime të energjisë të dëmshme për ambientin.

Tash vijmë tek pika kryesore, te burimi i pjesës dërmuese të ndotjes së ajrit në Prishtinë, te KEK-u. Ku është problemi këtu? Pse, pas qindra miliona euro investimeve që kemi bërë në këtë ndërmarrje publike, ajo prapë nuk funksionon si duhet dhe vazhdon të na ngufatë. Pse, edhe në temperatura më të larta se mesatarja për këtë kohë, ndotja është me e lartë se p.sh. dimrin e kaluar?

Përgjigjja është e thjeshtë. KEK-u është qendër e krimit dhe korrupsionit. Është qendër e keqmenaxhimit, në kuptimin e plotë të fjalës. A mundet KEK-u të mos ndotë fare? Kurrsesi! Por, a mund të ndotë shumë më pak? Gjithsesi! Por, për të ndotur më pak, kërkohet menaxhim i duhur i financave të KEK-ut. Kërkohet që financat e KEK-ut t'i binden ligjit, jo tenderomanisë. Fatkeqësisht, e kundërta ndodh, tenderët e KEK-ut në vazhdimësi janë temë e lajmeve për korrupsionin evident në këtë ndërmarrje publike. Dhe, kur vidhen paratë e KEK-ut, nuk mbesin para për të instaluar filtra, aq më pak filtra bashkëkohorë. Filtrat nuk janë të lirë dhe kur nuk ka filtra, ka vrasje të qytetarëve të Prishtinës nga ndotja e pakontrolluar e KEK-ut.

Po ashtu, KEK-u duhet të prodhojë vetëm aq energji sa ka kërkesë nga qytetarët e Kosovës, por për të mbushur apetitet korruptive, edhe në periudha si tani, kur kërkesa është e ulët, prodhohet më shumë se sa që është e nevojshme. Pra, për të shitur KEK-u, KESCO dhe kush-dikush, rrymë me çmime të shtrenjta jashtë Kosovës, ne sot paguajmë me shëndet. E kush ta ndalë këtë korrupsion? Normalisht, pasi nuk kemi organe të drejtësisë dhe kemi qeveri që na udhëzon të qëndrojmë brenda dhe merret me shkop magjik, ishte dashur të ndërhyjë menaxhmenti. Por, si ta bëjë menaxhmenti këtë, kur të emëruar në bord janë ose familjarë të afërt të pushtetarëve ose

militantë partiakë. Shihni anëtarët e Bordit të KEK-ut dhe e kuptoni për kë e kam fjalën. Njerëz që kualifikimin më të lartë e kanë gjakun ose librezën partiake, e në asnjë mënyrë njohuritë dhe shkathtësitë për të qeverisur me një gjigand si KEK-u.

Pra, në fund, strategjia energjetike e Kosovës është ajo që duhet kultivuar në përputhje me interesin më të mirë të ambientit dhe qytetarëve. Por, çfarëdo strategjie që ofrojmë për të ardhmen, do të lëngojë nga të njëjtat probleme që i përmenda më sipër. Pra, ndaleni abuzimin, korrupsionin, nepotizmin e militantizmin, se përndryshe këto pasoja vazhdojnë. Thënë të drejtën, unë vërtet nuk po kuptoj se si mund të vazhdoni me këtë mendësi, kur pothuajse të gjithë jeni bërë prishtinas. Ku edhe fëmijët tuaj po e thithin po të njëjtin ajër. Apo, hajnia e korrupsioni jua kanë qorruar sytë aq shumë, sa nuk po shihni as dëmin që po ia shkaktoni shëndetit të fëmijëve tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Këtu po diskutohet thua që kurrkush s'ka jetuar në Prishtinë përpara dhe nuk e di situatën. Historikisht kush ka jetuar, studiuar në Prishtinë, e di që çdo vit kur ka mjegulla, kur është ftohtë, ka qenë gjithmonë e njëjta situatë, nuk është diçka më keq sot se sa që ka qenë në vitet e '70-ta, po them, ose të '80-ta.

Sidoqoftë, fjalën e ka zoti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për kryetarin,

Kabinetin qeveritar,

Përsëritje për të nderuarit deputetë.

U diskutua dhe patëm diskutime shumë përmbajtësore në drejtime dhe në fusha të ndryshme në dimensionin e ndotjes së ajrit, mirë kishte qenë që t'u qasemi në mënyrë komplekse si ndotje të ambientit që nuk është vetëm ajri i ndotur në Kosovës, por kemi të bëjmë me ndotjen e tokës, ujit, por edhe ajrit.

Në përgjithësi mund të flasim dhe të konstatojmë se çështjet e burimit të ndotjes, te pasojat e ndotjes, te masat, të cilat duhet t'i ndërmarrim që të zvogëlohet kjo ndotje, si edhe për koston për t'u evituar dhe zvogëluar ndotja. Po më pëlqen entuziazmi i ministres së Ambientit dhe gjithsesi Ministria e Ambientit ka kuadro të mjaftueshme dhe të përgatitura për të bërë të gjitha ato aktivitete dhe veprime të planifikuara, në mënyrë që të ndikojë në zvogëlimin e ndotjes së ambientit, po shpresoj që kjo seancë do të jetë një sensibilizim dhe një moment logjik që do të ndërrojë mendjen dhe do të ndikojë që çdo punëtor, zyrtar dhe anëtar i mekanizmave përgjegjës për implementimin e mekanizmave të mbrojtjes ndaj ambientit do të vetëdijësohet, do të ndërjegjësohet dhe, më në fund, do të instalohet edhe institucioni i përgjegjësishë për secilin hallkë të sistemit tonë.

Prej diskutimeve të ndryshme, por edhe prej asaj çka u informuam këto ditë po del që problemi i parë është edhe identifikimi i burimeve të ndotjes, ashtu që prej njerëzve të këtij lëmi, prej asaj që termocentralet janë shumë ndotëse dhe participojnë me ndotjen më të madhe, nga të dhënat e analizave këto participojnë me 10%. Djegia e thëngjillit prej asaj që participohet me 1/3 del që për një sezon shpenzohet thëngjill për djegien nëpër shtëpia sa KEK-u të djeg për një ditë. Pavarësisht kësaj, atëherë hapi i parë është që të identifikohen burimet e ndotjes në mënyrë metodologjike, me metoda shkencore të sprovuara. Nuk kemi nevojë të shpikim ujin e ngrohtë, qytetet e tjera që kanë pasur probleme të ngjashme i kanë marrë masat adekuate dhe i kanë identifikuar burimet e ndotjes dhe karshi burimeve të ndotjes, janë marrë edhe masat adekuate për zvogëlimin e ndotjes dhe për prurjen e tyre në parametra tolerues për kushtet bashkëkohore të sodit.

Duke i radhitur këto, besoj që shteti ynë nuk duhet të kursejë mjete financiare për të marrë masat adekuate në drejtim të zvogëlimit të ndotjes. Kur jemi te KEK-u, nuk duhet të kursejmë ato 50 milionë për tre vjet për të participuar në projektin e përbashkët me Komisionin Evropian për ndërrimin e filtrave të KEK-ut. 50 milionë për tre vjet edhe disa milionë për veprime të tjera i zvogëlojmë 500 milionë shpenzime për pasojat shëndetësore të qytetarëve tonë në 10-15-vjeçarim e afërt dhe besoj që përpos zvogëlimit të shpenzimeve, e ruajmë kualitetin e jetës së qytetarit dhe mundësinë që të mos shkurohet jeta e qytetarëve tonë për shkak të ndotjes dhe që një pjesë të gjatë të jetës të mos bëjnë jetë jokualitative për shkak të sëmundjeve që shkaktohen.

Tash jam duke folur për pasojat që përpos pasojave në sistemin e frymëmarrjes edhe në sistemin kardiovaskular shumë rrallë përmendet që janë pasoja të drejtpërdrejta dhe pasoja që ndikojnë edhe në sistemin shpirtëror, që janë ndikues të drejtpërdrejtë në çrregullimet, në disa lloj çrregullimeve të skizofrenisë, por edhe të autizmit, që sot është një problem botëror, e si duket edhe në territorin e shtetit tonë janë duke u dukur këto pasoja.

Dhe, një prej burimeve të tjera janë derivatet e naftës dhe veturat. Te derivatet e naftës kisha pasur dëshirë t'ju rikujtoj, ose t'ju kthej në vëmendje, një problem që e kemi pasur para disa vitesh me dy maune, që rastësisht i ka ndalur Policia, duke e parë që ka rrjedhje prej tyre dhe u bë problem shtetëror, kur për t'i larguar ato prej shtetit tonë dhe për t'i çuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'i shkatërruar, shteti ynë ka shpenzuar para të drejtpërdrejta 150 mijë euro, pa i llogaritur shpenzimet përcjellëse që i ka harxhuar Policia në përcjellje të tyre, protestat që janë organizuar, frika që është shkaktuar te qytetarët, e të tjera.

Prandaj, ju lutem, analizat që i kemi bërë në atë kohë kanë dalluar analizat e dy shteteve mike, në krahasim me laboratorët tanë për përcaktimin e cilësisë së derivateve të naftës dhe kanë qenë drastikisht të rritura vlerat e oksidit të sulfurit, oksidit të azotit dhe të oksidit të karbonit, që as KEK-u nuk ka pranuar ta bëjë djegien e asaj lënde. Në atë kohë, as nuk kemi mundur ta sjellim ndonjë kompani për ta realizuar djegien dhe shkatërrimin e asaj sasive të benzinës në Kosovë.

Mirëpo, një atdhetar shqiptar ka ardhur dhe me kontributin e tij, duke ia paguar vetëm shpenzimet për transport dhe të tjera, i ka marrë, zoti Tafilaj, s'më kujtohet mbiemri, i ka çuar në Teksas, Hjuston, dhe i ka djegur atje.

Këtë shembull e tregova vetëm për t'i llogaritur pasojat dhe shpenzimet eventuale në çdo projekt më tutje dhe është koha e fundit që të jenë në një kontroll të përhershëm laboratorët që e bëjnë analizën dhe vlerësimin e derivateve të naftës, që janë njëri prej burimeve të ndotjes, e të mos flas edhe për veturat e vjetra, që nuk posedojnë katalizatorë, apo nuk kontrollohen për sasinë e emetimit të produkteve të dëmshme prej djegies së motorëve të tillë.

Propozoj konkretisht që të autorizohet Ministria e Financave dhe ministri që të gjenden mjetet për tre vjetët e ardhshme, që të investohet në projektin e KEK-ut për t'i ndërruar filtrat dhe propozoj që të planifikohet ndërtimi i shpejtë i dy deponive të mëdha në Kosovë, një për Kosovë dhe një për pjesën e Dukagjinit, ku do të bëhej trajtimi i mbeturinave në mënyrë adekuate dhe në mënyrë profesionale. Të mos harrojmë që edhe deponitë e mbeturinave janë njëri prej faktorëve kyç në participimin e burimeve të ndotjes.

Sikur të gjitha këto të bëheshin në mënyrë të planifikuar, e Ministria e Ambientit ka kapacitet për t'u bërë këto të gjitha në mënyrë të planifikuar, sikur resorët tjerë ta përcjellin, qysh është Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Infrastrukturës, besoj që për tre vjetët e ardhshme mund të ketë rezultate të dukshme në zvogëlimin e parametrave të ndotjes së ambientit tonë. Kisha pasur dëshirë që gjatë vlerësimeve dhe kualifikimeve të rrezikut prej ndotjes së ambientit të jeni pak më të kujdesshëm me propozimet që i bëni, se edhe ashtu qytetarët tanë janë në stres për këtë gjendje dhe ndoshta diskutimet e juaja do të shkaktojnë edhe një frikë. Nuk ka nevojë për të marrë masa shtesë të menjëhershme. Qëndrimi i nxënësve si në shkolla, si në shtëpi apo banesa, e kanë atë ajër, ndalesa e qarkullimit në trafik nuk mund të japë ndonjë kontribut të jashtëzakonshëm, se është një ndalesë për një lokalitet të vogël dhe ajri nuk mund të stopohet e të mos komunikojë në tërë qytetin. Mirëpo, do të jetë kjo seancë e do të jetë rekomandimi përfundimtar apo fillestar, që të instalohet institucioni i përgjegjësishë së segmentit të zbatimit të ligjit dhe do të fillojnë me zbatimin e masave gjorbitëse dhe ndëshkuese për ata që nuk i zbatojnë këto masa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Adem Mikullovc!

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit!

Ju përshëndes të gjithëve të pranishëm!

Por, së pari zoti kryetar, mendoj që nuk kemi kuorum ta mbajmë mbledhjen. Unë po çuditem. Ne po bëjmë muhabet ndërmjet vete boll mirë, po kuorum s'ka, e para e punës.

E dyta e punës, po i them dy-tri fjalë edhe unë. Mendoj, krejt këto diskutime, dje dhe sot, janë të mirëseardhura. Ka propozime shumë të mira, por janë pothuajse krejt të kota, se s'mund të ndërrojmë kurrgjë, s'mund të bëjmë kurrgjë hëpërhë. Bile, ekziston një fjali turqisht që thuhet "arbainen soni, hamsinen oni", që do të thotë "fondi i arbainit dhe dhjetë ditët e hamsinit" gjithmonë ajri është më i rëndi, dimri është më i forti. Kështu ka qenë edhe përpara, kështu është edhe tash, me përmasa më të mëdha. Por, që mund të ndërrojmë diçka është e kotë. Kuvendi do të bëjë plane afatgjata në të ardhmen çfarë të bëhet, pyllëzimi, gjelbërimi i qytetit... se sa për këto... jo Obiliqi, jo makinat, jo këto... këto janë muhabete të kota. Këto janë "më ka çua nëna me e la gojën", hajt të flas edhe unë, të them diçka, të më dëgjojnë edhe të tjerët që s'jam aq pasiv. Kaq pata unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mikullovc! Debat zhvillohet edhe pa kuorum, sepse nuk kemi për të votuar. Meqenëse e hapët këtë çështje, unë mendoj që grupet parlamentare është mirë që t'i caktojnë përfaqësuesit e tyre për t'i harmonizuar rekomandimet si Kuvend kur të përfundojë debati, i votojmë sipas Rregullores.

Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, më vjen mirë që Kuvendi i Republikës së Kosovës për tema të tilla të interesit të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve gjen konsensus për debat dhe për adresim të përgjegjësive, por edhe për masat që duhet t'i ndërmarrin institucionet kompetente, qoftë në nivelin qendror, apo edhe në atë lokal.

Ndotja e mjedisit në Kosovë, në zona të caktuar, në veçanti në rrethinën e Prishtinës, por edhe në Mitrovicë, për rrethinën e Prishtinës e kam fjalën për qytetin Obiliq, për Drenasin dhe për Mitrovicën, ka pasur jo vetëm tani, edhe vitet e mëhershme, në veçanti pas zhvillimit të industrive të caktuara, pas viteve të '80-a. Dhe, kjo gjendje nuk është e muajit të fundit, e vitit të fundit, apo e dy-tre vjetëve të fundit.

Së pari, duhet t'i diagnostifikojmë shkaktarët e ndotjes së ajrit, të analizohen të gjithë faktorët me statistika zyrtare dhe të besueshme, të cilat ende nuk i kemi. Nga kjo seancë e jashtëzakonshme të dalim me vendime konkrete obligative për Qeverinë dhe për mekanizmat e tjerë institucionalë që t'i zbatojmë në plotëni masat që do të miratohen nga kjo seancë e jashtëzakonshme. Duhet të mendojmë për masa urgjente. Ky dimër shkoi. A duhet të mendojmë vetëm kur përballemi me kriza të natyrave të tilla, apo të mendojmë për masa konkrete profesionale dhe institucionale afatgjate?

Propozoj që Qeveria brenda 90 ditëve t'i fillojë procedurat e nevojshme të prokurimit për vendosjen e elektrofiltrave apo filtrave me nanoteknologji, të cilët njëherë e përgjithmonë do ta

zgjdhnin problemin e ndotjes nga tymtarët e Kosova B, e jo siç është dëgjuar nga disa zyrtarë, është paraparë më 2019 dhe 2020. Çfarë përgjigje institucionale është kjo, nëse ne nuk marrim vendim dhe nuk i obligojmë mekanizmat relevantë që ta zbatojnë këtë masë? Do të përballemi njëjtë edhe në dimrin e ardhshëm, prandaj insistoj që rekomandimet e votuara në këtë Kuvend të jenë obligative për institucionet kompetente.

I propozoj këto masa:

- matje kompetente dhe profesionale me softuer unik për cilësinë e ajrit, me ekrane publike dhe transparente për qytetarët, siç i shohim edhe në metropolet dhe kryeqytetet tjera të vendeve të zhvilluara;
- transport urban efikas, me autobusë adekuatë, me katalizatorë, që emitojnë në minimum gazra toksike, që kanë ndikim dhe impakt të drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit në kryeqytet dhe në zonat që po bisedojmë, po pse jo edhe në gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- kontroll efikas të cilësisë së karburanteve - konsideroj që shteti ynë dhe institucionet kompetente nuk kanë qenë në nivelin e detyrës për kontrollin e cilësisë së karburanteve;
- kontroll rigoroz i asgjësimit të mbeturinave organike, që është një problem serioz për emetimin e gazrave toksike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit;
- reduktim maksimal i vajrave industrialë dhe atyre djegëse, që lirojnë substanca toksike;
- kontrollim dhe asgjësim sipas standardeve të medikamenteve dhe mbeturinave të kësaj natyre, që kanë pasoja jashtëzakonisht të dëmshme për shëndetin e popullatës;
- kontroll të përgjegjshëm dhe verifikim të cilësisë së kontrolleve teknike anembanë vendit të automjeteve që dalin në trafik dhe si pasojë e një moskontrollimi kompetent dhe të përgjegjshëm emetojnë monoksid dhe dioksid të karbonit dhe flitet që ndotja vjen pothuajse gati 30% nga automjetet që qarkullojnë në trafik;
- në periudhën e krizave të ndotjes së ajrit, të shikohet mundësia e aplikimit të sistemit të qarkullimit të makinave sipas parimit të numrave çift, ose tek, e jo ndalesë e qarkullimit për zona të caktuara, sepse kjo bie ndesh me lirinë e lëvizjes. Dhe, krejt në fund,
- koordinim serioz ndërinstitutional që t'u përgjigjemi në mënyrë adekuate problemeve të tilla që e rrezikojnë në masë shëndetin e popullatës. Tek e fundit, kemi obligim si njerëz të zgjedhur dhe si institucione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit, zoti Haliti!

I nderuar kryetar, zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht e falënderoj kryetarin e Kuvendit, i cili, në emër të Partisë Demokratike, e ka iniciuar këtë debat parlamentar, të cilin e konsideroj se është më shumë se i rëndësishëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse ambienti është jeta e qytetarëve dhe ne duhet të kontribuojmë në një ambient më të mirë dhe të kemi një ajër më të shëndoshë.

Ne e dimë që këto procese dhe këto probleme si Kosovë i kemi edhe më herët. Nëse e shohim Raportin e Progresit, edhe raportin e Avokatit të Popullit, edhe raportet tjera do të thotë nga institucionet përkatëse, e shohim që kemi pasur çdo herë rekomandim të investojmë në ambient, duke filluar nga moslejimi i shkatërrimit të lëmenjve, gjelbërimi, mbjellja e fidanëve e deri te pyjet, të cilat janë shkatërruar, t'i pyllëzojmë e ta krijojmë një ambient më të mirë për qytetarët e vendit tonë.

Ne kemi pasur apo të paktën këtë duhet ta thonë institucionet përkatëse që kemi shumë raste në Republikën e Kosovës, sidomos vdekje, që janë më të shpeshtuara viteve të fundit, që ndoshta të paktën nga qytetarët thuhet faktor kryesor është ajri, e kemi një numër të madh nga viti në vit të vdekjeve nga kanceri, që ndoshta këtë duhet ta thonë institucionet përkatëse, por ne si deputetë, si ligjvënës në këtë vend duhet t'i marrim masat adekuate dhe t'i harmonizojmë politikat dhe strategjitë për një ambient më të shëndoshë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne e kemi parë që këto ditë kemi marrë masa konkrete. Ka pasur rekomandime nga Ministria e Ambientit, i kemi pasur masat që janë marrë nga Komuna e Prishtinës, por unë mendoj që është për t'i respektuar këto masa, por në raste të këtilla është dashur të shpallet një gjendje ndoshta e jashtëzakonshme, që ministritë përkatëse, duke filluar nga Ministria e Transportit, Ministria e Ambientit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Tregtisë, e cila ka të bëjë me lëndë djegëse që transportohen në këtë vend dhe komunat përkatëse, të bëhet një shtab emergjent, që paraprakisht ta bëjë një analizë dhe pastaj t'i propozojë masat konkrete, të cilat duhet të ndërmerren që ta kemi një ambient më të mirë në Komunën e Prishtinës, po edhe në gjithë Republikën e Kosovës.

Ne duhet ta analizojmë dhe mendoj nga përgjegjësit, në këtë rast nga Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht nga ministritë përkatëse, duhet të na tregojnë se a është e mirëfilltë që infrastruktura ligjore në këtë drejtim, se ne e dimë që kemi dhjetëra ligje të votuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës që e rregullojnë fushën e ambientit, por a po zbatohen ato ligje, apo

kemi zbrazëtira ligjore, apo kemi ligje që nuk po na bien tamam që ta kemi një ambient më të mirë dhe ta kemi një ajër të shëndoshë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne e kemi edhe ligjin që e kemi votuar në vitin 2010. Ai ligj parasheh shumë masa. Është edhe parimi “ndotësit paguajnë”. Në ligji shkruan që gjobat janë nga 15 mijë euro deri në 50 mijë euro për ndotësit e mëdhenj të ajrit, Qeveria duhet të na raportojë, në këtë rast ministritë përkatëse, nëse kemi asi lloj ndotës, sa gjoba dhe sa kanë ndikuar ato gjoba në përmirësimin e jetës, në këtë rast të ajrit.

E kemi edhe Udhëzimin Administrativ 08/2016, që është nxjerrë për kontrollimin teknik të lirimit të gazrave, duhet të shikojmë a po implementohet ky udhëzim, apo ka nevojë që ky udhëzim nga institucionet përkatëse të ndryshojë, sepse nuk po shihet me dhjetë ligje apo dymbëdhjetë ligje, sa i ka Kosova në këtë fushë, ndotja e ajrit nga viti në vit vjen duke u përkeqësuar. Jo që ka ardhur vetëm këtë vit, sepse ne edhe vitet tjera kemi pasur rekomandime, por nuk kemi marrë ndonjë masë konkrete.

Unë propozoj dhe mendoj që disa nga shqetësimet kryesore, të cilat i thanë edhe kolegë tjerë deputetë, lidhur me ndotjen e ajrit, duhet të përfshihet në rezolutë apo në rekomandimet në fund të këtij debati, që besoj se është shumë produktiv, të krijohen plane për transportin urban dhe ndërurban, të investohet në ngrohjen e qytetarëve. Ne e dimë se sidomos në kryeqytetin tonë kemi shumë lagje të reja dhe mendoj se nëpërmjet “Termokosit” duhet të përkrahjet në këtë rast edhe nga Qeveria që të kemi shtrirje të rrjetit në të gjitha ato lagje, me me të vetmin qëllim që ta ulim në këtë rast ndotjen e ajrit, të përmirësohet infrastruktura urbane, stacionet e ndaljes, sinjalizimi, shtigjet e biçikletave.

Ne i ndalim makinat dy-tri ditë, por nga ata që i udhëheqin komuna në vazhdimësi nuk është marrë asnjë masë konkrete dhe asnjë shteg të biçikletave të paktën nuk kemi pasur rastin ta shohim në shumicën e komunave, as në kryeqytetin tonë. Mendoj që ndoshta më mirë është të investohet në shtigje të biçikletave, sesa të vendosim kunjat, t’i pengojmë qytetarët apo edhe afarizmin që po ndodh, dhe mendoj që edhe sot jem duke e pengur afarizmin me bllokadën që e kemi bërë në dy rrugë, se nuk mendoj që me dy rrugë pastrohet ajri në Prishtinë.

Mendoj që në zonat e qendrave të qyteteve duhet të organizohet forma sikur kemi edhe raste edhe shembuj në qytete të mëdha perëndimore, që ata që dëshirojnë të futen me makinë në qendër të paguajnë taksa të veçanta. Është mirë të bëjmë rregulla të ndryshme, në këtë rast në interes të një ajri më të mirë dhe të një ambienti më të mirë për qytetarët. Të investohet më shumë në filtrat e të gjithë ndotësve potencialë ose të detyrohen t’i vendosin, përfshirë termocentralet, ekonomitë hoteliere, operatorët e mëdhenj dhe të vegjël ekonomikë, autoservisët, qendrat e ndryshme përpunuese të djegësve të lëndëve, e tjera. Të kontrollohet importi i çdo lloji lënde djegëse, por edhe kontrolli dhe ndalimi i eksportit të thëngjillit në mënyrë të palicencuar.

Në bazë të informatave që i kemi si deputetë, kemi mbi 20 pika ilegale të eksploatimit të thëngjillit. Sot nxjerrin pa leje dhe pa kushte, dhe ai thëngjill u shitet qytetarëve, edhe në Prishtinë, por edhe në komunat tjera.

Andaj, mendoj që ne si institucione duhet t'i nxjerrim disa rekomandime sot, të cilat do të ndikojnë direkt në përmirësimin e ajrit në Republikë të Kosovës. Në të njëjtën kohë ta kemi një strategji konkrete të harmonizuar nga ministrat përkatës që e kanë këtë fushë dhe komunat se disa kompetenca bien edhe mbi komunat dhe në të njëjtën kohë ta kemi një raport të masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të shikojmë se cilat masa i ka ndërmarrë që brenda 30 ditës të shohim çka ka vepruar Qeveria konkretisht.

Ky debat konsideroj që është i mirë, por nëse nuk marrim masa konkrete në zbatueshmërinë e ligjeve, apo edhe plotësim ndryshimin e ligjeve përkatëse nëse propozohen nga ministrat përkatës në këtë rast, atëherë ne kot mund të diskutojmë këtu, mund të bëjmë debate të mira, fjalime të mira, por pa veprime nuk përmirësohet jeta e qytetarëve. Ne nuk jemi këtu që të futim panik te qytetarët, por që të qytetarëve t'u ofrojmë zgjidhje dhe të ju tregojmë se Kosova dhe institucionet e saj kanë ndërmarrë veprime konkrete, i kanë harmonizuar politikat e nivelit qendror dhe të nivelit lokal për ndryshimin e jetës dhe për një jetë më të mirë dhe një ajër më të shëndetshëm për të gjithë qytetarët.

Unë ju falënderoj dhe pres që nga kjo seancë të dalin rekomandime konkrete të zbatueshme nga institucionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Dje dhe sot u diskutua shumë, u tha shumë, pa dashur të ndalem shumë sa për të thënë diçka, po mundohem të kontribuoj direkt ndoshta në rekomandimet.

Natyrisht se gjendja aktuale sa i përket mjedisit, ndotjes së ajrit në Prishtinë, s'do mend se është pasojë e mospunës së institucioneve relevante tash e dy dekada. Kjo nuk është risi, prandaj po shkoj në rekomandimet, të cilat unë mendoj që do t'i kontribuojnë grupit që u formua pak më parë nga grupet parlamentare.

Në radhë të parë, rekomandimi i parë, mendoj që Qeveria do të duhej të marrë vendim që të ndalohet qymyri për ngrohje të ndërtesat kolektive me arsyeshmërinë që të gjithë që jetojnë në Prishtinë, besoj e kuptojnë që një ndotje shumë të madhe, për të mos thënë gati kryesore në Komunën e Prishtinës e bëjnë pikërisht këto ndërtesa. Pastaj, subvencionimi i Komunës së Prishtinës, por jo vetëm i Komunës së Prishtinës, por më shumë është Komuna e Obiliqit dhe

qytetarët që atje i vuajnë pasojat, jo vetëm kur ne po diskutojmë, por me vite. Pra, subvencionimi i Komunës së Prishtinës dhe komunave tjera përreth për mbjelljen e pemëve, përkatësisht gjelbërimi i hapësirave të atakuara gjithandej nga ndotja e ajrit në afat sa më të shkurtër kohor.

Përkrahja e këtyre komunave nga institucionet qendrore për ngrohje tjera alternative me pasoja shumë më të vogla sesa që aktualisht e kemi. Nëse veç tashmë dihet që ndër ndotësit kryesor është Termocentrali “Kosova B”, me urgjencë të pastrohen filtrat për të cilët po thuhet se nuk janë pastruar që nga viti 1985.

Inkurajimi dhe përkrahja e rezervë e projekteve kreative me ide të reja, të cilat do të ishin në funksion të përmirësimit të gjendjes aktuale tepër shqetësuese në kryeqytet, por edhe në komunat tjera, përjashtuar ndoshta komunën e Fushë-Kosovës, meqë dje kryetari tha që “kjo temë është banale dhe e shpifur”. Sipas kryetarit, jo sipas meje. Pastaj, të studiohen në afatin sa më të shkurtër mundësitë dhe kapacitetet tona shtetërore për një transport modern elektrik përgjatë gjithë kryeqytetit. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare të gatshme për të ndihmuar në zgjidhjen afatgjate të këtij problemi të madh si zëvendësim i lëvizjes së mijëra automjeteve vetëm brenda një dite.

Evitimi i djegieve të lëndëve tjera helmuese, përveç thëngjillit, siç është edhe djegia e gomave. Pra, këtu puna kryesore është e Inspektoratit dhe, në fund, ndoshta do të duhej të rishikohej vendimi i marrë nga ministritë përkatëse, pra nga ajo e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Ambientit, sinqerisht këtë vendim kisha dashur të di sa deputetë e kanë respektuar, ngase edhe sot kemi parë që ka pasur qytetarë që janë arrestuar, pa dashur të di arsyen, po megjithatë nuk e di deputetët, në radhë të parë, a e kanë respektuar a jo?

Pra, me një fjalë, sinqerisht e përgëzoj ministrin për përkushtimin që të ballafaqohet me çfarëdo problemi, jo tash, po qysh nga muaji shtator, por bashkërisht pra, më shumë mund të bëjmë dhe mund të punojmë, në mënyrë që të kemi rezultate, jo për të mbajtur seanca për dy ditë rresht, ne mund të dalim më shpejt me rekomandime dhe të mos humbim shumë kohë për të diskutuar dhe, në fund të fundit, nuk dihet se sa do të ndikojnë në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Shala e ka fjalën, nuk është. Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Želim da podržim inicijativu predsednika Parlamenta u vezi zabrinjavajući zdravstvenog stanja naših građana. U okviru poštovanja ljudskih prava, pravo na život, prava na zdravstvenu životnu sredinu i zdravu.

Mi smo u obavezi i dužni smo našim građanima i da garantujemo ostvarivanje i poboljšanje opštih usova života.

Problemi koji su se javili u okviru aero zagađenja velikih gradova, posebno Prištine, ako i nisu rešeni potiču iz nekoliko izvora. Termoelektrane koje ne koriste savremene tehnologije u cilju smanjenja zagađenja, uglj i drva koja čine osnovna sredstva za grejanje u domaćinstvima i malim preduzećima.

Moguća rešenja kao dugoročno efektivnog karaktera je gasifikacija ceo Kosova i u tom smislu mi imamo određene zalihe gasa kod Obilića koji bih država trebala dobro da iskoristi. Zatim bi trebalo poštovati kontrolu rada Termoelektrane i njihovih pridržavanja zaštite životne sredine u procesu proizvodnje.

Jedno rešenja je ozelenjivanje gradskog područja, odnosno u formi parkova ili manjih zelenih površina, to bi trebalo biti prioritet lokalnih samouprava, zato što pored ekološke komponente, zelenilo daje i estetsku dimenziju gradu koju ga treba dodatno oplemenjivati.

Gospodo poslanici,
Predstavnici Vlade,

Već je deset godina od nezavisnosti naše države i tek sada se po prvi put neko javlja da nam je jako loša situacija po pitanju zagađenja.

A tokom deset godina nikakve mere nisu preduzete, ministri nam se stalno menjaju, predsednici opština ne menjaju svoju strategiju oko divlje gradnje, oko zagađenosti reka, oko seća šuma koja postala biznis za pojedince, trebalo mi bi do sutra da govorim samo o Prevalu o nelegalnoj izgradnje raznih vikendica, počev od političara pa nadalje, o otpadnim vodama koja narušavaju život svima nama koji živimo u Prizrenskom regionu, počev od gornje sela Mušnikova, Rečane, Prizrena, tok reke Bistrice koja ide kroz centar grada, pa sve do Drima.

Poštovani predstavnici Vlade,

Neko mora snositi odgovornost, ali i posledice zbog svega ovoga. Mi ne smemo više da ćutimo i pokrивamo određena lica koja individualno profitiraju, imamo dobre Zakone koji se trebaju samo implementirati na terenu o zaštiti životne sredine, o zaštiti nacionalnih parkova, zaštićenih zona, a sve se to reflektuje na poboljšanje zdravstvenih i bezbednosni uslova naših građana.

I mi smo u obavezi da to poštujemo, a ne ovde dva dana raspravljamo i stvaramo političke poene kod naših građana. Hvala.

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Fatmire Kollçaku, le të përgatitet Hykmete Bajrami.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, kryesues!

Tashmë është dita e dytë kur po flasim për një temë aq të rëndësishme, e cila po trajtohet si një temë ad-hoc, kinse ka ndodhur diçka që nuk po ndodh tash e shumë vjet, të mos themi në 20 vjetët e fundit, dhe çfarë po bëjmë ne si shtet, edhe pse normalisht pavarësia ka ndodhur më vonë, por asgjë nuk na ka penguar së paku ta pengojmë degradimin e egër mjedisor.

Edhe në botë nuk është folur aq shumë për degradim mjedisor, mund të them se deklarata e parë, apo njohja e parë zyrtare e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm erdhi me Deklaratën e Stokholmit, e cila doli nga eko takimi i parë global në vitin 1972.

Mirëpo, shtetet e tjera, shtetet që mendojnë për impaktin e ndotjes në shëndetin e njeriut, iu kanë qasur shumë seriozisht temës së degradimit mjedisor. Normalisht nuk bëhet fjalë veç për ndotje të ajrit, ndotja e ujit, tokës, keqpërdorimi me pesticide, përveç krejt kësaj që kemi folur për ndotje këtu tash e dy ditë janë direkt impakti në shëndetin e njeriut, ajo me çka ushqehemi, ajri të cilën e thithim dhe pasojat të cilat janë evidente.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, si punëtorë e të cilit jam edhe unë si epidemiologe, do të thotë punëtorë e preventivës, e ka ngritur këtë çështje tash e një kohë.

Ne si shtet nuk po e pranojmë ndotësin më të madh dhe këtu po e shoh që ka tendencë për minimizim e ndotjes nga termocentralet.

Në momentin kur jemi edhe para miratimit të strategjisë energjetike dhe para ndërtimit të kapaciteteve të reja, shtrohet pyetja: a duhet ta shikojmë interesin material, apo prapë a do ta shikojmë atë impaktin përfundimtar, reperkusionet në shëndetin e njeriut? Sepse, të mos harrojmë, pasojat në shëndetin e njeriut janë varësisht nga kohëzgjatja e ekspozimit ndaj ndotësve dhe koncentrimi në ajër dhe aty janë më të atakuar qytetarët e komunës së Prishtinës, Kastriotit, Fushë-Kosovës, do të thotë Prishtina me rrethinë. Të mos i citojmë të gjithë ndotësit këtu që u përmendën. Por, prapë po i kthehem temës kryesore.

Ne nuk guxojmë si shtet të dalim dhe të themi se ne nuk e dimë në çfarë përqindjeje kemi ndotje prej secilit nga ndotësit që u përmendën. Detyra e parë është që vërtet të përcaktohen ndotësi më i madh dhe ndotësit e tjerë dhe ashtu pastaj të merren masa.

Mua më vjen mirë që ministrja e re po shpreh vullnet dhe dëshirë që t'i qaset kësaj teme. Por, çka po bëjmë ne si shtet? Ne nuk e kemi ndërtuar një sistem, sikurse që nuk e kemi as sistemin informativ shëndetësor të ndërtuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe tani ne ta kemi vërtet një regjistër të kancerit, një regjistër të saktë të sëmundjeve të sistemit respirator dhe kardiovaskular, do të thotë e zemrës dhe e mushkërive, dhe ta dimë me vite si ka shkuar regresioni, degradimi i shëndetit të qytetarëve. Të mos harrojmë, ne mund të kemi atak të përkohshëm nga kjo ndotje

alarmante 3-4 ditëve të fundit, që fatmirësisht, duke i falënderuar Ambasadës Amerikane u ngrit dhe u thirr kjo seancë, në vend se ne të kemi takime të rregullta si Kuvend i Kosovës lidhur me temën e degradimit mjedisor, ku në vazhdimësi do të vijnë ministrat dhe Kabineti qeveritar, sepse kjo është temë multidisiplinare dhe nuk ka mundësi vetëm Ministria e Mjedisit ta trajtojë dhe këtu të kërkojmë vazhdimisht raportim nga secili dikaster veç e veç, që është përgjegjës lidhur me çdo veprim që merret si në strategjinë energjetike, si në çdo veprim tjetër, të flasim për impaktin e shëndetit të njeriut. Unë vij nga komuna e Pejës dhe kurrë më e lumtur nuk jam si tani se jetoj në Pejë.

Mirëpo vetë fakti që të gjithë të tjerët që jetojnë në Prishtinë me rrethinë, si komuna më e ndotur, të mos harrojnë se pasojat, një atak akut që mund ta kenë këto ditë, po të mos i harrojmë pasojat që janë afatgjate, qysh nga e kaluara apo në të ardhmen, sepse fatkeqësisht si popull e kemi tendencë që të kemi kujtesë të shkurtër, por edhe të mendojmë pak për të ardhmen tonë.

Ajo që nuk na pengon sot, nuk na paraqet problem për të ardhmen, por nëse i shikojmë edhe ato pak të dhëna që i disponon Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i cili vazhdimisht kërkon bashkëpunim nga të gjitha institucionet, si në nivel parësor, dytësor dhe terciar që të raportojnë në baza të rregullta, jo vetëm sëmundje ngjitëse, por edhe sëmundjet kronike jongjitëse dhe mungesa e raportimit të rregullt na bënë të mangët në informacion.

Megjithatë, të dhënat që i disponon Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike janë treguar shumë të mira që sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes, do të thotë sistemit respirator, kardiovaskular, si dhe kanceri, përkundër faktit që nuk e kemi ende regjistrin e kancerit, janë në rritje dhe atë, rritje alarmante.

E ftoj këtë Kuvend si dhe Qeverinë që t'i qasen me prioritet të lartë temës së degradimit mjedisor dhe përmirësimit të situatës, si me masa emergjente që janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren, por shumë më tepër me ato afatmesme dhe afatgjata, sepse kjo temë është njëra ndër më të rëndësishmet.

Po ashtu e ftoj ministrinë dhe ministren Reshitaj që të konsultojë ekspertët, edhe pse nuk jemi shumë ekspertë që merren me tema të mjedisit, por megjithatë, ata që janë, shumë më tepër të përfshihen në grupet punuese, se sa të jenë ekipe ku janë përfaqësuar me ekspertë edhe huazi-ekspertë, që fatkeqësisht shumë janë në ministri të ndryshme, por kemi ekspertë që nuk janë ndoshta kuadër politik, por janë të përfshirë në task-forcën, sepse është shumë me rëndësi të ketë një qasje multidisiplinare dhe të dëgjohet zëri i ekspertëve si vendorë, ashtu edhe ata që janë në shtete të tjera dhe kanë përvoja, të cilat janë të ngjashme me tonat. Se tek e fundit, ju e dini që një katastrofë ekologjike nuk ka kufij dhe ajo çfarë ndodh në shtetet përreth, shumë shpejt pasojat janë edhe në vendin tonë dhe e kundërta.

Ju falënderoj dhe shpresoj që ky, edhe pse u thirr si një takim ad hoc i Kuvendit të Kosovës, i nxitur nga Ambasada Amerikane dhe matjet që janë bërë, të jetë në baza të rregullta që ne ta ftojmë Qeverinë të raportojë vazhdimisht këtu për masat që do të ndërmerren në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është mirë që po e mbajmë një seancë të tillë, është turp që seancë të tillë nuk kemi mbajtur përpara për Obiliqin.

Jeta e fëmijëve, jeta e qytetarëve të Obiliqin aspak nuk është më e pavlefshme se jeta e qytetarëve të Prishtinës.

Nuk është dashur të pritet që ajri të ndotet në Prishtinë, në mënyrë që të ndërmarrim masa të tilla. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të rasteve të ndryshme të sëmundjeve pa shërim të qytetarëve të Obiliqit.

Po besoj që termocentralet, si shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit, për të cilën jemi pajtuar shumica nga ne në këto dy ditë, më shumë me ndotjen e ajrit në Obiliq dhe në Fushë-Kosovë dhe në fshatrat përreth, se sa në Prishtinë. Ne duhet të mësohemi që qytetarët e Kosovës t'i trajtomë njësojë, jo të trajtohen ndryshe ata qytetarë ku jetojmë ne.

Parafolësja tha se është shumë e lumtur që jeton në Pejë dhe atje ka një ambient të pastër. Unë dua t'i tregoj asaj që familja ime jeton në fshatin Sferkë e Thatë, doponia e pesë komunave në Rrafshinë e Dukagjinit gjendet pikërisht në mes të fshatit Sferkë e Thatë dhe Lutogllavës, është deponi sipërfaqësore, 10 vjet atë deponi e ka mirëmbajtur KFOR-i italian, çka i falënderoj nga zemra, pas dhjetë vjetëve aty askush nuk ka bërë asnjë investim. Mbeturinat e pesë komunave zbrazen aty, banorët e fshatit Sferkë, Lutogllavë, Restenik dhe fshatrave përreth jetën gjatë stinës së verës e kanë të padurueshme.

Tokat e punueshme aty janë helmuar, ngordhin bagëtia dhe jeta është bërë e papërballueshme dhe aty nuk ka lumturi, ka lumturi për qytetarët e Pejës, të Istogut, të Deçanit, të Klinës, të cilët mbeturinat i mbledhin dhe kompania publike "Ambienti" shkon dhe i zbrazen aty. Askush nuk është lodhur që të groposet aty e t'i hedhin mbeturinat, me t'i mbulojnë, siç ka bë dhjetë vjet KFOR-i italian.

E nderuar ministre,

Më herët më tregove që për menaxhim të mbeturinave buxheti është zero. Unë sot u bëj thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që për të gjitha rekomandimet të vendosim kosto të përafërt buxhetore, ta obligojmë Ministrinë e Financave, ministrin përgjegjës, institucionet përgjegjëse që të gjejnë buxhet. Nëse kjo është e pamundshme në këtë fazë, atëherë në rekomandime të thuhet që të gjitha këto të jenë të përfshira në rishikim të buxhetit në vitin 2018. Rekomandimet pa kosto buxhetore janë të kota.

Tani, të nderuar kolegë, po kthehem te çështja e cilësisë së karburanteve. E ndjej përgjegjësi të them disa fjalë, sepse për dy vjet e shtatë muaj kam qenë ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Gjendjen nuk e kam gjetur të mirë, historikisht kontrolli i cilësisë së karburanteve ka qenë problem dhe a e dini pse? Sepse operatorët privatë që janë importues të karburanteve janë kontrolluar nga laboratorët privatë dhe nga trupat inspektuese që kanë qenë privatë.

Për një vit e gjysmë kemi punuar në legjislacion, jemi konsultuar me EULEX-in, kemi pasur ndihmë nga Bashkimi Evropian, USAID-i, nga Ambasada e Britanisë.

Kemi konsultuar të gjitha palët, kemi ardhur në përfundim që cilësia e karburanteve duhet të kontrollohet nga institucionet shtetërore.

Kemi nxjerrë Udhëzimin 01/2017 dhe kompetencën e kontrollit të cilësisë së naftës e kemi kaluar te Doganat e Kosovës.

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, me dhjetëra maune, pasi kanë ardhur në kufij, janë kthyer mbrapa, kur e kanë parë seriozitetin e Doganave të Kosovës.

Dhe, a e dini çfarë? Ministri aktual, i cili vjen nga radhët e “Nismës”, po e ndryshon Udhëzimin administrativ 01/2017, sepse do ta marrë kontrollin e cilësisë së karburanteve nga doganat dhe prapë ta kthejë te trupat inspektuese ose te operatorët privatë, sido që t’i quajmë ata.

Shoqata e Naftëtarëve ka qenë kundër politikave tona, sepse atyre nuk u konvenon që të ketë cilësi të rreptë. Cilësia duhet të kontrollohet nga dora e shtetit.

Ajo çfarë ne kemi lënë gjysmë dhe ka mbetur në gjysmë, për shkak se mandati ynë mbeti në gjysmë, ka qenë blerja e një laboratorit shtetëror.

Të nderuar deputetë,

Të hyrat në Doganë nga akciza dhe taksa të tjera për karburante janë një milion euro në ditë. Krejt çka duhet është që Qeveria të ndajë një milion euro për të blerë një laborator shtetëror për kontrollin e cilësisë së naftës. Ndërkohë që cilësia e brendshme, brenda territorit, e naftës duhet të kalojë në kompetencë të Ministrisë së Ambientit. Prapë është konflikt i interesit që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë t'i licencojë pikat e karburantit dhe të njëjtën kohë të inspektojë cilësinë e tyre.

Ju e dini shumë mirë që unë në legjislaturën e kaluar kam sjellë edhe Ligjin për naftën. Ai ligj në mes të dy leximeve ka pësuar, sepse është ndikuar nga grupet e interesit dhe jam detyruar ta tërheq ligjin në seancën e fundit, në lexim të dytë, për shkak se si i tillë ka qenë i dëmshëm dhe ka qenë i paimplementueshëm.

Andaj, kudo që të jetë kontrolli i cilësisë së karburanteve, ai duhet të bëhet nga institucionet shtetërore dhe duhet të bëhet nga një laborator shtetëror.

Sot në rekomandime duhet të ndajmë buxhetin, ai buxhet është dashur të ndahet në rishikim të vitit 2017, nuk është ndarë, duhet të ndahet sot.

Inspektimi nga trupat privat mund të ndodhë në Gjermani, po jo në Kosovë. Na falni, se kemi afera të korrupsionit e mbiafera edhe në KEK, edhe në inspektim të naftës e kudo tjetër.

Ne nëpërmjet mekanizmave shtetërorë duhet të kontrollojmë një materie, e cila është kaq vitale dhe kaq e rëndësishme.

Edhe një herë po rekomandoj që për cilindo rekomandim sot të vendosen kostot buxhetore, të bëhet obliguese për Qeverinë që nëse nuk mund të hyjnë sot këto në buxhet, atëherë të futen në rishikim të buxhetit.

Sa i përket komunikacion, të nderuar deputetë,

Dua t'ju sjell vëmendjen vetëm te një shembull konkret.

Ndalesa e komunikacionit nuk besoj që sjell rezultate. Ne duhet të angazhohemi, Komuna duhet të angazhohet në eliminimin e fyteve të ngushta, duhet të formohen rrugë njëkahore. A e dini që vetëm te Rrethi i flamurit në Prishtinë, te shkolla "Ali Sokoli" secili nga ne që udhëton me veturë rri 15 minuta minimum me veturë të ndezur duke pritur në radhë. Krejt kjo për shkak se Komuna e Prishtinës nuk i vendos pengesat, në mënyrë që kalimtarët këmbësorë aty ta shfrytëzojnë mbikalimin. Nëse mbikalimi është i papërshtatshëm, aty me 50 mijë euro mund të bëhen shkallë rrëshqitëse dhe të mos kemi fyte të tilla të ngushta, të tilla nje të pakalueshme kemi në gjithë Prishtinën. Andaj duhet të mendohet në mënyrë strategjike dhe jo me zgjidhje ad hoc. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Përshendetje, ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Dua ta filloj me diçka që tha zoti Haliti gjatë kësaj seance.

Më kujtohet vitet '80-ta e bisedova edhe me një koleg, ka qenë një shkrim në "Zërin" javor të asaj kohe dhe realisht ka qenë një pamje sikurse tash e Prishtinës dhe bëj pyetje, kush dhe ku do ta zhvendosë Prishtinën?

Thonë janë çështje të trashëguara dhe sigurisht po të futemi në arkiva të "Zërit" javor, të revistës "Zëri" të asaj kohe do ta gjejmë atë, do të thotë kjo çështje është trashëguar dhe nuk dua tash ta arsyetoj as veten, e asnjë nga institucionet tona, as këtë parlament të nderuar. Po realisht janë probleme të trashëguara dhe herë pas here kanë marrë përmasa që janë shqetësuese dhe sigurisht duke i ndërthurur, ndërlidhur me faktorë të tjerë, sigurisht që pasojat janë shumë më të rënda.

Koncepti rreth zhvillimit ekonomik, nuk është vetëm sa i përket zhvillimit ekonomik, ai është kontekstual dhe shumëdimensional dhe si i tillë nuk kufizohet vetëm te të mirat ekonomike, po përfshin të gjitha sferat e jetës, me rastin konkret edhe atë esencial, ambientin në të cilin po jetojmë.

Ne kemi pasur një zhvillim ekonomik çfarë kemi pasur, mirëpo shumë pak jemi kujdesur për ambientin tonë.

Kur kemi parasysh se çfarë po ndodh jashtë në ambientin tonë, me ajrin të cilin e absorbojnë qytetarët e Republikës së Kosovë, në përgjithësi, e qytetarët e kryeqytetit të Prishtinës dhe rrethinës, duke përfshirë edhe Obiliqin dhe dua ta bëj në digresion që është bërë këtu një debat për Obiliqin dhe është miratuar Ligji për Obiliqin.

Mirëpo ne kemi shumë ligje të miratuara, kemi shumë rezoluta të miratuara, por nuk i kemi zbatuar dhe nuk e kemi përcjellë zbatueshmërinë e tyre.

Dhe, pashmangshëm kërkon mobilizimin e përgjithshëm institucional e qytetar për të afruar zgjidhje, e cila kërkon masa të menjëhershme për ulje të vlerave të ndotjes. Po në të njëjtën kohë kërkon trajtim adekuat dhe të vazhdueshëm që qytetarët të mos përballen me ajrin kaq të ndotur dhe me pasoja kaq të mëdha për shëndetin, edhe të vetë neve, se edhe ne po jetojmë këtu dhe pjesën dërmuese të kohës jemi duke e kaluar në Prishtinë.

Ne kemi shumë raporte nga organizatat e ndryshme botërore, siç është Organizata Botërore e Shëndetësisë, për rastet, për pasojat, për të gjitha.

Kemi edhe në Raportin e Progresit për vitin 2014, 2015 e 2016, i cili thekson se zbatimi i legjislacionit që i adreson sfidat lidhur me ndotjen e ambientit është i mangët dhe institucionet nuk po i zbatojnë rekomandimet e BE-së.

Kemi rekomandime, thashë edhe një herë, nga BE-ja, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë se sa mikrogram në metër kub kemi ndotje dhe shumëçka tjetër.

Ne duhet të themi se kanceri është bërë tash gati si gripoz dhe një nga pasojat e sëmundjes së kancerit është pikërisht ajri i ndotur dhe jo sikurse që thirren ata të cilët nuk e kanë dashur dhe nuk e duan lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, që është vetëm nga bombardimet e NATO-s. Është edhe mungesa e kontrollit të ushqimit dhe shumë faktorë të tjerë.

Ne e dimë gjithashtu se i kemi afro 12 ligje të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës dhe shumë udhëzime administrative në fuqi, por rezultat kemi ajrin çfarë e kemi tash, ajrin shumë të ndotur.

Kosova nuk është duke vuajtur mungesën e ligjeve, por mungesën e një monitorimi rreth zbatimit të tyre nga institucionet përkatëse. Shtrohet dilema se si është e mundur që kaq shumë ligje e udhëzime administrative dhe ambienti ynë shkon duke u përkeqësuar. Duhet ta kemi parasysh edhe matjen, në të cilën po thirremi shumë. Ajri më i ndotur është pas orës 16:00, kur të gjithë ne dhe familjarët tonë kthehemi nëpër shtëpitë tona dhe atëherë fillon faktikisht ajri të ndotet shumë më tepër. KEK-u, nuk dua ta arsyetoj, por që nga viti 2014 ka bërë investime të dukshme dhe ato janë parë edhe në filtrat, të cilët janë vendosur dhe ka një ndikim shumë të ndjeshëm sa i përket zvogëlimit të ndotjes së ajrit. Dhe, ta kemi parasysh që ndalimi i thëngjillit nënkupton që institucionet tona, Qeveria, në radhë të parë, përkatësisht ministria përkatëse do të duhej të ofrojnë mbështetje sociale për ato familje, por nëse e kemi dilemën nëse do të duhej të ngrohemi me diçka që helmon ose na helmon, apo t'i mbështetim prej fondeve tona çfarë i kemi, prej buxhetit tonë, patjetër që do të duhej ta zgjedhim këtë të dytën, dhe kjo është shumë me rëndësi.

Besoj se dëmi është shumë më i madh nëse kemi pak të ftohët, ose kemi ftohje, sesa ta ndotim ambientin për të gjithë ne, edhe për familjet tona.

Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore është njëra nga mundësitë. Administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë, ndalimi dhe kthimi pas procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit janë disa nga masat, të cilat do të duhej që ne nëpërmjet rezolutës, e cila sigurisht do të votohet këtu, nëse do të kemi deputetë të mjaftueshëm, se edhe po lodhemi shpesh, u

lodhëm dhe shumë shpejt dhe e ndërpreme seancën, por ja edhe sot numri i deputetëve nuk është i mjaftueshëm.

Të nderuar, përveç sanksioneve ligjore që kanë institucionet e Republikës së Kosovës, ato duhet të marrin masa shtesë për ta përmirësuar situatën e krijuar të cilësisë së ajrit, duhet një komunikim më i mirë ndërinstytucional për të parë se si po shkon zbatueshmëria e ligjeve dhe planeve të hartuara. Duhet të ketë edhe ide kreative në raport me institucionin-qytetarë sa i përket, jo vetëm zbatueshmërisë së ligjeve, por edhe përtej kësaj, që shkon në të mirë dhe interes të gjithmbarshëm qytetar. Po shoqëria civile dhe të gjithë ata, të cilët e proklamojnë dhe e duan ajrin e pastër, do të duhej të kyçen dhe të jenë pjesë aktive e të gjitha këtyre zgjidhjeve.

Ngrohtorja e kryeqytetit - Ne e dimë se kogjenerimi ka filluar, mirëpo KEK-u ka kapacitete që edhe për 50% ta shtojë këtë mundësi. Do të duhej që kjo të ndodhë sa më shpejt që është e mundur dhe do të duhej që vërtet të mbështetet nga të gjitha institucionet relevante, të cilat janë të thirrura dhe janë përgjegjëse për investimet e tilla dhe për mbështetje të tilla.

Makinat me defekte teknike - Përveç bashkëpunimit institucional duhet kontroll i shtuar i makinave, të cilat kanë filtra të ajrit dhe janë të shumta që e ndotin në masë të madhe ajrin. Do të duhej të shtohet kontrolli i derivateve. Ka pasur ide, ka pasur laboratorë, të cilët kanë pasur mekanizma dhe kanë pasur mundësi t'i kontrollojnë ato, por është koha e fundit tash që ne në të gjitha aspektet, pavarësisht se çfarë kemi bërë më herët, pavarësisht kush ka qenë në pozitë dhe opozitë, pavarësisht kush ka qenë ministër dhe pavarësisht se kush ka qenë qytetarë i zakonshëm. Është një moment vendimtarë që ne të mobilizohemi si tërësi. Ky Parlament është i thirrur dhe është më adekuati, për këtë arsye edhe kryetari i Kuvendit e ka thirrur këtë debat parlamentar, duke pasur parasysh që ne do të dalim unikë dhe nga ky aspekt do të jemi ata, të cilët do t'i lëvizim të gjitha levat për ta krijuar një ambient të pastër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica!

Para se ta vazhdojmë diskutimin, duhet të ju njoftoj që grupet parlamentare i kanë caktuar deputetët për t'i bërë rekomandimet pas debatit dhe për t'i votuar ato. Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" e ka caktuar Dardan Sejdiun; Grupi Parlamentar i LDK-së e ka caktuar Besa Gaxherrin; Grupi Parlamentar i PDK-së Evgjëni Thaçin; Grupi Parlamentar i AAK-së, Teuta Haxhiun; Grupi Parlamentar "Nisma" e ka caktuar Enver Hotin; Grupi Parlamentar "6+" e ka caktuar Albert Kinollin.

Tani është mirë që ta caktoni kohën, ndoshta do të ishte e përshtatshme nga 12 e gjysmë të takoheni dhe të filloni nga puna sa u përket këtyre çështjeve. Nëse dikush s'ka diskutuar nga të paraqiturit para se të shkojë në takim të përbashkët është mirë të paraqitet dhe ta kryejë diskutimin, që të mos i ngelet merak pa diskutuar, që të shkojë në mbledhje për rekomandime.

Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të dashur qytetarë dhe

Ju kolegë deputetë,

Problemi i ndotjes së ajrit, ujit dhe mjedisit konsideroj që u takon ekspertëve që janë profesionalë në këtë lëmi, mirëpo identifikimi i ndotjes dhe pastaj cilat janë masat që duhet të merren, besoj që këto janë ato të cilat duhet t'i diskutojmë bashkërisht, mirëpo punën përfundimtare dhe vendimtare në këtë drejtim konsideroj që e ka grupi i ekspertëve, e jo ne deputetët, për të cilët shumica prej nesh, prej ditës së djeshme i kanë diskutuar, mirëpo mendoj dhe konsideroj që një pjesë shumë e vogël e grupeve parlamentare janë njerëz të profileve që janë profesionalistë në këtë lëmi.

Dua t'i theksoj dhe unë disa prej shqetësimeve, apo të cilat konsiderojmë që ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe ato u diskutuan edhe dje prej shumë folësve, prej shumë deputetëve këtu, mirëpo është e udhës t'i diskutoj edhe unë disa prej atyre shqetësimeve që mendojmë që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e ajrit.

Elektro-filtrat e TEC "Kosova B" nuk janë ndërruar, siç thanë edhe disa prej folësve tjerë, prej viteve të '80-ta. Kuvendi, pra ne, duhet të kërkojmë prej Qeverisë, që KEK-u sa më parë t'i ndërmarrë procedurat, domethënë t'i përfundojë ato procedura tenderuese për zëvendësimin e tyre. Mirëpo, këto, siç thanë edhe parafolësit e mi, personat që janë drejtpërdrejt prej Qeverisë, duke e përfshirë edhe kryeministrin, që po na mungon në seancë, edhe dje, edhe sot, dhe s'di se sa do të na i marrë parasysh të gjitha këto që po i flasim dy ditë vazhdimisht.

Deri më tani, procedurat tenderuese janë filluar tri herë dhe janë anuluar. E fundit ka qenë në vitin 2016, dhe ato për shkak të specifikave të caktuara, i ka ndaluar OSHP-ja. Sipas punëtorëve të KEK-ut dhe sipas informacioneve që i kemi marrë në terren, ato janë anuluar për shkak të përpjekjeve dhe manipulimeve të tenderit, meqenëse aty ka qenë një vlerë shumë e madhe. Para dy ditësh është raportuar nga Qeveria dhe Zyra e BE-së në Kosovë që e kanë marrë përsipër këtë proces. Unë dua të di dhe njëkohësisht dua ta pyes Qeverinë, mirëpo në këtë rast vetëm një ministre e kemi të pranishme, kur do të ndërrohen elektro-filtrat e Termocentralit "Kosova B"?

Besoj që ndoshta ndonjëherë marrim përgjigje, mirëpo tani për tani veç pyetje kot bëjmë. Elektro-filtrat do të dështonin menjëherë siç edhe ka ndodhur vazhdimisht në TEC "Kosova B", meqenëse nuk do të modernizohen dhe ato pa vonesë, sepse sistemi i transportit të hirit duhet të rikonstruktohet tërësisht. Aktualisht, është problemi më i rëndë që shkakton edhe ndotjen më të madhe përreth TEC "Kosova B". Është ky sistem i cili nuk mbërrin të zhvendosë sipas parametrave hirit dhe të ulë mënyrën drastike të funksionimit të elektro-filtrave.

Një shqetësim tjetër është edhe formimi i një task-force, e cila është formuar së fundmi nga Qeveria e Kosovës dhe e cila në vete i ka përfshirë vetëm ministrat e jo specialistët shëndetësorë, kimistët, inxhinierët e mjedisit, apo edhe të tjerët.

Ky është një sinjal se do të vijojë përjashtimi i burimeve njerëzore të kualifikuara nga përgatitja e masave adekuata. Një nga mangësitë e patejkalueshme është edhe nxjerrja jashtë e sistemit publik të pjesës më të madhe të specialistëve, të cilët, e thashë edhe më herët, kryesisht i kanë bërë rezistencë sa kanë qenë brenda institucioneve dhe asnjëherë nuk janë ftuar në një konkurs publik.

Sot nuk i kemi as statistikat e të sëmurëve me kancer dhe as studime zyrtare nga institucionet e Kosovës për këtë çështje. Njëjtë është edhe për sëmundjet respiratore apo të tjera, të cilat vijnë nga ndotja e ajrit.

Po ashtu, nuk e kemi asnjë studim të përditësuar për ndotjen e ajrit në Kosovë, apo edhe në rajonet e caktuara, e as studime të plota, as pjesërisht të ndikimit afatgjatë të termocentraleve me qymyr që i ka Kosova.

Instituti i Shëndetit Publik, mbrojtja e mjedisit, meteorologjia, inspektoratet, janë jo vetëm me numër të vogël specialistësh, por çdo ditë e më shumë numri i tyre po largohen. Domethënë nga aty po largohen specialistët dhe po zëvendësohen me staf që kanë njohuri administrative, e gjithnjë më pak ato shkencore. Meqenëse vij nga rajoni i Prizrenit, një shqetësim tjetër e kemi, për të cilin duhet t'i tërhiqet vërejtja Qeverisë, sa u përket projekteve që po mundohen t'i futin në rajonin e Zhupës, pra hapja e hidrocentraleve të vogla përgjatë Lumëbardhit, sepse sipas politikave, të cilat janë bërë edhe në Shqipëri, në vendet e Shqipërisë, mendohet që këto projekte do ta ndotin ambientin dhe në një masë më të madhe. Bile-bile, ndotja konsiderohet që të jetë katastrofale për rajonin e Prizrenit, por edhe më gjerë.

Meqenëse kemi mundësi t'i parandalojmë ato, shpresoj dhe mendoj që duhet të parandalohen menjëherë. Kjo janë vetëm disa të dhëna, të cilat jemi munduar t'i nxjerrim, mirëpo sa i përket ndotjes së ajrit konsideroj që duhet të përfshihen ekspertët konkretë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fidan Rekaliu e ka fjalën. Le të përgatitet Nait Hasani.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Sot, vendi ynë, qytetarët tanë, rinia e Kosovës, jeton një periudhë dhe një gjendje të vështirë në kuptimin e plotë të fjalës për shkak të mungesës së shpresës, perspektivës, pasigurisë për të

ardhmen, mungesën e mbështetjes, keqkeqverisjes në të gjithë sektorët e jetës së izoluar, duke mos pasur mundësi të lëvizjes së lirë. Fakti që jemi i vetmi vend i izoluar i Evropës e lëndon dhe e cenon dinjitetin individual dhe kolektiv të tyre. Sot pothuajse efektivisht gjysma e qytetarëve të vendit përballet me rrezikun serioz të shëndetit që vjen nga degradimi i kushteve mjedisore në vendin tonë. Nuk është se ne nuk jemi të vetëdijshëm për pyetjen se nga çfarë dhe kush është faktori real për një problem të tillë që sot na ka shtyrë të diskutojmë për të.

Që vendi ynë është qeverisur keq kronikisht, këtë e di gjithsecili, por që degradimi i pandalshëm i qeverisjes po shkon drejt pikave kritike të rrezikimit të shtetit dhe të qytetarëve. Në periudhën e fundit ka pasur plot prova të tilla. Një ndër to është edhe situata e fundit me ndotjen, e cila nxori në pah dështimin total të institucioneve nga të gjitha nivelet, që kanë përgjegjësi në formulimin dhe zbatimin e politikave mjedisore.

Megjithëse ekzistojnë institucione, qoftë të nivelit ministror, apo ekzekutiv, hulumtuese dhe shkencore, qendrore dhe lokale, buxhet dhe kapacitete njerëzore që paguhet për ta përmbushur mandatin dhe rolin institucional për këtë fushë, sot gjendemi para një situatë të rëndë gati të një kufiri me katastrofë ekologjike me rrezik për shëndetin e pothuajse gjysmës së qytetarëve. A duhet që më në fund Qeveria, por edhe ky Kuvend, të kërkojnë llogari nga Ministria e Mjedisit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, institucionet tjera, Komuna e Prishtinës për atë se si lejuan të vijë kjo gjendje? Ku ishin ata? A e kanë kryer detyrën specifike të hulumtimit, matjes, përcaktimit të shkallës së rrezikut, propozimit të masave dhe veprimeve për ta ruajtur mjedisin jetësor, e rrjedhimisht shëndetin e qytetarëve?

Moskryerja e përgjegjësive dhe detyrave nga aktorët institucionalë sot ka rezultuar me një përballje të drejtpërdrejtë me ndotjen e përmasave që e tejkalon çdo standard të pranueshëm dhe në një kundërveprim komplet absurd të Komunës së Prishtinës, e cila në panik nga reagimi qytetar ka ndërmarrë disa veprime radikale dhe të pamenduara, siç është kjo e ndalimit të hyrjes së automjeteve në qytetin e Prishtinës.

Pra, gjendemi në një situatë që, pasi është prodhuar një rrezik mjedisor, nga dështimi i institucioneve kompetente, kemi reagim ad hoc, të pamenduar dhe të papranueshëm për parimet e lëvizjes së lirë të njerëzve, mundësinë e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve që të trajtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, mundësinë e dëmtimit të bizneseve që zhvillojnë veprimtari në kryeqytet dhe në rrethinën e tij. Këtu gjej rast t'i përcjell shqetësimet e afaristëve të shumtë nga Komuna e Podujevës që punojnë dhe veprojnë në Prishtinë, por edhe nga komunat tjera, të cilat janë të prekur nga ky vendim. I njëjti duhet të rishikohet dhe të pezullohet sa më parë, pasi kjo absolutisht nuk ofron zgjidhje, përkundrazi e thellon atë.

Besoj se kjo seancë, përtej debatit dhe diskutimeve të grupeve politike, duhet të nxjerrë urgjentisht konkluzione të qarta, afatgjate e obligative për Qeverinë dhe me obligime për

komisionet parlamentare për ta mbikëqyrur implementimin e këtyre masave nga Qeveria. Konsiderojmë se Komuna e Prishtinës duhet me urgjencë ta hartojë projektin për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes për të gjitha lagjet e kryeqytetit dhe të fillojë të orientojë investime për ta realizuar këtë proces, e jo të ndodhë që Komuna të dërgojë në suficit dhjetëra miliona euro çdo vit.

Qeveria duhet që t'i përgjigjet këtij projekti, duke e ditur se ka kosto të lartë financiare, që nuk mund të përballohet tërësisht nga Komuna. Paralelisht në shtrirjen e rrjetit të ngrohjes me kogjenerim duhet të ndalohen me masa kundërvajtëse komunale përdorimi i lëndëve djegëse që prodhojnë kosto mjedisore në zonat dhe lagjet që janë të mbuluara me shtrirje të rrjetit, ndërsa përdorimi i thëngjillit do të duhej të ndalohej në tërësi, nëse një gjë e tillë lejohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në të njëjtën kohë, për të siguruar një ngrohje alternative duhet të subvencionohen, nëse jo ndryshe, nëpërmjet liritimit të TVSH-së dhe taksave tjera për produktet më miqësore për ambientin, siç është rasti me pompat termike dhe peletin.

Shteti duhet të ndërtojë strategji afatgjate për ta nxitur përdorimin sa me të lartë të burimeve të ripërtëritshme në nivel vendi.

Në nivel të Qeverisë, ministrisë, agjencive dhe instituteve, që sipas ligjit janë të obliguara t'i kryejnë testimet, hulumtimet dhe përcaktimet e faktorëve ndotës, duke përfshirë edhe masat e veprimet konkrete deri në eliminimin apo zvogëlimin e atyre faktorëve. Duhet të zgjohemi nga gjumi dhe të fillojmë ta zbatojmë mandatin e tyre, secila sipas fushëveprimtarisë së vet. Këto përgjegjësi e detyra nuk janë realizuar qartë. Prandaj, kur kryeministri dhe Qeveria e inflacionojnë fjalën "punë", duhet t'u themi se ka mjaft punë për ta, të cilat as nuk i kanë bërë, e as nuk po duket se dinë t'i bëjnë. Përveç se të punosh, kërkohet edhe të dish të punosh. Megjithëse shpresa ime është te profesionistët, intelektualët, shoqëria civile dhe qytetarët, që po kërkojnë përgjegjësi, pasi kjo përbërje e udhëheqje e Qeverisë mund të më befasojë vetëm nëse do të reflektonte mbi përgjegjësitë kushtetuese që i ka, e që duket se nuk i kupton. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Të nderuar kolegë deputetë,

Një seancë e jashtëzakonshme e thirrur, ndërsa deputetët nuk e shohin gjendjen e jashtëzakonshme dhe kjo është çështja që rëndësia e kësaj seance tregohet me praninë e deputetëve, Qeverisë apo të gjithëve.

Nuk është hera e parë që në Kosovë kemi ndotje të ajrit. Mendoj që Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligje të mjaftueshme, edhe më herët, edhe tash, për ruajtjen e mjedisit dhe cilësinë e

ajrit. Me aq sa e di, meqë kemi qenë edhe pjesë e Komisionit për Mjedis, dhe kemi qenë në kontakte edhe me ato aparaturat që kanë bërë matjen e ajrit në Prishtinë, ka qenë një i vendosur te fakulteti, një te “Rilindja”, siç jemi mësuar t’i themi, dhe në 2-3 vende tjera, një ka qenë i vendosur në Han të Elezit, një në Obiliq, një në “Ferronikel”, tash janë vendosur edhe të tjera.

Kjo ndotje e ajrit nuk ka ardhur nga Obiliqi, nuk ka ardhur nga thëngjilli, nga djegia, por kjo ndotje e ajrit ka ardhur nga makinat që i djegin derivatet e naftës pikërisht nga dy kohët, të cilët theksohen edhe këtu. E para është që matjet janë bërë në mëngjes në hyrje, në orën 8:00 diku, prej 7-8 kur ka filluar hyrja e makinave në Prishtinë, po ashtu edhe daljet kur kanë qenë prej orës 16:00 kanë treguar që kemi rritje të sasisë së gazrave, të cilat e kanë ndotur edhe ajrin. Po pse ka ndodh kjo, mund të themi që derivatet e hyra në Kosovë nuk janë të cilësisë, janë me ato parametrat, që janë helmues në kuptimin e plotë të fjalës. Po e them këtë, e kemi parasysh se në Kosovë hyjnë përafërsisht 800 milionë litra naftë në vit, ose çdo ditë shpenzohen nga 2 milionë litra. Edhe aparaturat që i kanë marrë Ministria e Industrisë dhe Tregtisë për matjen e këtyre janë mbi nivelin e asaj matjes që është e lejuar. Për shembull, matja e lejuar është deri në 10 ppm, ndërsa matjet për të cilat i ka marrë aparatura Ministria e Industrisë dhe Tregtisë e marrin prej 30 deri në 500 ppm, që do të thotë është mbi dozën e lejuar.

Tjetra është që në Kosovë ka hyrë dhe petroll-koks, naftë e cilësisë që është shumë e rrezikshme për vendin. Në bazë të të dhënave, 20 milionë litra naftë e tillë kanë hyrë në Kosovë. Janë ndalë në Doganë, ndërsa janë liruar të gjitha, përveç 210 mijë litrave që janë kthyer. Do të thotë që në Kosovë ka hyrë kjo naftë, është djegur, është keqpërdorur dhe është ndotur ambienti. Tjetrën e kemi, që sasia e thëngjillit që është me matje, petroll-koksi e ka 8,5% cilësinë, ose 85 ppm, ndërsa thëngjilli e ka 10 ppm, që do të thotë 1%. Kjo do të thotë që thëngjilli nuk e ka ndotur ambientin ose mjedisin, thëngjilli nuk e ka bërë këtë gjendje të jashtëzakonshme të ajrit, por këtë e kanë bërë nafta, makinat, derivatet, të cilët kanë hyrë pa cilësi, pa kontroll në Dogana dhe në Kosovë.

Tjetra është që edhe pse është jocilesore, ne e paguajmë më shtrenjtë, e paguajmë me 1 euro, 1,05 centë, ndërsa në shtetet fqinje e kemi me 80 centë naftën cilësore. Do të thotë që ne paguajmë për t’u helmuar, do të thotë kompanitë që furnizojnë, në çdo vend është e njëjta gjendje dhe kjo nuk do koment. Komenti ynë është që kjo seancë mund të nxjerrë rekomandime, rezoluta, mund të vendosë edhe gjendje të jashtëzakonshme dhe seanca të jashtëzakonshme, por nuk e zgjidh këtë problem, nuk e zgjidh dhe as nuk ka për ta zgjidhur me asnjë rekomandim, por këtë duhet ta zgjidhë me zbatueshmërinë e ligjeve.

Cilësia e shpeshtë e dyshimtë është nga ajo se unë them që krejt kompanitë që e furnizojnë kanë ndonjë lidhje miqësore diku-diku dhe që ua kanë mundësuar për ta shtyrë këtë, edhe për t’u liruar nga Doganat, edhe për ta keqpërdorur, edhe për t’u furnizuar, e tjerë, e tjerë... Gjithë ajo çka është mund të flasim, edhe duhet të flasim, por për ta zgjidhur problemin nuk kemi drejtësi, nuk

kemi organe të drejtësisë, nuk kemi Prokurori që ndërmer masa. Ka kallëzime penale për naftën e dyshimtë, e asnjëherë nuk është marrë asnjë masë. Ata prokurorë kanë heshtur, edhe sot heshtin. Për mua është me rëndësi që kjo gjendej është ndotje politike-akustike, që e kemi quajtur, ose ndotje e ajrit politik. E këtë nuk mund ta heqim, këtë as qytetarët s'kanë dashur ta heqin kur kanë votuar në zgjedhje pikërisht për këtë gjendje, prandaj as ne sot nuk mund ta heqim, pikërisht sepse kjo ndotje vjen nga papërgjegjësia e organeve të drejtësisë, që ato e kanë sjellë këtë gjendje.

Për mua, edhe një herë, ministrja me angazhimet e veta që thotë, ne e kemi miratuar, ministre, një ligj për Obiliqin, i kemi caktuar edhe parametrat, perimetrin 5 kilometra në rreth të Obiliqit që të ketë edhe mbrojtje, por ata të Obiliqit asnjëherë s'janë ankuar, edhe kanë jetuar e jetojnë edhe sot dhe punojnë aty, për ndotjen e ajrit. Ata kanë kërkuar mbrojtje, kanë kërkuar cilësi të ajrit, kanë kërkuar zona të gjelbra, kanë kërkuar mjekësi, për t'ua dhënë mundësitë që të kenë trajtim më të mirë, por kanë kërkuar edhe lirimin nga disa taksa për shkak se jetojnë aty ku prodhohet rryma, e jetojnë pa rrymë.

Të gjitha këto ligje ne kemi mundësi t'i zbatojmë, por nuk kemi Ekzekutiv që merr masa. E di që njëherë na kanë pas kundërshtuar kur e kemi pas nisur procesin e Ligjit për Obiliqin, edhe Ministria e Mjedisit, thoshin që kemi dublifikime të ligjeve. E sa herë bëhen dublifikime të ligjeve, po shihet që prapë ngufatja e ajrit, apo rritja e sasisë së acideve të sulfurit dhe karbonit në këto po ndikon.

Ministre, zbatoje ligjin, merri masat me ato task-forca, meqë kam dëgjuar ke folur, nuk të zgjidhin problem as ato, po del priju dhe eci ato task-forca. Sa ministret, sa këshillat e ministrave do t'i kishe formuar... me aso këshillash nuk është zgjidhur asnjëherë. E kemi mësuar nga politika dhe praktika që Çerçili në njëfarë kohë kishte thënë "Kur nuk doni të zgjidhni probleme, formoni këshilla". Kështu që këto këshilla që i ke formuar nuk janë për të zgjidhur problem. Prandaj, zgjidhja e problemit fillon vetvetiu, drejtpërdrejt me angazhim, e jo me këshilla. Zbatoje ligjin, i ke zgjidhur të gjitha problemet.

KRYESEUSI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Lluka dhe pastaj replikë Nait. Ministrja e ka me ty.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Përshëndetje!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara kolege,

Vetëm një sqarim, u bisedua disa herë puna e elektro-filtrave të "Kosova B". Është një sqarim ndoshta pak teknik. "Kosova B" e ka marrë një donacion nga Bashkimi Evropian rreth 35 milionë euro. Janë të parapara gjithashtu në Buxhetin e Kosovës për vitet 2019-2020.

Arsyeja pse vitet 2019-2020, sepse tash sivjet në muajin maj Komisioni Evropian i ka përgatitur të gjitha dokumentet e duhura, pra dosjen e tenderit, dhe në muajin maj do ta shpallë tenderin, sepse është duke i përgatitur termat e referencave dhe deri në fund të vitit presim takim me fituesin. Mandej, për t'i instaluar elektro-filtrat kërkohet kohë 8-9 muaj, pra nuk është punë që bëhet brenda muajit. Kërkon që Termoelektrana "Kosova B" të ndërpritet tërësisht dhe ne nuk guxojmë që atë ta ndërpresim tërësisht për 8 apo 9 muaj, sepse pastaj do të futemi në sezonin e dimrit, kur duhet të importojë rrymë vazhdimisht gjatë kohës sa është në remont. Dhe, për ta bërë këtë nga të gjithë ekspertët preferohet që për t'i minimizuar shpenzimet të bëhet ndaras në dy sezona verore, kur kostoja e importit të energjisë është minimale, por edhe nevoja për të importuar është minimale. Prandaj, kjo është arsyeja pse duhet të shpërndahet pra në vitet 2019-2020, e nuk mund të bëhet brenda një vere apo një sezoni.

Nëse bëhet një gjë e tillë, atëherë do të shumëfishohet shuma e investimit, sepse importi, vlera e importit është shumë më e madhe sesa vlera e filtrave, që në këtë rast është paraparë të jetë 74 milionë euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Reshitaj e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Përshëndetje!

I nderuar nënkryetar i Parlamentit,

Kolegë dhe ju deputetë,

Më vjen mirë që edhe sot po flitet për ajrin, për mbrojtje të mjedisit. Desha vetëm shkurt t'i përgjigjem deputetit Nait Hasani.

Po, i nderuar deputet, ne kemi bërë ligje, i kemi rishqyrtuar me vite dhe kemi humbur shumë kohë duke u arsyetuar se ne po i rishqyrtojmë, e po i rishqyrtojmë, e po i rishkruajmë. Sot më nuk kemi kohë të eksperimentojmë me ligjet. Mendoj se i kemi ligjet. Korniza ligjore për mjedisin në 85% është optimalisht e mundur të funksionojë. Mund të ketë ndryshime të pakta që kanë nevojë, mirëpo jo aq sa për të thënë se ne nuk kemi ligje për mjedisin. Ne kemi ligje të cilat janë edhe brenda kornizave dhe nevojave të Bashkimit Evropian, mirëpo gjithmonë duke u bazuar edhe në kushte socio-ekonomike të vendit tonë, ku ne jetojmë.

E kam thënë dhe vazhdoj ta them, unë ende nuk e di saktë kush është ndotësi më i madh në Republikën e Kosovës. Për të ngre gishtin, unë që jam në krye të një ministrie, të një institucioni shtetëror të një vendi, gjithashtu unë që vij nga fusha e shkencave ekzakte, nuk më lejohet të akuzoj apo të ngre gishtin. Si një qytetare e thjeshtë mund të aludoj apo të paragjykoj se ndotësi më i madh mund të jetë KEK-u, apo nafta, apo diçka tjetër, mirëpo për ta udhëhequr një shtet ne duhet të bazohemi në fakte shkencore, duhet të bazohemi në hulumtime ekzakte, në hulumtime të thukëta, e pastaj të dalim e të konkludojmë. Dhe, besoj se nuk do ta kishim këtë situatë që secili nga ne ta japë një mendim të vetin, apo secili nga qytetarët ta krijojë këtë

konfuzion. Ne si shtet duhet të besojmë në fakte, duhet të investojmë në ekspertë, duhet të investojmë në hulumtime të mirëfillta shkencore. Ne duhet ta kemi një hulumtim të mirëfilltë, i cili do t'i hulumtojë grimcat a vijnë nga KEK-u, a vijnë nga nafta apo nga thëngjilli dhe bëjnë gjithë këtë rrëmujë, gjithë këtë smog në periudhat kur kushtet meteorologjike janë të disfavorshme.

Të dashur deputetë, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, mendoj se këtë logjikë të të vepruarit duhet instaluar në sistemin institucional e shoqëror të vendit tonë.

Kur unë marr informata nga ekspertë të ndryshëm, nga ju të nderuar deputetë, nga shumë e shumë qytetarë që më shkruajnë çdo ditë dhe të gjitha janë konfuzë, prandaj edhe një herë po theksoj - ne duhet ta kemi një hulumtim të mirëfilltë shkencor për nivelin e ndotjes së ajrit. Ne duhet ta kemi një sistem monitorues të mirëfilltë në vendin tonë, sepse jemi shtet, kemi institucione dhe ne duhet të bazohemi në të. E pastaj nuk është e vështirë, i nderuar deputet, të veprojmë. Nuk është e vështirë të veprojmë, kur ne kemi fakte, e absolutisht nuk ka logjikë, as rëndësi, nëse do të mbrohet, qoftë KEK-u, apo ndonjë institucion tjetër.

Sa i përket task-forcës që ne e kemi formuar, në tetor të këtij viti unë vetëm e kam formuar grupin punues të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, që është njëfarë lloj task-force e brendshme e ministrisë, e cila më ka dhënë informacione dhe ajo punon për pjesën teknike. Nevoja për t'u krijuar një task-forcë ndërministrorë ka qenë... Ajo gjithsesi është dashur të krijohet. Pse? Sepse, të gjithë po pajtoheni që problematika e mjedisit nuk bie vetëm në domenin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Prandaj, me krijimin e kësaj task-force do të merren përgjegjësitë e të gjitha ministrive të linjës, të cilat kanë të drejtë, kanë udhëzime administrative të ndërhuara me ligj për ta mbrojtur cilësinë e ajrit në vendin tonë.

Prandaj, mendoj se është e rëndësishme edhe politika, por edhe pjesa e ekspertëve që të punojnë bashkërisht në këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nait, a dëshiron? Zoti Nait Hasani. Po, zakonisht në debat replikat s'funksionojnë, por meqenëse ju të dytë e filluat personalisht, mund të vazhdosh.

NAIT HASANI: Thonë, mos të lashtë Zoti pa shokë. Këtu është problemi.

E nderuara ministre,

Çështjet që po i ngre si probleme, unë i kuptoj ato. Kam qenë kryetar i Komisioni për Mjedis, jam marrë me të gjitha këto probleme që sot po fliten, nuk janë të sotme, nuk janë të para një muaji, dy apo tre muajsh. Këto probleme ekzistojnë. Ajrin nuk e kemi të ndotur tash. Nuk është këto tri ditë kiameti i botës që u bë në Prishtinë, ajri ka qenë edhe vitin e kaluar, edhe tjetrin vit. Ajri është i ndotur prej pasluftës nga cilësia e naftës, jo nga thëngjilli i KEK-ut. Nga thëngjilli i

KEK-ut kemi mundur ta marrim blozën. Dëmi i saj është 1%, e nga cilësia e naftës është 8,5%. Kjo është ajo që po na helmon, sasia e naftës që hyn në Kosovë dhe 2 milionë litra. Nëse dhjetëmijë makina i kemi që hyjnë brenda ditës në Prishtinë, në mëngjes dhe kur të dalin, djegia e tyre liron sasi të karbonit dhe që e ndot cilësinë e ajrit. Kjo do të thotë që ne kemi një ndotje të jashtëzakonshme. Për çdo ditë është, na ka qëlluar mjegulla, na ka qëlluar lagështia, na ka qëlluar koha kur nuk ka lëvizur ajri, ose sikur që thotë 1 metër e kemi pasur lëvizjen e ajrit për sekondë.

Kjo do të thotë, të gjitha këto kanë ndikuar për t'u bërë një gjendje e tillë. Po, ne përditë e kemi këtë gjendje. Përditë, në orën katër edhe në orën tetë e kemi këtë gjendje. Nuk kemi nevojë të ankohe mi, por kemi prokurorët të papërgjegjshëm, kemi gjykatës të papërgjegjshëm. Ti mund t'i formosh, edhe një herë po ta them, edhe njëqind këshilla...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Naiti ka qenë kryetar i komisioni, ka hequr dorë, ka shkuar në tjetër komision. E kam marrë unë tash, duhet edhe ky të më dëgjojë.

Unë pajtohem me shumicën që u thanë, por edhe nuk kemi për çfarë ta zbulojmë ujin e nxehtë. Domethënë, faktorët që e ndotin ajrin në Prishtinë, pothuajse janë të njohur. Ministre, vetëm merre Raportin e Progresit çka sugjeron në vitin 2016, këqyrini masat që janë marrë në vitin 2017 dhe merre shikojeni se çfarë veprimesh duhet ndërmarrë në vitin 2018. Është e shkruar qartë, domethënë kurrjë nuk kërkohet më shumë, përpos zbatimit të ligjeve.

Kjo nënkupton që ka pasur mungesë të kontrolleve në automjete, kontrolle teknike, siç po quhen. Ka pasur mungesë të kontrolleve të cilësisë së naftës, ka pasur probleme me ngrohje, sidomos me peletin, i cili vjen prej Serbisë, e është i përzier me materie plastike, e ne e dimë që në kushtet e dimrit përdoret shumë.

Këtë javë që po e lëmë pas, dhe ju e dini shumë mirë, që nesër po duket, sipas meteorologëve, do të ju ndihmojë edhe Zoti, do të bjerë shi dhe nuk do të keni më problem me ndotje të ajrit, por jua më parë thatë që nuk i dini shkaktarët e ndotjes së ajrit, ndërsa në të njëjtën kohë i keni ndaluar makinat në kryeqytet. Tash, domethënë... pak po bini në kundërshtim me vendimet, e para.

E dyta, ministre, dil merr vendim të ndalen automjetet, të mos lihen ndezur në parking, se jeni duke harxhuar edhe naftë, edhe jeni duke e ndotur ajrin. Pasi po u dashka për qytetarë, merreni vendimin që për zyrtarë të mos lejohet, të paktën të mos mbeten makinat ndezur gjatë gjithë ditës, dje edhe sot.

Tjetrën që duhet tani thënë, po flitet për “Kosova B”. Dihet fare mirë që ajo një problem historik që është duke e përcjellë Kosovën vit pas viti. Kemi dëgjuar që janë ndarë fonde prej Komisionit Evropian. Shumë mirë! Kemi dëgjuar që do të participojnë edhe institucionet vendore me rreth 30 milionë euro. Shumë mirë! Por, a do të zgjidhet problemi tash e një vit?

Mbështetja e komisionit, atë ditë ju kemi thënë hapur, i kemi edhe anëtarët këtu të pranishëm, deputetët nuk janë ekspertë dhe është e pandershme që ne sot, në rast se shkojmë dhe e bëjmë një strategji, dhe i sugjerojmë ministrisë se çfarë duhet të bëjë. Unë mendoj që ju duhet t’i shtrëngoni masat mbi Inspektoratin, sepse ata pothuajse me asnjë vendim të vetëm nuk e kanë ndëshkuar asnjë korporatë ndotëse në Kosovë. E harruat, për shembull, e keni “Ferronikelin” në Drenas, e keni “Trepçën”, është “Kosova B”, se “Kosova A” me sa kam dëgjuar unë është me cilësi të lartë.

Duhet t’i kontrolloni aty ku kontrollohen automjetet teknike, duhet t’i merrni urgjentisht masat për shkak edhe të menaxhimit të ujërave, se s’po i përmend kurrkush. Duhet ta shihni pse digjen deponitë e mbeturinave në mënyrë ilegale gjatë verës dhe ato, natyrisht, kanë plastikë e lloje të ndryshme të mbeturinave që e ndotin ajrin, duhet ta shihni ku e kemi Ligjin për trajtimin e mbeturinave, që akoma nuk është kurrkund në horizont. Duheni parë Ligjin e pyjeve, sepse nuk ka ligj të pyjeve, pyjet priten në mënyrë ilegale katastrofale, ju e dini që çdo pemë ka përmbajtës edhe të ujit. Të gjitha këto janë elemente për të cilat ne duhet t’i ndërmarim masat dhe të mos na përsëritet situatë e ngjashme në vitin e ardhshëm.

Pse e kemi këtë situatë alarmante sot në opinionin publik, nuk je ti fajtores. Përkundrazi, bile ti e ke sensibilizuar opinionin me sa e pamë edhe në komision. Por, ne e kemi këtë situatë alarmante për shkak se kemi instrumente matëse dhe për çdo mëngjes, për shembull, e kemi agjencinë përmbrota atje, çdo mëngjes na i çon informatat se çfarë cilësie të ajrit kemi. Sot, për informacion të qytetarëve, cilësia e ajrit është më e mirë se në Tetovë, më e mirë se në Varshavë, më e mirë se në Shkup, e më e mirë se në shumë qendra të rajonit.

Pra, edhe një herë po ju them, edhe kolegëve të mi, Shkupi nuk ka afër “Kosovë B”, por është më i ndotur se Prishtina. Tetova nuk ka termocentral afër, është më e ndotur se Prishtina sot. Nënkuptohe kur ka propozuar dikush të ndërpritet prodhimi i “Kosova B”, s’kemi më para për të çuar në Serbi, e kemi ndaluar blerjen e rrymës në Serbi. Do të prodhojmë vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e kam një pyetje shtesë për të gjithë ata që dinë, se unë nuk e di, a e dini që në Kosovë janë katër rafineri naftë, të nderuar deputetë? Kush i ka dhënë ato licenca dhe qysh funksionojnë, a punojnë, a prodhojnë, çka bëjnë? Fjalën e ka zoti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme, pra për cilësinë e ajrit, për të cilën çështje natyrisht se po të ishin në funksion instrumentet e shtetit, ashtu siç parashihet me Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, nuk do të kishte fare nevojë gjithë ky diskutim.

Fillimisht, duhet thënë hapur se të gjitha institucionet kanë dështuar, ministrinë përkatëse që merren me mbrojtjen e mjedisit, duke filluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, inspektoratet qendrore dhe lokale në zbatimin e këtij ligji, në të cilin janë të shpjeguar mirë se kush janë ndotësit, në ç'masë dhe cilat janë masat që duhet parandaluar ndotjen e ajrit e, natyrisht, që mund të vijnë nga ndërmarrjet e mëdha publike, institucionet publike, automjetet dhe përdorimi i thëngjillit dhe vajrave të djegura të automjeteve, si lëndë djegëse për ngrohje në ekonomitë e vogla dhe të mesme familjare.

Gjithashtu, problematikë të veçantë paraqet edhe importi i petroll-koksit nga vendet fqinje, çmimi i të cilit është shumë i lirë, 60 euro për ton. Petroll-koksi është një lëndë djegëse në formë të granulave shumë energjetike, që përdoret në industrinë përpunuese dhe prodhuese, por edhe për ngrohje në ndërmarrjet e mëdha, e që ka përmbajtje të lartë të sulfurit. Po ashtu, problem është edhe importi i naftës së dyshimtë nëpërmjet Mitrovicës së Veriut, por edhe në pikat tjera doganore, naftë kjo jo e cilësisë së mirë, por është një naftë as D/2-sh, por e tillë siç e quajnë me fjalën serbokroate, “Ilozh ulje”. Kjo naftë u shitet madje edhe institucioneve, domethënë shkollave të Kosovës.

Duhet rikujtuar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka bërë një strategji për cilësinë e ajrit për vitet 2013-2022 dhe një plan të veprimit për cilësinë e ajrit të inkorporuar në strategji, por që në atë kohë Kuvendi e ka kthyer prapa me rekomandimin për ta ndarë planin e veprimit nga strategjia, pra për t'u bërë dy dokumente, dhe që prej atëherë ministria fare më nuk e ka sjellë në Kuvend këtë plan të veprimit për cilësinë e ajrit.

Shihet qartë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor asnjëherë nuk është marrë seriozisht me këtë problematikë, sepse nuk e ka ndërmarrë asnjë hap për ta parandaluar ndotjen e ajrit. Inspektorati e di mirë se Termocentrali “Kosova B” që nga ndërtimi, domethënë që nga viti 1984, nuk e ka ndërruar filtrin dhe sipas përfaqësuesit të KEK-ut, atë ditë që biseduam në komision, edhe vetë e pranon se mund të klasifikohet si ndotësi kryesor i ajrit në Prishtinë dhe komunat tjera përreth.

Kjo gjendje e ajrit ka qenë vazhdimisht dhe për çdo vit, por për fat të keq këtë vit e kishim një mot me mjegull dhe pa erë, e si pasojë është krijuar “efekti serrë” dhe patjetër që kjo gjendje ndikon direkt në shëndetin e qytetarëve të Kosovës, duke prekur organet respiratore dhe duke shkaktuar implikime kardiale.

Prandaj, të nderuar kolegë, është më se e nevojshme që të bëhet një strategji e veçantë dhe një plan i veprimit urgjent, që kjo gjendje të minimizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse e kemi të qartë se zgjidhje automatike nuk ka. Pra, hartimi i strategjisë duhet bazuar në një studim paraprak shkencor, që merr në konsideratë të gjithë faktorët, si koston e prodhimit të energjisë, mbrojtjen e ambientit, si dhe gjendjen socio-ekonomike të popullsisë sonë.

Pra, në bazë të kësaj analize studimore të definohet qartë që në planin afatmesëm dhe afatgjatë me cilat potenciale energjetike duhet të ngrohet Kosova. A të shfrytëzohet energjia solare, të shfrytëzohet era, uji, apo të vazhdojmë të ngrohemi me thëngjill?

Sa për informim, Kosova ka rreth 2 100 orë me diell, që është një potencial i lartë energjetik për ta shfrytëzuar. Pra, ditët me diell shumë të larta dhe në këtë kuptim, në qoftë se shihet nga ekspertët se është me interes të kalohet në energji solare, në energji me ujë, atëherë njëkohësisht duhet të subvencionohet çdo shtëpi që investon në ngrohje solare, për ta zvogëluar emetimin edhe të gazrave, edhe të thërrimeve në ajër, dhe paralelisht kësaj është shumë me interes që nga Ministria e Bujqësisë thjesht të mendohet që pyjet që janë të shkatërruara të ripyllëzohen, sidomos me drurë halorë, të cilët edhe gjatë dimrit kanë pigment, kanë ngjyrë të gjelbër dhe janë respiratorë apo pastrues të ajrit, duke e thithur CO₂-shin.

Pra, në njërën anë duhet të parashihet në bazë të strategjisë se ku të investojmë dhe në cilat energji alternative të fokusohemi dhe, në anën tjetër, duhet patjetër të bëjmë hapësira të gjelbra dhe të bëjmë pyllëzime, kryesisht afër zonave urbane, sepse aty është ajri më i ndotur dhe në këtë kuptim do të mund që ta mbrojmë në afat të mesëm dhe në afat të gjatë ajrin dhe mjedisin në përgjithësi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'ia jap fjalën deputetit të radhës, unë do t'i kërkoj grupit punues harmonizimin e rekomandimeve që të takohet tani. me qëllim që t'i kemi ato me kohë.

Atëherë, sipas radhës fjalën e ka deputeti Armend Zemaj. Urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministre,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që po e trajtojmë një temë, që siç duket është ngrehur për disa arsye. E para është akumulimi i kësaj problematike, por mbi të gjitha dalja në sipërfaqe, ta quaj kështu shprehimisht, e ndotjes së ajrit në një zonë të caktuar, siç është Prishtina, si kryeqytet i Republikës së Kosovës, edhe nga ndikimet e faktorit të jashtëm, duke e parë rrezikun nga ndotja e ambientit.

Ajo që është evidente është që ndotësit kanë qenë të evidentuar në Republikën e Kosovës. Ajo që ka munguar është zbatueshmëria e ligjit në shumë segmente, e kur mungon kjo, atëherë është tregues i qartë se njerëzit e inkriminuar, ta quaj kështu, në shkatërrimin e natyrës janë mbi ligjet, e ata njerëz shumica janë të veshur nën petkun e politikës, kështu që edhe Ministria e Ambientit, së paku në sensibilizimin e opinionit më tutje nuk ka mundur dhe nuk do të mund të arrijë, sipas bindjeve të mia, edhe sipas të kaluarës, sa i përket kësaj çështjeje. Pse po e përmend?

Me vite të tëra kemi proklamuar, kemi ngritur zërin ndaj Ministrisë së Ambientit për degradimin e pyjeve, ndaj degradimit të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë për gurthyesit ilegalë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, dhe ato shihen. Asnjëri nuk është i fshehur diku në hapësirat e Republikës së Kosovës, po të gjitha janë buzë rrugëve, qofshin ato nacionale a regjionale dhe kjo nuk do koment tjetër.

Pjesa tjetër që lidhet me krimin e organizuar është nafta, është duke hyrë nga fillimi nga dogana, por edhe nga akumulimi dhe përdorimi i brendshëm.

Kështu që janë shumë segmente që ndërlidhen me disa ministri të linjës të zbatimit të ligjit, të organeve të ndjekjes, ku masat janë shumë të vogla dhe tash ndotja e ajrit, potencimi dhe masat të cilat janë ndërmarrë, sidomos lojërat që bëhen me ndalimin e qarkullimit në një hapësirë të caktuar në Prishtinë, është më shumë për t'i hedhur hi syve opinionit publik dhe ikje nga problemi real. Problemi real është moszbatimi i ligjit dhe masat të cilat është dashur të ndërmerren deri më tani dhe degraduesit dhe ata që e kanë dëmtuar mjedisin, e kanë degraduar, e kanë shkatërruar dhe e kanë shkretuar janë vepra penale, e ne nuk kemi dëgjuar që dikush është dënuar sipas Kodit penal dhe Kodit të procedurës penale.

Kështu që e nderuar ministre,

Edhe vitin e kaluar, kur e kam ngritur një çështje që ka pasur të bëjë me degradimin e ambientit në një zonë të caktuar të komunës së Deçanit, keni reaguar sipas mandatit që keni.

Keni dërguar Inspektoratin e mjedisit shumë shpejt me vullnetin tuaj, por ajo ka qenë vetëm një ditë.

Shkatërrimi ka ndodhur menjëherë pas ditëve në vijim. Pse ka ndodhur? Sepse njerëzit që qëndrojnë prapa këtyre janë të lidhur me pushtetarë që ju jeni në Qeveri dhe që ju e udhëhiqni Qeverinë. Njerëzit qëndrojnë prapa gurthyesve, njerëzit që qëndrojnë prapa bizneseve që kanë të bëjnë me hidrocentralet dhe të cilët e kanë shkatërruar florën e faunën, i kanë shkatërruar pyjet, i kanë shkatërruar lumenjtë në Republikën e Kosovës dhe tash çka presin neve, presim ajër të patër, apo presim zhvillim natyror, begati, ku çdo cep i Kosovës rrezikohet, atakohet çdo ditë nga këta njerëz dhe nga këta individë, duke shikuar vetëm interesin personal, grupor, të grupeve të

tyre, të cilët përfitojnë, ndërsa qytetarët ndëshkohen dhe janë të thirrur të jetojnë në një ambient të papastër.

Kjo ndërlihet edhe me shumë gjëra të tjera. Ju kujtohet vetëm deponia e barnave të skaduar afati në Prishtinë, me qindra tonelata të grumbulluara, nga cili faktor? Nga faktori njeri, duke qëndruar në depo, ndërsa sa herë që kemi shkuar, më kujtohet edhe të kaluarën e largët edhe të afërt, në Qendrën Klinike Universitare thoshin se kanë mungesë të barnave.

Janë shumë faktorë, zonja ministre, nuk janë kolegët tua këtu, të sektorëve të ndryshëm, qoftë ministri i Punëve të Brendshme, tash ky që ishte këtu i Tregtisë, po edhe shumë ministra të tjerë, i Drejtësisë e të tjerë, të cilët duhet jo vetëm t'ju dëgjojnë juve dhe jo t'ju përkrahin në mënyrë publike, sepse dëshirojmë ajër të pastër në Prishtinë, por duhet që përtej Task-forcës, me Prokurorinë e Shtetit dhe me gjykatat të ketë një parandalim të degradimit të ambientit në Republikën e Kosovës.

Përndryshe, thirrja e këtyre seancave nuk nënkupton asgjë tjetër, vetëm ikje nga problemet e tjera, nga krimi, nga korrupsioni, nga vendimet e paligjshme të kësaj Qeverie dhe të cilat do të shihen vetëm si lojë mediatike dhe asgjë më tepër dhe asgjë më shumë.

Unë ju garantoj, zonja ministre, që përkrahjen e shumicës së deputetëve do ta keni, por jam skeptik që gjithë ato që ju i potencuat që dy ditë, do të mund t'i realizoni, duke marr parasysh që njerëzit që janë pjesë e Kabinetit tuaj qeveritar dhe që janë të ndërlidhur drejtpërdrejt me këto afëra korruptive, mund t'i zbatoni në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me që është anëtar i grupit punues, unë po ia jap fjalën deputetit Enver Hoti dhe të bëhet gati deputetja Sala Berisha, e cila e kishte radhën, ju lus për mirëkuptim. Urdhëro, Enver!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

E mora fjalën për të sqaruar pak më shumë, sepse ky debat besoj që ka kaluar bukur gjatë dhe është i mirë që është bërë për një arsye.

Është një arsye, sepse po e nxjerr në pah mosfunksionimin edhe mosbashkëpunimin ndërinstytucional.

Ne si Komision për Planifikim Hapësinor kemi pasur një takim me shumë aktorë, me ministrin, me përfaqësuesin e KEK-ut, me drejtorin për Mbrojtje të Ambientit, me Inspektoratin, me doktorin për Mbrojtje të Institut Kombëtar të Shëndetësisë, me përfaqësuesin, me Avokatin e Popullit dhe kemi dëgjuar një qëndrim të tyre, një prezantim të tyre që me të vërtetë ka qenë jashtë çdo niveli që kemi dëgjuar në komisionin parlamentar.

Dhe, duhet të bëjmë thirrje jo vetëm për të mbrojtur dhe për të marrë masa, por ajo çka është më e keqja është se nuk kemi bashkëpunim ndërinstytucional as në mes të ministrive, ku është vetëm ministrja këtu, të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Bujqësisë, Tregtisë dhe Industrisë e të Ministrisë së Rendit, është parë hapur kjo.

Inspektoratet, të cilat janë nëpër ministri, thuaja se janë inekzistente, ato mund të konstatojnë gjëra, mund të konstatojnë defekte, kanë konstatuar shumë çështje dhe i kanë ngritur, por e vërteta qëndron se asnjë masë, që ata e kanë rekomanduar dhe paralajmëruar nuk është zhvilluar më tutje as nga sistemi i drejtësisë, gjyqësori e prokuroria dhe as nga Policia.

Kështu që degradimi i ambientit që ka ardhur deri në këtë nivel që është sot, nuk është pasojë vetëm e këtyre dy muajve të fundit.

Mendoj se kjo duhet të ngrihet si çështje dhe duhet të realizohet një aktivitet shumë i madh ndërmjet institucioneve.

Ne dëgjuam se ka mungesë të inspektorëve, ka kushte të cilët ata nuk mund të punojnë, çka domethënë kjo? Ndërsa me dhjetëra njerëz në administratë të Qeverisë sorollaten zyra dhe as nuk mund të sistemohen dhe nuk kryejnë ndoshta asnjë detyrë gjatë gjithë vitit, se lere më gjatë muajit apo ndonjë jave. Kjo është e vërteta.

Ne këtë çështje e kemi ngritur edhe për qeveritë e kaluara, kjo është një gjendje e trashëguar.

E dimë që e posedojmë një administratë jofunksionale, jo tani, po që sa vjet. Kjo duhet të ngrihet dhe duhet të bëhet një rikonfigurim i funksionimit të qeverisë nëpër të gjitha dikasteret, në të gjitha nivelet, mandej nuk ka një bashkëpunim mes ndotësve më të mëdhenj, të cilët janë potencial ndotës të mjedisit, ata nuk penalizohen, nuk zbatohet ligji. Këto janë çështje që ne duhet t'i ngremë dhe t'i themi.

Mendoj se është momenti i fundit që drejtuesit e Qeverisë, jo vetëm të kësaj Qeverie, po ata më herët që është dashur të bëjnë e nuk e kanë bërë, ne u bëjmë thirrje këtyre ministrave, këtij Kabineti qeveritar që të largohen nga një zhargon në neveritës që është duke i përcjellë të gjitha qeveritë deri tani: “duhet ta bëjmë”, kemi nisur ta bëjmë”. Jo, ne duhet të flasim për atë çka kemi bërë, kjo është më tani diçka që na neveritë edhe neve si deputetë, por edhe qytetarët e vendit.

Nuk mund të jepen shpjegime edhe përgjigje para deputetëve dhe para opinionit të gjerë pse është atakuar kjo gjendje e ambientit.

Ne kemi marrë masa dhe do të bëjmë vlerësime dhe studime, pse s'e kemi bërë deri më tani? Ku janë arsyet?

Ne dëgjuam nga drejtori i KEK-ut që janë dhënë mbi 50 milionë për mbrojtjen e ambientit. Janë mbjellë mbi 260 mijë fidanë.

Ndërsa, në anën tjetër, nga drejtori i Mbrojtjes së Ambientit marrim informacion se mbi 30% ndotësi i ambientit është KEK-u.

E nderuar ministre,

Ju dëgjova me vëmendje se keni ngritur një Task-forcë. Sinqerisht dua ta them se kjo më kujton ngritje të Task-forcave nga ish-presidentja, që e ka pas bërë namin me to për çështje të ndryshme, për funksionim të sistemit të drejtësisë, për funksionim të sistemit të sigurisë dhe krejt ai farë grumbulli i atyre Task-forcave merrnin paga, mëditje të mira dhe në fund janë shuar. Asnjë funksion, asnjë punë nuk e kanë kryer deri tani.

Nuk mendoj që ka nevojë të bëhen paralelizma, të ngrihen ekipe Task-forca, sepse institucionet janë, edhe Inspektoratet, edhe ekspertët, edhe ministria juaj, edhe ministri të tjera, po duhet të marrim masa konkrete për t'i zbatuar ato plane të veprimit që ju i deklaruat në Komision, për t'i zbatuar ato studimi që ekzistojnë dhe për t'i realizuar, për të fuqizuar e për t'i jetësuar në praktikë.

Mendoj që të gjitha këto veprime të tjera, qoftë në aspekt deklarativ, qoftë si dokumente, qoftë si trupa që po i krijoni, për mendimin tim janë krejtësisht një tentativë për të dalë nga kjo situatë dhe për t'u fshehur para opinionit për punën që duhet ta kryeni.

Edhe një herë dua ta përsëris, është momenti i fundit që të gjithë zyrtarët shtetërorë, kudo që janë, t'i kryejnë detyrat në bazë të përgjegjësive dhe ligjeve që janë.

Kërkojmë vetëm zbatimin e ligjeve, sepse asnjë pengesë tjetër nuk ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala, ndërkaq të bëhet gati deputetja Arbërie Nagavci.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Shala!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Media,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme, debat në lidhje me ndotjen alarmante të ajrit.

Në rend të parë dëshiroj ta falënderoj zotin Kadri Veseli për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme, me një temë që na bënë të gjithëve bashkë, që na fton për një mobilizim

maksimal, individual edhe institucional. Debat, i cili konsideroj që nuk duhet drejtuar gishtin fajtor askund.

Tani më dihet fakti se ditëve të fundit Prishtina është kapluar me një ndotje të lartë të ajrit, e cila e bën cilësinë e ajrit shumë të pashëndetshme, nuk është diçka e re. Mirëpo, aktualisht informimi është në nivel më të lartë krahasuar me vitet e kaluara falë investimeve të bëra nga Qeveria dhe donatorët për monitorimin e cilësisë së ajrit, gjë që ka arritur të sensibilizojë edhe qytetarët dhe institucionet e vendit.

Ndotje të tilla ka pasur edhe në të kaluarën, mirëpo ne nuk duhet që pafundësisht të heshtim për një situatë të tillë. Andaj, propozoj që të merren masa që do të kenë efekt të qëndrueshëm.

Masa të tilla, si kjo tani, ad hoc, janë masa që në një moment të caktuar ndoshta kanë një efekt shumë të vogël në uljen e ndotjes, të mos themi të papërfillshëm, kur kemi parasysh që ajri nuk njeh kufij.

Andaj duke ditur tani më se burimet ndotëse në vend janë termocentralet, transporti, ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla, ne duhet të fokusohemi në uljen e emisioneve ndotëse nga këto burime, pasi që Prishtina është e ndikuar nga burimet e lartpërmendura dhe të mos vijmë në situatë që të lutemi në përmirësimin e kushteve meteorologjike.

Para se të kërkojmë cilësinë e ajrit brenda standardeve të BE-së, e që ne i kemi adaptuar edhe për vendin tonë përmes ligjeve dhe strategjive, sigurisht që shtrohen pyetjet:

Termocentralet tona si funksionojnë?

Po mjetet që frekuentojnë në rrugët tona, po edhe në rrugët e Prishtinës, meqenëse po flasim për ndotjen në Prishtinë, a i mbushin kriteret dhe standardet e BE-së, si ato teknike, po sidomos në cilësinë e derivateve të cilën e përdorin? Mendoj se jo, nuk i përmbushin.

Ne të gjithë si deputetë e kemi marrë një letër, një shkrim nga një laborator i cilësisë së kontrollit të naftës dhe kemi marrë informacione sa i përket këtij problemi.

Mandej, kaldajat që përdoren në ekonomitë familjare dhe në biznese të vogla, çfarë përdorin për djegie dhe sa janë shtëpitë konform standardeve të BE-së? Cili është rezultati, për afërsisht mund ta dimë, edhe pse ministrja tha që nuk kemi bërë ndonjë studim shkencor dhe hulumtim tjetër.

Nëse i mbledhim përgjigjet nga të gjitha këto pyetje, rezulton se edhe cilësia e ajrit pa tjetër që do të jetë jashtë normave të BE-së, domethënë tejkalim të limiteve të lejuara.

Andaj, bëj thirrje që, nën një, planet urbane gjatë hartimit të tyre duhet të respektojnë zonat e gjelbëruara, të kihet parasysh dhe të përfilllet strikt, të lëshohet leja ndërtimore duke respektuar zonat e gjelbëruara. Në këtë pikë ne e dimë shumë mirë edhe jemi dëshmitarë të asaj se ka qenë në një kundërshtim të vendimeve të tilla Komuna e Prishtinës me Ministrinë e Ambientit. E kemi rastin e ndërtimit në zonën e gjelbëruar, në rrugën B, ku tani janë ndërtuar ndërtesa me kate të larta në kundërshtim me kriteret ambientale dhe ligjore, po edhe me kriteret ndërtimore.

Më tutje, të gjitha institucionet që bartin me vete pjesën e përgjegjësisë për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të respektojnë legjislacionin primar dhe sekondar në favor të mbrojtjes së cilësisë së ajrit, duke i përmbushur obligimet ligjore. Dihet cilat janë ato institucione që të mos marr kohë t'i përmend.

Ne si shtet e kemi edhe strategjinë për cilësinë e ajrit, e cila është e aprovuar. Aty janë një varg masash, të cilat duhet të implementohen dhe jam e sigurt se do të ulëj edhe niveli i ndotjes së ajrit, andaj të mendojmë edhe në gjetjen e formës së implementimit të dokumenteve strategjike dhe ligjore, pasi që ato ekzistojnë dhe janë të transpozuar nga direktivat e BE-së.

Pasi që bëhet fjalë për ndotjen në një zonë urbane, e dihet që burimet kryesore të ndotjes së ajrit në zonat urbane janë kryesisht emisionet ndotëse të shkaktuara nga trafiku, nga ekonomitë familjare, nga bizneset e vogla, e tjera. Mendoj se do të ishte me rëndësi që të bëhet prioritet si nga niveli lokal dhe ai qendror projekti i zgjerimit të rrjetit të ngrohjes, kogjenerimi, në mënyrë që të eliminohen emisionet nga ekonomitë familjare, pra ngrohja e shtëpive dhe objekteve institucionale.

Të investohet në efikasitet të energjisë, në mënyrë që të zvogëlojmë shpenzimin e panevojshëm të energjisë, e që në mënyrë indirekte zvogëlon emisionet nga prodhimi i energjisë.

Të krijohen korsi, ku do të qarkullojnë automjetet e transportit urban, ndihma e parë dhe taksitë, në mënyrë që të mund t'u ofrohet qytetarëve shërbim kualitativ që të tërhiqet qytetari për të përdorur më shumë trafikun urban.

Të ndërtohen parkingje në periferi të qytetit, po e them me theks të veçantë, në periferi të qytetit, sepse e dimë se ka qenë një tentativë që ndërtohet parking brenda qytetit, në qendër të Prishtinës. Në këtë mënyrë, duke u ndërtuar parkingje në periferi të qytetit, ju ofrohet transporti urban qytetarëve që të hyjnë në qytet pa veturat e tyre si dhe të njëjtën kohë të rritet çmimi i pagesës së parkingjeve që ekzistojnë në brendi të qytetit.

Të krijohen lehtësime tek investitorët që do të investojnë në pajisje për prodhim të energjisë së renovueshme, siç është energjia e erës, energjia solare dhe energjitë e tjera, edhe pse këto kapacitete në vendin tonë janë të limituara, por është mirë të krijohen këto mundësi.

Unë po e shfrytëzoj rastin të përmend në këtë rast, se tani kem mungesë, zbrazëti, vakum institucional në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, sepse nuk ka Bord, presin mjaft kërkesa të licencohen për energji të ripërtëritshme dhe Kuvendi nuk po kryen obligimin e vet ta plotësojë Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, duke nxjerrë arsye krejtësisht banale karshi rëndësisë së plotësimit të atij bordi.

Të krijohen burime alternative të furnizimit me energji elektrike që në raste të caktuara, kur për kohë të gjatë ballafaqohemi me kushte meteorologjike të pafavorshme, për shpërndarjen e ndotësve në ajër, të përdoren burime alternative. Ndoshta do të ishte mirë që në këtë kohë të pikut të ndërpritet edhe prodhimi i energjisë elektrike termo tek ne, dhe të furnizohemi nga importi i energjisë elektrike, apo të bëjmë diçka në drejtim tjetër, sepse ne kemi një projekt, i cili pret të zbatohet, siç është interkoneksioni Shqipëri-Kosovë dhe dihet që moszbatimi i këtij projekti të rëndësishëm, i financuar edhe nga Qeveria gjermane, për shkaqe politike nuk është në funksion.

Po i përmend si masë gjetjen e alternativës për furnizim me energji elektrike pasi që në afërsi të Prishtinës ndodhen termocentralet dhe qyteti i Prishtinës natyrisht që ndikohet nga ndotja që lirohet gjatë proceseve teknologjike të termocentraleve dhe mihjeve sipërfaqësore të thëngjillit.

Kështu që në këtë sektor duhet të investohet në teknologji të re, tani jemi në pritje të termocentralit “Kosova e Re” dhe po besoj dhe po shpresoj shumë se do ta zbutë këtë problem për të cilën jemi duke folur.

Sigurisht që teknologjia e re do të përmbushë standardet e BE-së dhe në aspektin mjedisor, me theks të veçantë në mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

Këtu, më lejoni të cek edhe një element tjetër që do të ndikonte në rritjen e ndotjes së ajrit në Prishtinë, duhet pasur parasysh edhe pozitën gjeografike të Prishtinës. Prishtina është një fushëgropë, e cila është e papërshtatshme në kushte atmosferike, sidomos gjatë sezonit të dimrit që karshi të gjithë këtyre ndotësve të përballojë një gjë të tillë dhe të mos ballafaqohemi me ndotje të tillë.

Mirëpo në qoftë se ne themi për Prishtinën, nuk do t'i radhis ndikuesit ndotës më të mëdhenj të ajrit në Prishtinë, sepse pas Prishtinës qytetin më të ndotur e kemi edhe Gjilanin dhe në qoftë se këtu është element kryesor termocentrali, atëherë në Gjilan cili element do të ishte më kryesor?

Të ndotura janë sidomos qytetet industriale, Mitrovica dhe Drenasi, në të cilën ka pasur protesta të qytetarëve për shkak të ndotjes së ajrit që vinte nga “Ferronikeli”.

Krejt në fund, të nderuar kolegë deputetë, ne nuk e rregullojmë cilësinë e ajrit duke drejtuar gishtin për fajtorët, ne duhet të kërkojmë përgjegjësi institucionale, individuale dhe të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë unë dëshiroj të njoftoj që janë edhe tetë kolegë të paraqitur për të diskutuar.

Nëse ju pajtoheni, do të mbyllim këto diskutime, domethënë do të vazhdonim dhe do të lenim si orë që të votojmë rekomandimet, për orën 14:00, nëse shefat e grupeve parlamentare marrin përsipër që të sjellin deputetët në sallë dhe ne të mos marrim pauzë fare, po të mbyllim punën deri në orën 14:00.

Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci, le të bëhet gati deputeti Driton Selmanaj.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Ministra,

Përkundër faktit që tashmë situata është shqetësuese dhe qytetarët me të drejtë janë të brengosur për shëndetin e tyre, kjo gjendje nuk është as e re, e as e papritur.

Sipas informatave dhe raporteve, kjo gjendje përsëritet çdo vit në këtë periudhë.

Do veçoja këtu Raportin e Progresit dhe së fundmi raportin e Avokatit të Popullit, i cili edhe sivjet, sikurse viteve të kaluara, ka paraqitur detajisht gjendjen në këtë fushë, duke dhënë edhe rekomandimet për veprim.

Përkundër kësaj organet kompetente nuk kanë ndërmarrë veprime që janë të parapara me ligj, gjegjësisht nuk kanë ndërmarrë veprime për masat parandaluese, për të cilat janë kompetente, para sezonit të dimrit gjatë vitit 2017, para se të hynim në fazën e pragut të alarmit.

Duke qenë se çështja e ndotjes së ajrit, përkundër faktit se është jetike dhe me rëndësi të jashtëzakonshme për secilin prej nesh, është çështje thellësisht shkencore, unë do të fokusohem kryesisht te roli ynë ligjvënës dhe te aspekti ligjor, gjegjësisht obligimet të cilat dalin nga ligji dhe, për më tepër, te mosrespektimi i tij nga organet kompetente.

Dua të përmend fillimisht Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i cili parasheh në nenin 24 masat për tejkalimin e pragut të alarmit dhe cilësinë e dobët nga ajri. Theksoj se kur pragu i

alarmit tejkalohe dhe përcaktohet cilësi e dobët e ajrit, ministria përcakton masat paralajmëruese dhe informon Qeverinë, autoritetet relevante lokale dhe publikun.

Për parashikimin dhe paralajmërimin e gjendjes së smogut ose situatave me cilësi të dobët të ajrit, Qeveria me propozim të ministrisë, me akt të veçantë përcakton masat për rregullimin e sistemit special paralajmërues.

Në raste emergjente, për të normalizuar gjendjen masat e ndërmarra duhet të koordinohen nga ministria, Qeveria dhe autoritetet lokale, gjegjësisht komuna.

Ministria përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e shkarkimit në ajër nga burimet e ndotjes. Po ashtu autoritetet lokale, në bashkëpunim me ministrinë, duhet të ndërmarrin masa emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit. Operatorët duhet të ndërmarrin masat emergjente, për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit dhe duhet të informojnë në mënyrë periodike ministrinë, publikun dhe autoritetet lokale për masat preventive të aplikuara për zvogëlimin e ndotjes.

Konkretisht, kjo dispozitë e ligjit parasheh nëntë pika specifike, të cilat e adresojnë këtë çështje.

Po ashtu sikurse tashmë është e qartë, institucionet tona kanë dështuar në këtë drejtim, respektivisht në zbatimin e të gjitha pikave më sipër.

Tutje, sipas nenit 33, të të njëjtit ligj, parashihet dhe monitorimi i cilësisë së ajrit nga ministria, e cila do të duhej të siguronte monitorimin e përhershëm të cilësisë së ajrit dhe ndikimin në mjedis dhe shëndetin e popullatës dhe parashihet që raportet e monitorimit të bëhen publike.

Ministria me akt të veçantë, sipas këtij ligji, do të duhej të përcaktonte kriteret për caktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve, të cilët monitorohen, metodologjinë e punës si dhe formën dhe kohën e raportimit të të dhënave.

Po ashtu subjektet, të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit, janë të detyruara sipas ligjit që të organizojnë sistemin e monitorimit intern, me qëllim të përcjelljes së shkallës së ndotjes dhe natyrisht parandalimit të saj.

Asnjë nga obligimet e mësipërme nuk janë përmbushur dhe askund nuk mund të gjejmë raporte të monitorimit, gjithnjë nëse supozohet se ekzistojnë të tilla.

Një ligj tjetër që rregullon këtë fushë është Ligji për mbrojtjen e mjedisit, i cili parasheh edhe planin e sanimit, të cilin me propozim të ministrisë e nxjerr Qeveria, e që do të duhej të ndërmerreshin masa të shpejta dhe intervenime urgjente, e jo task-forca për evidentim të situatës,

e cila tashmë është e qartë apo veprime sekondare, që nuk pritet të japin rezultate të shpejta. Aq më tepër, kur sa u kuptua në këtë task-forcë nuk janë përfshirë ekspertë të fushës, qoftë nga fusha e shëndetësisë apo kompetentë të fushës adekuate, por janë kryesisht të nivelit politik.

Dua të ndaj këtu me ju dhe një të dhënë, e cila po përmendet shumë shpesh si faktor në ndotje të ajrit, gjegjësisht bëhet fjalë për përdorimin e thëngjillit si mjet për ngrohje në shkolla dhe çerdhe.

Për informatën tuaj, asnjë institucion edukativo-arsimor publikë në komunën e Prishtinës nuk e përdor thëngjillin si mjet për ngrohje. Me saktësi ju njoftoi se nga 88 objekte arsimore publike në komunën e Prishtinës, 34 e përdorin naftën për ngrohje, 17 prej tyre e përdorin peletin, 20 përdorin drutë si mjet për ngrohje, dy rrymën dhe 15 janë të kyçura në sistemin e ngrohjes nga “Termokosi”.

Përkundër kësaj, edhe unë mendoj dhe pajtohem se duhet shqyrtuar me urgjencë mundësinë e marrjes së masave, qoftë edhe direkt, të ndërprerje të mësimin në ditët me ndotje më të madhe në komunën e Prishtinës dhe komunat e tjera, ku gjendja është më e vështirë, pasi që këto ditë të humbura do të mund të zëvendësoheshin në muajt vijues në kushte më të mira atmosferike.

Është edhe një element tjetër i rëndësishëm që duhet theksuar, sipas legjislacionit në fuqi, për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, sikurse situata në të cilën ndodhemi, Qeveria jo vetëm nxjerr plane të intervenimit, por ka obligim ligjor që të informojë Kuvendin, gjë që po ashtu nuk e ka bërë.

Pra, kjo duhej të ishte një seancë ku do duhej të raportonte Qeveria, ku vetë kryeministri, bashkë me anëtarët e tjerë të kabinetit duhej të ishin të pranishëm, e jo një mbledhje e ftuar nga kryeparlamentari, i cili edhe vetë në pjesën më të madhe të kohës nuk ishte i pranishëm.

Për më tepër, jo vetëm që nuk ka veprime në këtë drejtim, por kemi dhe deklarata publike të ministres së Mjedisit, se nuk kemi njohuri se nga vjen ndotja, pra njohuri të sakta, për çfarë në të vërtetë e përgëzoj për sinqeritetin, por ishte shqetësuese edhe një deklaratë tjetër, se ekspertë të kësaj fushe e kanë rekomanduar që të mos merret me këtë çështje, pasi kjo është vetëvrasje politike, domethënë këtë e ka thënë publikisht në një emision televiziv.

Edhe pse jam e vetëdijshme se ministria e ka trashëguar një gjendje të rëndë në këtë fushë, e ka obligim të na tregojë se kush janë ata ekspertë, të cilët nuk brengosen për shëndetin e qytetarëve, por për karrierën politike të individëve të caktuar.

Akoma dhe sot qytetarëve dhe të tjerëve nuk u është ofruar informim kualitativ dhe me kohë që do të ndikonte në vetëdijesimin e tyre për marrjen e masave preventive. Ajo që ndikoi për

problematizim dhe diskutim në këtë fushë, në fakt ishin vetëm të dhënat e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara Amerikës, edhe pse sipas nenit 54 të të njëjtit ligj, ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuar dhe të tjera janë të obliguara që rregullisht dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, respektivisht për dukuritë, të cilat janë duke u përcjellë në kuadër të monitorimit të emisionit dhe cilësisë të mjedisit, si dhe për masat paralojmëuese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, e themeluar nga ministria, me qëllim të monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit dhe njoftimit në lidhje me të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm po ashtu nuk ka kryer punën e vet për informim të qytetarëve në lidhje me gjendjen e ajrit dhe ndotjen. Edhe vetë kryeshefi i agjencisë flet me informata të Ambasadës amerikane dhe jo me gjetjet dhe rezultate të punës së tyre.

Akoma sot nuk dihet cili është numri i të sëmurëve, përgjigjja e së cilës do të ishte treguesi më i mirë i ndikimit të gjendjes së ajrit në shëndetin e popullsisë. Këtë nuk mund ta dimë, për arsye të mosfunksionimit të sistemit informues shëndetësor, edhe pse sipas Ligjit për shëndetësinë, institucionet shëndetësore dhe personat përgjegjës juridikë dhe fizikë janë të detyruar të mbledhin të dhëna shëndetësore dhe t'i raportojnë ato në mënyrë periodike në Institutin e Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Andaj, edhe pse kjo situatë po përsëritet çdo vit, institucionet tona kanë dështuar në vetëdijesimin e qytetarëve dhe nuk janë ndërmarrë fushata sensibilizuese për qytetarët, duke i targetuar grupet e ndryshme dhe duke promovuar edukim shëndetësor. Për më shumë, ne sot po flasim për gjendjen e ajrit në komunën e Prishtinës, përderisa nuk kemi asnjë të dhënë për komunat e tjera, përfshirë këtu edhe komunën e Gjakovës, edhe pse mund të konkludojmë që situata është e ngjashme. Madje, në komunën e Gjakovës po mungon edhe mbështetja për ngrohoren e qytetit, duke i obliguar qytetarët në shumicën e rasteve të përdorin mjete të tjera për ngrohje, konkretisht thëngjillin, i cili është më ekonomik, por që ndikon në ndotje.

Sot duhet të kuptojmë përfundimisht që çmimi i ndërmarrjes së masave preventive, investimi në filtra e në energji alternative, masat për eficiencyn e energjisë dhe të tjera është shumë jorelevant me çmimin që do të shkojë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Kërkesa ime e fundit për sot është për prokurorin e shtetit, kryeprokurorin, i cili akoma nuk ka filluar hetimet ndaj përgjegjësve të personave që janë kompetentë sipas ligjeve të përmendura, andaj ftoj për një hetim për mosveprim sipas detyrës zyrtare të personave përgjegjës për mosrespektim të ligjit dhe rrjedhimisht për moskujdes ndaj shëndetit të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministrja e ka kërkuar fjalën, urdhëro!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: E nderuar deputete,

Edhe një herë dua ta ritheksoj që qysh në javën e parë të mandatit tim kam përcaktuar prioritetet përmirësimin e cilësisë së ajrit. Kemi bërë planin e aktiviteteve për reduktimin e ndotjes së ajrit duke marrë mendime, rekomandime edhe të ekspertëve të mjedisit.

Gjatë kësaj periudhe kam pasur kritika pse po merrem me përmirësimin e cilësisë së ajrit, me pretendimin që të merresh me ajrin është vetëvrasje politike. Po, është shumë e vërtetë. Kjo ka nënkuptuar që deri më tani askush nuk ka pasur guxim të merret me këtë çështje dhe se përpjekjet për të reduktuar ndotjen e ajrit janë të predispozuar të dështojnë në vendin tonë. Unë nuk mendoj kështu, në fakt, e mendoj që kundërtën. Ata që s'kanë pasur dhe nuk kanë guxim dhe vullnet për t'u marrë me ajrin dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, ata janë të dështuar dhe nuk ia duan të mirë Kosovës. Ne nuk duhet dhe as nuk guxojmë t'u ikim përgjegjësive, duke u ikur kështu problemeve dhe në të kaluarën, ato sot janë shtresuar dhe zmadhuar dhe tani kemi një gjendje shumë të vështirë dhe normalisht edhe shumë probleme për të zgjidhur.

Pavarësisht të gjithave, unë jam në shërbim të qytetarëve të vendit dhe bashkërisht me të gjithë ju, do t'ia dalim që të përmirësojmë cilësinë e ajrit në vend. Edhe një herë po e theksoj, jo vetëm problematikës së ajrit, po çdo problematike në Kosovë ne institucionet jemi të obliguar me ligj t'u qasemi në mënyrë profesionale, të bëjmë hulumtime të mirëfillta, të kemi mundësi, t'u japim ekspertëve tanë mundësi të kenë qasje në projekte madhore, të na japin rezultate të sakta dhe ne si institucione, si pjesë e politikëbërjes të jemi të saktë në atë se si do të vazhdojë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Ministre, faleminderit për sqarim. Unë ju përgëzoj për angazhim tuaj dhe për përgjegjësinë që keni marrë, ndonëse kjo nuk ju takon për gjendjen aktuale, por edhe një herë e përsëris pyetjen, pa e mohuar se dikush ju ka dhënë deklaratatë tilla, unë mendoj që keni obligim ndaj qytetarëve t'ua bëni me dije se kush janë ata ekspertë, të cilët ju kanë udhëzuar që të mos flisni dhe të mos merreni për këtë temë, sepse bëhet fjalë për jetën e qytetarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministria prapë e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Mendoj që nuk ka rëndësi se kush e mendon këtë, ne duhet të merremi me problemin dhe me mendësinë e krijuar, jo me individin që ka thënë kështu.

Ne duhet të marrim guximin të futemi në substancë, në përmbajtje të problemeve, e jo të sillemi me vite vërdallë, sepse pasojat me të vërtetë janë shumë të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Më në fund, Driton Selmanaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Bekim Haxhiu. Urdhëro, Driton!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuar... si duket probleme teknike sa herë të më vijë rendi mua.

Në fakt, po të dëgjohen me kujdes të gjithë deputetët prej dje dhe deri sot, më tepër po më asocion sikur të ishim këtu në një simpozium shkencor, se sa si një institucion përfaqësues politik.

Unë fillova prej dje të ndjehem inferior, se nuk e paskam ditur se kaq shumë ekspertë të ambientit ka në këtë Kuvend. Dhe, besomëni, jam i sigurt që do të na e kenë zili edhe forumet ndërkombëtare të nivelit global kur diskutojnë për ngrohjen globale ose ndotjen e ambientit. Të paktën, unë mendoj që krejt diskutimet do të duhej të ishin krejtësisht ndryshe, unë po provoj të jap kontributin tim në kontekst krejtësisht ndryshe. Po e marr shembull kështu, para tri ditësh niveli i shifrave të ndotjes së ajrit ishte mbi 300, dje ra në 170, sot ka rënë në 76, çka po ndodh, në fakt?! Njerëzit që merren vesh në këtë fushë, po më thonë mua kështu: duhet të bjerë borë, shi, në mënyrë që së paku të fillojë pastrimi i ajrit. Te ne as borë, as shi, me frymë krejtësisht minimale po ndodh që ajri po pastrohet, madje nëse vazhdohet me këtë ritëm, ne do t'ia kalojmë edhe Oslos, edhe shumë vendeve të tjera, ku niveli është 4 ose 5.

Dhe, çka më bën të dyshoj këtu? Mos është involvuar faktori njeri në këtë farë tematike? Mos dikush atje në termocentralet tona po i ndal qëllimshëm filtrat që të mos funksionojnë? Kam përshtypjen që këtu ka vend edhe për hetuesinë që të shikojë, sepse mora disa informata që për të operuar ato filtra kërkohet një sasi e madhe e energjisë, harxhojnë, konsumojnë shumë energji ato dhe dikush qëllimshëm edhe i ndal. Sikur dje dhe sot i lëshuan ato dhe tash ajri filloi të trajtohet, ose them kemi një ajër që duhet të na marrin lakmi të tjerët dhe pothuajse kjo tematikë tashmë e humbi edhe relevancën pse duhet të diskutohet.

Çështja tjetër, lidhur vetëm me një masë e cila është ndërmarrë, lidhet me lëvizjen ose qarkullimin e automjeteve. Unë kam përshtypjen që po i bartim dy mesazhe negative me këtë masë. Cila është? E para, është që ne po i ndalim makinat të qarkullojnë vetëm në disa rrugë kryesore të vendit, të Prishtinës dhe zakonisht ku gravitojmë ne si deputetë dhe si pushtetarë eventualisht dhe ku ndodhet Kuvendi, ku ndodhet Qeveria. Çka po u themi njerëzve? Ato vende ku ne jemi, po kujdesemi që ajri të jetë më i mirë, ndërkohë që ju përreth, na falni po ky është mesazhi. Ose mesazhi tjetër, po u themi njerëzve mos i merrni makinat, dilni ecni në këmbë, ose shfrytëzoheni transportin publik që i bie kur të ecni në këmbë, ekspozojuni rrezikut më shumë, rrezikoni më shumë. Domethënë një masë goxha paradoksale.

Dhe, tash unë nuk e kam problem vetëm me kontaminimin e ajrit, mirë që ne po e diskutojmë këtë, unë kam përshtypjen që ne jemi të kontaminuar në çdo aspekt, edhe me ushqimin. Ne nuk e dimë çfarë hamë, çka është më e rëndësishme nuk e dimë edhe çfarë barnash konsumojmë. Unë para disa ditësh mora vesh kështu, në Kosovë importohet insulina e prodhuar në Poloni, e që në fakt, kjo kompani që po prodhonte insulinë të vetmin eksport jashtë Polonisë e kishte Kosovën. Ne Kosova kemi vendosur që të marrim insulinë prej Polonisë, domethënë që të vetmin eksport e ka te ne, që i bie ne jemi të kontaminuar jo vetëm me ajrin, por në çdo aspekt, në të cilën po jetojmë. Normalisht që këto masa, të cilat janë ndërmarrë janë krejtësisht simbolike dhe uroj që disa prej tyre të marrin fund shpejt, por këto raste të na shërbejnë neve që të jetë alarm që të gjitha institucionet të kryejnë mandatin e tyre sipas ligjit dhe Kushtetutës që e kanë. Unë e di që një numër i madh i agjencive, të cilat janë të thirrura të merren me këtë tematikë, pothuajse gjysmën e kohës gjatë një viti e kalojnë në turizëm studimor nëpër shumë punëtori që ndodhin jashtë Kosovës dhe kjo duhet të marrë fund tashmë.

Unë mendoj që ata kanë mbërritur aq shumë nga këto punëtori që deri sot kanë qenë pjesë e tyre sa që t'i kthehen dhe ato t'i implementojnë në praktikë dhe ne të mos e kemi këtë telashe çfarë e kemi. Kur e dëgjoja më herët ministrin e Zhvillimit Ekonomik, i cili thotë që KEK-u me prodhimin ose me punën e vet vetëm deri në 10% ndikon në ndotjen e ambientit, unë kam përshtypjen që ky vend vuan për dije, për ekspertizë, që vërtet t'i identifikojmë burimet, në fakt cilat janë ato. Nuk është marre të thuhet që nuk di ta bëj këtë punë, s'kemi njerëz. Hajde t'i kontraktujmë edhe disa ekspertë ndërkombëtarë që vijnë, së paku na identifikojnë burimet e ndotjes dhe më pas provojmë t'i japim zgjidhje secilës situatë që na paraqitet para neve.

Po them, ndjehem mirë që për pak kohë i kemi larguar tematikat e tjera, si Specialja ose demarkacioni, ose tematikat që e kemi lodhur këtë popull, e po merremi me tematika reale, uroj që njerëzit të merren vërtet me punën që u takojnë, jo vetëm ju si ministre, por të gjitha institucionet e tjera, në mënyrë që të mos jetë më objekt trajtimi kjo tematikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës ia jap fjalën deputetit Bekim Haxhiu, ndërkaq le të përgatitet deputeti Labinot Tahiri.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Brenda këtyre ditëve është thënë mjaft, prandaj do të përpiqem që të mos përsëritëm në ato të cilët kolegët paraprakë i kanë diskutuar. Edhe pse pak vështirë që të mos përsëriten disa gjëra, por dua të rikujtoj një moment këtu në seancë të Parlamentit kur ishim në takim me fëmijët e shkollave fillore për 1 Qershorin, vite më parë dhe kur fëmijët ishin të ulur në pjesën e deputetëve dhe ne disa nga deputetët u përgjigjeshim pyetjeve të tyre. Njëri nga këta fëmijë pyeti: pse Prishtina nuk ka shtigje për biçikleta?

Pse në Prishtinë të gjithë shkojnë me makina në punë? Një dukuri, e cila drejtpërdrejt do të ndikonte në zvogëlimin e qarkullimit dhe në ndotjen e ajrit. Masa e ndërmarrë këto dy ditë nga komuna është tërësisht e paqëlluar, sepse nëse është provuar të reduktohet qarkullimi në qendrën e qytetit, ka bërë që ky qarkullim të jetë më i madh në lagjet periferike ose në lagjet e tjera joperiferike, siç është Dardania, Ulpiana, Kodra e Diellit dhe pjesë të tjera të qytetit. Pra, edhe pse është menduar që me këtë zvogëlohet qarkullimi i automjeteve, një gjë e tillë nuk është arritur, sepse kjo në asnjë botë, në asnjë të dhënë shkencore nuk është vërtetuar se ajri ndalet në semaforë, ashtu siç ka provuar aktualisht Komuna e Prishtinës që ta zvogëlojë qarkullimin e ajrit dhe ta ndalë në semaforë ose me një qarkullim tërësisht të gabueshëm.

Mendoj që kur kemi diskutuar këtu në Parlament, e ka pasur edhe debate rreth numrit të të sëmurëve dhe vizitave mjekësore në komunën e Prishtinës, ka qenë një prej parametrave që është dashur të merret në konsideratë dhe në shqyrtim, sepse është thënë që brenda një viti në komunën e Prishtinës ka pasur mbi 2 mijë vizita mjekësore dhe unë e besoj plotësisht që edhe kështu ka qenë, edhe të dhënat janë të sakta, por edhe atëherë ka qenë shqetësimi im se kjo rritje e të sëmurëve është e lidhur drejtpërdrejt me ambientin dhe me kushtet sociale, si faktorë që ndikojnë në rritjen e të sëmurëve. Ka pasur kundërshtime, por sot ky debat parlamentar po e vërteton atë nga të gjithë njohësit e kësaj fushe se kushtet e ambientit dhe kushtet sociale ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e sëmundshmërisë dhe nuk është ndonjë punë që ka qenë për t'u lavdëruar në aspektin e kujdesit shëndetësor, por që është një punë, e cila ka ndodhur në aspektin e ndotjes së ambientit dhe kjo ka ndikuar në rritjen e sëmundshmërisë.

Ndotja e ambientit lidhet me shumë faktorë, e të cilët drejtpërdrejt janë të lidhur edhe me menaxhimin institucional, edhe të vetë ndërtimeve, të cilat kanë ndodhur në komunën e Prishtinës që nga paslufta e deri sot. Pra, është më se e vërtetë që ndërtimet e egra dhe ndërtimet pa leje kanë ndikuar që edhe ajo zonë e gjelbër, e cila ka qenë e paktë në komunën e Prishtinës, të rrënohet. Për më keq edhe ato zona, të cilat kanë qenë të gjelbra në lagje të caktuara, siç është ajo e Rrugës B, edhe ato të ndërtohen pa asnjë kriter dhe tani kemi një kryeqytet nga betoni, ku nuk mund të ndodhë pastrimi i ajrit, sepse të shihet një pemë e gjelbër, një dru i gjelbër në Prishtinë është shumë e rrallë.

Pra, duhen masa, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt, lëshimi i lejeve ndërtimore, që të respektohen kriteret e zonës së gjelbër, e kjo nuk ka ndodhur nga paslufta në komunën e Prishtinës, e për fatin e keq të qytetarëve të Republikës së Kosovës një dukuri e tij është bartur edhe në komnatat e tjera dhe besoj që problemi i njëjtë pastaj do të bartet edhe atje.

Tek çështja e ambientit që lidhet drejtpërdrejt edhe me ajrin, por edhe me gjithë sistemin e mbrojtjes së ambientit, kemi diskutuar edhe këtu në Parlament, unë mendoj që përveç asaj ndotjes që i ndodh Obiliqit nga termocentralet, në Obiliq është edhe një bombë ekologjike tjetër, për të cilën Ministria e Ambientit dhe Qeveria e Kosovës duhet të kenë parasysh të investojë në

mënyrë urgjente. Deponia e mbeturinave në Obiliq, e ndërtuar nën zonën e lumit Sitnica, bën që depërtimi i ujërave të ndodhë dy anshëm, nga lumi Sitnica në deponi dhe pastaj, nga ato në lumin Sitnica sërish. Pra, investimet të cilat kanë qenë të planifikuara dhe kërkesat të cilat kanë qenë të vazhdueshme për të investuar në atë deponi, janë refuzuar dhe nuk janë përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe shpresojmë që ajo bombë ekologjike në Mirash të evitohet dhe të investohet, sepse do të ndodhte një katastrofë ekologjike ambientale, sepse i tërë sistemi ynë varet, edhe sistemi ekologjik varet, është i lidhur me njëri-tjetrin. Pra, çka duhet të veprojmë tutje që kjo ndotje të zvogëlohet, pra që të gjithë ata të cilët janë përgjegjës të marrin masat e duhura, duke filluar nga moslëshimi i lejeve ndërtimore, nëse ato nuk plotësojnë kriteret e zonës së gjelbër dhe të gjithë faktorët e tjerë, të cilët janë të lidhur me rritjen e mbrojtjes së ambientit dhe duke bërë pyllëzimin, një çështje e cila është më se e nevojshme.

Ajo që ka ndodhur, degradimi ambiental i njëpasnjëshëm qoftë në pyje, në prerjen e tyre, rrënimi i lumenjve e pastaj rrënimi ambiental në qytete, gjithashtu një prej dukurive të cilat duhet të ndërpritet dhe kjo të vendoset brenda suazave ligjore. Duhet të kemi kujdes që nëse kemi investuar në ngrohjen e kryeqytetit, i cili është një sistem ekologjik dhe ngrohja e qytetit me mazut, e cila e ka ndotur qytetin do të thotë është zvogëluar, atëherë sigurisht që kjo ndotje do të duhej të zvogëlohej, por që gjithsesi ngrohja do të duhej t'u ofrohej të gjithë qytetarëve të Prishtinës, edhe ekonomive private, por edhe të gjithë të tjerëve që kjo të jetë me një çmim shumë më të lirë dhe jo me çmimin aktual, sepse çmimi aktual i ngrohjes në qytet është shumë i lartë, prandaj qytetarët për ngrohje, por edhe bizneset private i shfrytëzojnë ato mundësi të ngrohjes me çmime më të lirë dhe kjo pastaj ndikon në ndotjen e ambientit, sepse çmimi më i lirë sigurisht që në treg është ai i thëngjillit. Por, gjithsesi nëse ne ofrojmë kushte më të lira dhe të ngrohjes më të mirë me sisteme të tjera, të cilat sigurisht që institucionet tona do të kishin përgjegjësi që të ofronin në mënyrë ekologjike edhe në aspektin edhe më të mirë, edhe më të lirë, atëherë sigurisht që kjo ndotje do të zvogëlohej.

Pra, përgjegjësia është e përbashkët e të gjithëve, por që përveç atyre që u quajtën edhe simpoziume shkencore, neve do të na takonte të merremi më shumë me aspektet ligjore dhe me monitorimin e ligjeve, të cilat ky Parlament i ka aprovuar, e të cilat nuk po zbatohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Labinot Tahiri, të bëhet gati deputetja Fitore Pacolli-Dalipi.

LABINOT TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Të gjithë ata që janë staf i Parlamentit,

Qytetarë të nderuar,

Ministre, ju përshëndes,

Do të filloj me një kritikë, arsyeja e mosmarrjes pjesë e Listës serbe në Parlament, mosmarrja pjesë e tyre në këtë seancë po na injoron neve si shqiptarë të këtij Parlamenti. E dyta, ata po jetojnë në Prishtinë e në Kosovë dhe është shqetësimi i njëjtë ndotja e ambientit edhe për ata, por le ta dinë se nuk mjafton të bashkëpunojmë vetëm kur ata duan bllokimin e proceseve të Kosovës, siç është formimi i ushtrisë. Nëse ne kemi shqetësim për ambientin dhe ndotjen e ambientit në Prishtinë ose në Kosovë, edhe ata duhet të jenë pjesëmarrës nëpër këto seanca të jashtëzakonshme ose ndoshta nuk u dhimbsen qytetarët e tyre të komunitetit serb.

Tjetra, mosmarrja pjesë edhe e deputetëve shqiptarë në Parlament, ku isha nënshkrues i kësaj seance të jashtëzakonshme dhe sot po shihet se sa janë këtu, na tregon se sa e meritojmë t'i marrim pagat tona mujore nga shteti. Pra, s'e meritojmë fare! Njashtu, do të kisha kërkuar nga deputetët dhe qytetarët që të mos i drejtohen vetëm zonjës Reshitaj, ministres, për këtë gjendje të rëndë, sepse nuk është kah jeton vetëm ministrja në Prishtinë ose në Kosovë, por janë shumë ministra dhe kryeministri e presidenti, e të gjithë ne deputetët që duhet të marrim masa rreth kësaj ngjarje që po ndodh. Nëse duan qytetarët e Prishtinës dhe të Kosovës që kjo punë të marrë kahe më serioze dhe të merren masa për t'u zgjidhur ky problem, unë i sugjeroj popullit ose qytetarëve të Prishtinës le të dalin masivisht në protesta, sepse nuk merret asnjë vendim të kryhet nëse nuk çohet populli në këmbë.

Arsyeja pse po e them këtë është vetë pasqyra e këtij Parlamenti këtu, se sa serioz e marrim shqetësimin e qytetarëve, të cilët ishin në protesta ose edhe atyre që po u shkakton dëm ndotja e ambientit. Për fund, kërkoj nga ministri Sefaj që t'i lirojë rrugët dhe policinë në këtë kohë të ftohtë, sepse nuk është zgjidhje ky bllokimi i rrugëve, po ashtu arsyeja e zhbllokimit të rrugëve duhet të bëhet sepse Prishtina është qytet i demokracisë sjellëse në Kosovë dhe nëse vazhdojmë kështu t'i shohim rrugët e bllokuara në Prishtinë, Prishtina po duket si të ishte Koreja Veriore. Prandaj, kërkoj që të bëhet zhbllokimi i rrugëve dhe ta falënderoj nga zemra këtu publikisht deputetin më të vjetër, simbol i Parlamentit që është shembull me prezencën e tij, në marrjen e pjesë të seancave, zotin Adem Mikullovcit. Pra, le të marrim shembull nga ai i cili edhe gjendjen shëndetësore nuk e ka mirë, e po merr pjesë, e ne këtu i marrim pagat dhe nuk marrim pjesë në Parlament. Faleminderit! Labinot Tahiri, Ferizaj, Kosovë e Shqipërisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Fitore Pacolli-Dalipi, pas saj do ta marrë fjalën deputetja Vjosa Osmani-Sadriu. Urdhëro, Fitore!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Ditëve të fundit presioni i lartë i qytetarëve dhe shoqërisë civile mbi institucionet qendrore dhe lokale ka bërë që të merren disa masa të menjëhershme për të zbutur sado pak situatën e krijuar. Mirëpo, për t'u ballafaquar seriozisht dhe sinqerisht me problemin duhet të bëhen hapa konkretë dhe afatgjatë. Por, kjo nuk mund të bëhet përderisa vazhdohet me vendime arbitrare, gjithnjë nën

kushte të urgjencës dhe në përputhje me interesat private të disa qeveritarëve, e në mungesë të një vizioni zhvillimor për vendin.

Nëse bëjmë një kërkim të thjeshtë që nga paslufta e deri më tani, shohim se volumi i lajmeve dhe diskutimeve, si dhe presioni qytetar dhe ai i shoqërisë civile rreth ndotjes së ajrit shtohet gjatë stinës së dimrit dhe bie me ardhjen e pranverës, për t'u shtuar prapë në fillim të dimrit. Thuajse me ndotje po ballafaqohemi vetëm gjatë dimrit. Ndonëse, niveli i ndotjes është më i lartë në këtë periudhë të vitit, nuk do të thotë se kemi ajër të pastër gjatë verës. Ndërsa, qeveritë që nga paslufta e deri më tani, për shkak të presionit të qytetarëve gjatë periudhës së dimrit përmes konferencave e tavolinave të diskutimit dhe përpilimit të strategjive, të cilat hartohen vetëm për të mbuluar apo për t'iu përshtatur kontratave të dëmshme, bën përpjekje për të ulur presionin dhe jo për të zgjidhur problemin. Ndërsa, muajve të pranverës dhe të verës, kur presioni qytetar ishte më i ulët, u lejua degradimi i atyre pak hapësirave të gjelbra që kishin mbetur, shndërrimin e tokave bujqësore në ato ndërtimore për interesa individuale dhe privatizuan industritë vendore pa kriteret minimale për mbrojtje të ambientit. Shembull konkret mund të përmendet fabrika e Ferronikelit, e cila në vend se të ndikonte në zhvillim ekonomik e social, u shndërrua në fabrikë helmuese për banorët e Drenasit.

Ndotja e ajrit nuk është diçka e re dhe as problem që është shfaqur rishtazi, por problem me të cilin po ballafaqohemi tani e disa vjet. Tani kur po diskutojmë për këtë problem të kamotshëm, nuk kemi asnjë studim thelbësor nga institutet, agjencitë apo institucionet përkatëse.

Si rrjedhojë, sot nuk ka as pajtim në mes të institucioneve përgjegjëse se kush janë ndotësit kryesorë, si dhe për hapat që duhet të ndiqen. Tani kur po diskutojmë për këtë problem, nga presioni i madh, edhe ministrja Reshitaj para disa ditëve u detyrua të thotë se kjo gjendje e krijuar nuk mund të zgjidhet me një 'shkop magjik'. E vërtetë, por, përderisa nuk paskemi 'një shkop magjik' për të dalë nga kjo katastrofë mjedisore, e krijuar për vite me radhë, kemi mundësi që sot të dalim me një rezolutë për të angazhuar ekspertët vendorë, agjencitë dhe institutet përkatëse që së pari të analizojmë gjendjen e krijuar, pra të kuptojmë se kush janë ndotësit kryesorë dhe në bazë të analizës të ndërmerren hapat e nevojshëm. Praktikrat e mira për mbrojtjen e ambientit dhe masat që aplikohen nën presionin e krijuar nuk mund të vendosen brenda natës dhe mbi të gjitha, pa një studim profesional të gjendjes.

Ditëve të fundit, pa u bazuar në ndonjë studim u fajësuan amvisëritë, familje, shumica të varfra, të cilat përdorin thëngjill për ngrohje. U tha se ato janë ndër ndotësit kryesorë dhe se duhet të ndryshojnë mënyrën e ngrohjes, pra, në situata të tilla kur kemi mungesë strategjie e vizioni dhe presion për të ndryshuar gjendje, atëherë shumë lehtë ka rrezik të aplikohen politika që godasin së pari të varfrin. Rritja e paarsyeshme e çmimit të rrymës ka detyruar shumë banorë të shfrytëzojnë thëngjillin si alternative më të lirë për ngrohje.

Pra, në vend se të drejtojmë gishtin drejt atyre që mezi po ia dalin të mbijetojnë, qeveria duhet seriozisht të punojë të bëjë zgjidhje tjetër për ngrohje, gjithnjë duke u bazuar në analiza paraprake. Pasi, procesi i kogjenerimit në Prishtinë po funksionon shumë mirë, atëherë duhet të bashkohen forcat që zgjerimi i rrjetit të mbulojë sa më shumë banesa kolektive, shkolla, qendra mjekësore dhe shtëpi individuale dhe të bëhet një zgjidhje e mirë për ngrohje në fshatra. Përderisa Prishtina ka mundësi të zgjerojë tutje sistemin e ngrohjes, problemi mbetet edhe për qytetin e Kastriotit dhe të Fushë-Kosovës, si dhe shumë qytete të tjera, të cilat nuk kanë ndonjë sistem funksional të ngrohjes. Prandaj, është e rëndësishme që të angazhohen ekipe profesionale që të punohet për të parë mundësitë e krijimit të sistemeve moderne për ngrohje në këto qytete.

Vendimi i Komunës së Prishtinës për të ndaluar qarkullimin e veturave në qendër të Prishtinës, ndonëse nuk dihet ende për efektin pozitiv që mund ta ketë, duhet vlerësuar. Ndalimi i qarkullimit të veturave në qendër të qytetit në të ardhmen, duke u bazuar në hulumtime të mirëfillta, duhet të fillojë në mënyrë graduale, duke krijuar mundësi për të arritur në qendër përmes shtimit të autobusëve dhe biçikletave të qytetit, krijimit të shtigjeve të sigurta për çiklistë dhe ngritjen e sigurisë për këmbësorë. Po ashtu, puna e mirë që është bërë gjatë katër vjetëve të fundit në Prishtinë me fillimin e reformave në trafikun urban, mbjelljen e fidanëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra, duhet të vazhdojë dhe të merren model edhe nga komunat e tjera.

Përveç kufizimit të qarkullimit të veturave, institucionet përkatëse duhet të kontrollojnë dhe të analizojnë lëndën djegëse e cila hyn në Kosovë, shpeshherë e pakontrolluar dhe shitet nëpër pompa të derivateve. Kujtojmë kohën kur Komuna e Prishtinës mbylli shkollat për shkak të cilësisë së lëndës djegëse që përdorej për ngrohje. Lënda djegëse nuk ishte naftë, siç ishte paraparë, por ‘vaj djegës’ dhe sipas analizave të bëra nga një institut në Evropë, ky vaj kishte përmbajtje të sulfurit mbi 800 ppm, ndërsa vlera e lejuar është vetëm 10 ppm. Ky lloj vaji në shtetet e Bashkimit Evropian lejohet të përdoret vetëm në industrinë e anijeve, të cilat kanë filtra të posaçëm. Vendimi i atëhershëm i komunës ishte cilësuar si i ngutshëm dhe asnjëherë nuk u hulumtua se si ky lloj i vajit, i ndaluar të përdoret në Kosovë, arrin të shitet brenda në vend dhe të shpërndahet nëpër shkolla, e ndoshta është përdorur dhe vazhdon të përdoret si karburant për vetura dhe për ngrohje. E sot kur po flasim për ndotjen e ambientit, në tregun tonë qarkullojnë karburante të pakontrolluara, të cilat hyjnë në vend në formën e kontrabandës, e cila mund të kontrollohet dhe të vërtetohet nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

Natyrisht, se shkaktari më i madhi ndotjes, i pambështetur në ndonjë analizë apo studim, vazhdon të cilësohen termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”. Mirëpo, kohëve të fundit po propagandohet me të madhe se me ndërtimin e termocentralit të ri do të përmirësohet cilësia e ajrit dhe pastaj më nuk do të kemi probleme të tilla. I gjithë ky konstatim, pa analizë paraprake. Në mungesë të informimit të drejtë këtë propagandë kanë filluar ta besojnë shumë qytetarë, se kinse ky termocentral me pajisje teknologjike moderne nuk do të ndotë ajrin. Me nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e këtij termocentrali pa ndonjë studim të mirëfilltë ambiental, qeveria ka

marrë vendim edhe për gjeneratat e ardhshme që përveçse qytetarët do të paguajnë prej xhepave të tyre, do të paguajnë edhe me shëndetin e tyre.

Ndotja që shkaktohet nga termocentralet nuk është vetëm ndotje e ajrit që ne e shohim, por ndotje e ujit dhe në tokave bujqësore. Të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe e dimë që situata energjetike në vend është e rëndë, por nuk duhet të lejomë që përmes vendimeve të ngutshme dhe aspak transparente të ndërtohet një termocentral për të cilin nuk është bërë asnjë studim i mirëfilltë ambiental. Paraja publike duhet të investohet në projekte, të cilat sjellin dobi për secilin qytetar dhe jo në projekte të cilat përveçse bëjnë qytetarin më të varfër, do ta bëjnë atë të ndihet edhe më i sëmurë.

Për fund, të nderuar qytetarë, presioni juaj nuk duhet të ndalet as pranverës, e as në verë, duhet të vazhdojmë të bëjmë presion mbi qeverinë që të fillojë urgjentisht hulumtimet e nevojshme për zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtërishme, investime në sigurimin e energjisë solare dhe energjisë gjeo-termike. Kosova duhet të fillojë të bëjë përgatitjet e nevojshme për kyçje në gazin natyral dhe për këtë tashmë ka studime, se kyçja e Kosovës në unazën e gazit është e realizueshme.

Është më se e rëndësishme që sa më parë të fillojmë formimin e sistemit të përbashkët energjetik me Shqipërinë, përmes të cilit jo vetëm se do të zgjidhnim problemet e tanishme me ndotjen e ajrit, si dhe me furnizim, por do të hapim mundësi për zhvillim pa pasur ndonjë nevojë ta kontaminojmë ambientin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, janë edhe tre kolegë, të cilët janë paraqitur që të diskutojnë sot. Unë edhe një herë lus kryetarët e grupeve parlamentare dhe kolegët deputetë që janë në ambientet e Kuvendit të kthehen në sallë, sepse shumë shpejt do të votojmë tekstin me rekomandime.

Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani-Sadriu, ndërkaq pas saj fjalën do ta ketë deputeti Rexhep Selimi.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse, askush nga Qeveria nuk është këtu dhe besoj që për një çështje të rëndësishme kaq të madhe është jo vetëm për të ardhur keq, por është mungesë e përgjegjësisë dhe seriozitetit dhe mosrespektim i obligimeve kushtetuese që i ka Qeveria e Kosovës. Unë nuk do të ndalem te disa rekomandime, për të cilat isha përgatitur të flas, qofshin ato sa i përket buxhetit të nevojshëm që do të nevojitet patjetër për t'u implementuar cilado nga masat për të cilat kemi folur këtu tash e dy ditë, qofshin disa prej rekomandimeve që i ka dhënë edhe shoqëria civile, e që kanë të bëjnë edhe me lehtësirat fiskale, edhe me taksën ekologjike, edhe me çështje të tjera që mund të ndihmojnë në mbrojtje të ambientit në përgjithësi, por edhe në përmirësimin e nivelit të ajrit. Por,

edhe shkakut i kritikave që i kemi marrë këto ditë si deputetë që po hyjmë në një fushë që nuk e kemi në ekspertizë, unë do t'i kthehem fushës sime të ekspertizës, pra fushës që e njoh pak më mirë dhe po e filloj me këtë.

E drejta në ajër të pastër është e drejtë themelore e njeriut. Trajtohet si e tillë nga një sërë organizatash ndërkombëtare, trajtohet si e tillë në mbi 100 kushtetuta të vendeve demokratike dhe trajtohet si e tillë në një sërë konventash ndërkombëtare, të cilat ne i kemi bërë pjesë të Kushtetutës sonë. Prandaj, ajo çka po ndodh këto ditë në Kosovë, besoj nuk e ekzagjeroj në qoftë se e karakterizoj si shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kur e kemi hartuar Kushtetutën e vendit kemi konsideruar që për t'u bërë shembull i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përtej atyre të drejtave që i kemi paraparë në Kapitullin II të Kushtetutës, duhet po ashtu t'i bëjmë drejtpërdrejt të implementueshme edhe një sërë konventash që mbrojnë qytetarët tanë, siç është Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Pakti për të Drejtat Civile Politike dhe një sërë konventash tjera.

Duke filluar nga e para, pra Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 24 është interpretuar nga një sërë organesh ndërkombëtare dhe ekspertësh si një nen që mbron fëmijët tanë, mbron shëndetin e tyre dhe garanton një ambient të pastër. Pra, në ambientin në të cilin po jetojnë fëmijët tanë është duke u shkelur një të drejtë e tyre kushtetuese. Pakti për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, po ashtu në nenin 7, në nenin 10 dhe nenin 12 kërkon që qytetarëve t'u garantohet një mjedis në të cilin ata mund ta mbrojnë shëndetin e tyre.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe pastaj vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat ne i kemi obligim kushtetues t'i zbatojmë sipas nenit 53 të Kushtetutës së vendit, kërkojnë po ashtu që të mbrohet ambienti, por, ndër të tjera, të mbrohen qytetarët nga ndotja e ajrit dhe rreziqet në shëndetin e tyre, që shkakton. Janë së paku dy vendime që janë identifikuar, rasti Lopez kundër Spanjës dhe rasti Guerra kundër Italisë, në të cilat Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka thënë se ndotja e ajrit, pra jeta dhe puna në një ajër që rrezikon shëndetin e qytetarëve karakterizohet si shkelje e nenit 8 të kësaj konvente, pra shkelje e cila ua mohon qytetarëve edhe të drejtën e tyre për një jetë familjare.

Prandaj, përveç kësaj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në një sërë rastesh, po ashtu pajtohem me disa kolegë që e ngrehën këtë çështje, ka thënë se në qoftë se institucionet publike nuk i informojnë qytetarët se çfarë rreziqesh për shëndetin e tyre po shkakton ndotja e ambientit, atëherë ai shtet po e shkel po ashtu edhe të drejtën e qytetarëve për t'u informuar. Kushtetuta jonë ka marrë për bazë disa prej zhvillimeve më moderne në këtë aspekt, prandaj e ka futur në nenin 52 edhe çështjen e ambientit. Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese ka vendosur në rastin "Fadil Hoxha dhe 49 të tjerë", që institucionet publike kanë për obligim që ta marrin mendimin e qytetarëve të Kosovës, para se të marrin vendime për çështjet e ambientit. Si rrjedhojë, po e

përsëris, çka po ndodh këto ditë është shkelje flagrante e të drejtave fundamentale të njeriut, të qytetarëve tanë, sipas cilitdo interpretim.

Prandaj, edhe duhet të merret me kaq seriozitet, prandaj çka po diskutojmë këto ditë nuk është çështje e rëndomtë, mirëpo për ta bërë edhe më të qartë këtë punë dhe obligimin e institucioneve publike në raport me ajrin e pastër, unë besoj se ka nevojë që Kushtetuta jonë të qartësohet edhe më tej.

Prandaj, propozimi im është ky:

Në qoftë se brenda gjashtë muajve institucionet publike nuk do të ndërmarrin asnjë nga masat emergjente, për të cilat ky Kuvend, por edhe ministra të caktuar kanë folur dhe kanë premtuar këto dy ditë, atëherë do të iniciojë amendament kushtetues në nenin 52 të Kushtetutës, ku tek pjesa e ambientit e drejta në ajër të pastër dhe e drejta në ujë të pastër do të cilësohet si e drejtë kushtetuese. Natyrisht që për një gjë të tillë do të duhen 40 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe unë shpresoj shumë që do ta shprehni vullnetin që ta përkrahni një iniciativë të tillë, e cila veçse do ta bënte Kushtetutën e Republikës së Kosovës si pjesë të mbi 100 kushtetutave të tjera demokratike, të cilat të drejtën në ajër të pastër e konsiderojnë të drejtë themelore dhe kushtetuese të njeriut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Në këtë iniciativë mund t'i merrni 40 deputetë, do ta kishit kryer këtë herë me këtë votim, në qoftë se janë të pajtimit deputetët. Urdhëro, fjala për ju!

VJOSA OSMANI: Natyrisht se kjo do të mund të bëhej edhe sot, mbledhja e nënshkrimeve. Megjithatë, siç e thashë, besoj se duhet të presim dhe ta shohim në qoftë se masat emergjente që u diskutuan nga ministrja e ambientit do të ndërmerren, ose jo. Në qoftë se brenda gjashtë muajsh asnjë nga masat që propozohen me rezolutën e këtij Kuvendi nuk ndërmerren nga institucionet publike, natyrisht që amendamentin kushtetues unë mund ta propozoj brenda ditës dhe shpresoj që do ta përkrahni dhe do ta nënshkruani. Sipas procedurave, ai duhet të kalojë edhe në Gjykatë Kushtetuese dhe ju si kryetar i Kuvendit do ta keni natyrisht këtë detyrë që ta dërgoni në Gjykatë për ta marrë mendimin, mirëpo zgjerimi i të drejtave të njeriut edhe në këtë kontekst unë nuk pres që do të paraqesë ndonjë problem, as gjatë interpretimit të Gjykatës. Thjesht, do ta bëjë Kushtetutën tonë pjesë të kushtetutave moderne, që të drejtën në ajër të pastër pra e konsideron si të drejtë kushtetuese të njeriut.

KRYETARI: Faleminderit! E mendova që edhe sot grupi punues ta fusë si pikë të rezolutës, pastaj në qoftë se nuk veprohet, ju e inicioni. Faleminderit për kontributin!

Atëherë, Rexhep Selimi e ka fjalën dhe deputeti i fundit është Faton Topalli, i cili është në listën e të deklaruarve. Të tjerë nuk kemi, atëherë jemi në proces votues.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Në radhë të parë, unë do të ju kërkoj falje të gjithë atyre që janë ekspertë të kësaj fushe, kur unë flas si jo ekspert. Nuk i jap vetes të drejtë që unë jam ekspert i ambientit, e aq më tepër i matjes së përmasave të ndotjes së ajrit. Mund të flas vetëm si qytetar, që çohem në mëngjes dhe e shoh ajrin e ndotur, ose e ndiej atë sa herë që qarkulloj në territorin, sidomos në Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Kastriot. Por, si jo ekspert unë i kam pyetur shumë të tjerë që kanë njohuri më të mëdha dhe jam informuar që veturat, ndonëse mund të kenë vit të prodhimit jo sikur në vendet evropiane, nuk del që janë njëri ndër ndotësit, ose thënë një ndër tre ndotësit më të mëdhenj të ambientit në Kosovë.

Prandaj, unë mendoj që marrja e masave sot e dje në ndalimin e qarkullimit të veturave në mungesë të masave adekuate dhe në mungesë të masave ndaj faktorëve kryesorë na nxjerr pak qesharakë, sepse pavarësisht se veturat janë ndotës faktor që mund të renditet diku në faktorët që e ndotin ambientit, nuk po dalin ndër tre faktorët më të mëdhenj. Dhe, rrjedhimisht vjen pyetja se kush është faktori më i madh, kush e ndot më së shumti ajrin në Prishtinë, por edhe në Kosovë? Kur flasim në Prishtinë, atëherë mjafton që ta kemi shikimin e mjaftueshëm, të shohim nga Kastrioti, të shohim KEK-un, ta shohim tymin e tij dhe e dimë se kush e ndot më së shumti ambientin në Prishtinë dhe në komunat tjera përreth. Madje, besoj të ju ketë rastisur ndonjëherë, që kur ka rënë Blloku 1, a Blloku 2, se nuk e di mirë se cili bllok bie, pra kur nuk punon KEK-u, është i vetmi rast që Prishtinën e sheh cep më cep, ose që nga Prishtina e sheh Fushë-Kosovën, ose Kastriotin.

Andaj, po më duket që nuk jemi duke i rënë problemit tamam në kokë me rastin edhe të trajtimit këtu në seancë, por sidomos në rastin e marrjes së masave adekuate. Kështu që jam shumë i bindur, pavarësisht dëshirës për të kontribuar në seancë, pavarësisht edhe dëshirës time dhe të kolegëve të mi për të kontribuar që ta kemi ajrin më të pastër, kjo seancë nuk do ta pastrojë ajrin. Të jeni të sigurt! Ata që e pastrojnë ajrin janë tjerë faktorë dhe po ashtu, kam frikë që edhe rezoluta që do ta nxjerrim në këtë, prapë edhe kjo rezolutë s'do ta pastrojë ajrin. Ajri pastrohet ndryshe. Uroj që përpiluesit e kësaj rezolute t'i kenë njohuritë e nevojshme të ekspertizës për ta bërë një gjë të tillë, por krejt çka mund të dalë pas kësaj seance, përgatituni mund të dalë ndonjë kontratë e re. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Topalli, para se ta merrni fjalën, kolegë deputetë, në qoftë se nuk kemi kuorum, na duhet një vendimmarrje, përndryshe edhe grupi punues, i cili është duke punuar, para njëzet minutave nuk mund të bëhet gati që ta sjellë materialin. Kështu që duhet ta kemi një vendimmarrje, ose ta shtyjmë në orën 16:00, ose të presim deri në orën 14:20, se për orën 14:00 të gjithë e kanë ditur që do të kemi seancë. Ka mundësi që prapë riciklohet e njëjta. Atëherë, ju bëj apel të gjithëve për orën 14:15. Atëherë e dimë nëse vijnë deputetët, kështu që nuk bëjmë pauzë pastaj fare, përndryshe disa masa duhet t'i marrim. Procesi i votimit është në

orën 14:15, për shkak se grupi punues është duke punuar, i ka kërkuar 20 minuta. Zoti Topalli, fjala për ju!

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Qeveritarë, në fakt s'qenka asnjë këtu.

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi takuar këtu në Prishtinë, në një seancë të veçantë të Kuvendit të Kosovës, sepse jemi shqetësuar për ndotjen e ambientit, e mbi të gjitha për ndotjen e ajrit. Faktikisht, derisa ne po diskutojmë sot këtu mbi Prishtinë, mbi shumicën e qyteteve të Kosovës, bien kambana të vdekjes nga termocentralet tona, që prodhojnë energji me linjit.

Sot jemi mbledhur këtu, sepse jemi të shqetësuar. A është ky shqetësim i arsyeshëm? Po! A është kjo temë e re? Jo! Nuk është temë e re. A dihet cilët janë fajtorët kryesorë të ndotjes së ajrit? Po, dihet. Janë termocentralet, industria, automjetet, amvisëritë private, e madje edhe bujqësia, të cilën nuk e përmendi askush. A ka fajtorë për këtë ndotje? Ka! A dihet cilët janë fajtorët? Po, dihen. Po, cili është fajtori kryesor? Cila është "nëna" e fajeve?

Unë këtu dua ta them një çështje, që kur e kam filluar punën si deputet më është thënë, së paku nga një deputet, që kur e kam pyetur se si është puna e deputetëve, që deputetët kërkojnë prej të gjithëve përgjegjësi dhe vetë nuk i japin askujt përgjegjësi. Ndoshta është kështu për disa, ndoshta edhe nuk është kështu, por unë dua të filloj nga përgjegjësia personale sa i përket ruajtjes së ambientit. Tre vjetët e fundit, përjashtuar këtu Ligjin për Obiliqin, nuk e kam ngrehur asnjëherë seriozisht ndonjë çështje që ka të bëjë me ruajtjen e ambientit, respektivisht me ruajtjen e ajrit. Pra, fajtor janë partitë politike pa përjashtim, kush më shumë, e kush më pak. Fajtor është Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe secili deputet veç e veç në legjislaturat e kaluara, por edhe në këtë legjislaturë, që me asnjë vendim parlamentar nuk e ka detyruar Qeverinë për t'i ndërmarrë masat e nevojshme, për ta ndryshuar qoftë edhe pjesërisht këtë gjendje. Fajtorë janë edhe ato parti politike që kanë qenë në pushtet gjatë 18 vjetëve të fundit dhe nuk kanë bërë asgjë për ambientin.

Pra, nëse politika është rregullatori kryesor i jetës dhe kjo është sigurisht kështu, atëherë politika është shkaktari kryesor për gjendjen e krijuar. Dihet botërisht që termocentralet me thëngjill janë ndotësit kryesor të ajrit. Ky nuk është ndonjë zbulim i ri. Për shembull, në Bashkimin Evropian çdo vit vdesin nga 23 mijë qytetarë para kohe për shkak të termocentraleve që përdorin thëngjill. Pra, kjo ndodh në vendet e zhvilluara me standarde të caktuara, me kontrole strikte dhe me masa sigurie, e lëre më te ne, ku një filtër ndërrohet një herë në 30 vjet.

Industria e varfër në Kosovë, hiç këtu termocentralet, nuk është e zhvilluar mjaft, prandaj edhe ndoshta roli i saj është më i vogël në ndotjen e ajrit. Pas termocentraleve, ndotësit kryesorë janë

makinat dhe amvisëritë private. Ndotja ekstreme nga makinat u dedikohet 100% praktikave të të gjitha qeverive të deritashme, por këtu mbajnë përgjegjësi edhe deputetët që e kanë lejuar këtë, që Kosova është kthyer në një vend, ku të gjitha makinat e këqija të shteteve të Bashkimit Evropian, të dala prej përdorimit, vijnë këtu dhe e ndotin ajrin. Pra, rrogat e administratës dhe çfarëdo investimi në Kosovë ne e paguajmë në një mënyrë apo në një tjetër me gjak, me jetë njerëzish, sepse me makinat bërlllok të shteteve të Bashkimit Evropian e ndotim ambientin në Kosovë.

Edhe ndotja nga amvisëritë vjen si rezultat i gjendjes ekonomike dhe i pamundësisë për të siguruar stufa ekonomike dhe sisteme ngrohjesh, që nuk e dëmtojnë, apo e dëmtojnë më pak ambientin. Megjithatë, duhet shtuar edhe këtë së paku nga një ekspert i kësaj fushe, nga Luan Shllaku është thënë që termocentrali harxhon, respektivisht djeg aq shumë sa të gjitha amvisëritë gjatë një sezoni brenda një dite. Për habinë time, një ditë para kësaj seance, sot dy, janë marrë disa masa që e përkufizojnë ndotjen e ambientit në rrugët e Prishtinës. Unë e përgëzoj Komunën e Prishtinës dhe Ministrinë e Ambientit për veprimet e ndërmarra. Sot mësuam që në punë mund të shkohet pa makina, që mund makinat të parkohen edhe jashtë qytetit të Prishtinës, që transporti urban kur është funksional e luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ambientit. Por, këto masa i shërbejnë më shumë ngritjes së vetëdijes, janë më shumë një moment i cili na tregon se çfarë problemesh të mëdha kemi, një moment i cili tregon se gjelbërimi, transporti urban, pra parkingjet janë të rëndësishme, por nuk luajnë ndonjë rol të madh për çështjen e ruajtjes së ambientit, sepse ndotja e ambientit nuk është çështje metrash e as kilometrash, por e qindra kilometrash.

Kështu për shembull, termocentralet e thëngjillit në Gjermani, ku konsiderohet se kontrolli dhe masat e mbrojtjes janë strikte, çdo vit shkaktojnë vdekjen e parakohshme të 4 350 qytetarëve, prej të cilëve 2 500 jashtë Gjermanisë. Polonia prej 5 830 vdekjeve të parakohshme të shkaktuara nga termocentralet me thëngjill i shkakton 4 700 në vendet fqinje. Franca, e cila nuk gati fare termocentrale, ka 1 300 të vdekur të parakohshëm për shkak të termocentraleve në Holandë. Tani, ju mund ta paramendonit se çfarë do të thotë mbrojtja me nga 100 metra, kur dihet saktësisht pasi ka hulumtime evropiane, që ndotja e ambientit nga termocentralet kalon disa qindra kilometra.

Jemi në një situatë jashtëzakonisht të vështirë, e me masa emergjente ditore dhe me çështje metrash nuk zgjidhet çështja e ruajtjes së ambientit, e as çështja e ruajtjes së ajrit në Prishtinë. Të rrezikuar nga termocentralet tona nuk është veç Prishtina, nuk është vetëm Fushë-Kosova e Obiliqi, që janë shumë afër termocentraleve, por janë edhe të gjitha qytetet e Kosovës.

Nga të gjitha diskutimet deri më tani kemi parë se nuk kemi ndonjë analizë sa i përket situatës, respektivisht sa i përket emërimit të ndotësve kryesorë të ambientit, pra nuk ka matje të sakta mbi të cilat pastaj mund të përpunohen strategjitë e caktuara. Krahas kësaj si Qeveri duhet të

angazhohemi që ligjet ekzistuese për mbrojtjen e ambientit të zbatohen në raport me termocentralet, në raport me makinat, në raport me amvisërinë dhe në raport me bujqësinë. Shpresoj që rezoluta, e cila do të përpilohet shpejt, ta paraqesë edhe një afat të caktuar kohor për Qeverinë, po edhe për ne si Kuvend, për t'i ndërmarrë masat e nevojshme për ruajtjen e ambientit, respektivisht për përmirësimin e ajrit. Po them qëllimisht, jo në Prishtinë, Obiliq, por në gjithë Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,
Me qaq e konsideroj të mbyllur debatin. Faleminderit për kontributin dhe seriozitetin e marrë. Tani unë po ia lë pjesën kur të vijë grupi punues, na jep edhe përfundimin dhe propozimin e projekt-rezolutës, në mënyrë që të shkojmë drejtpërdrejt në procesin e votimit bashkërisht. I ftoj kolegët deputetë, kryetarët e grupeve parlamentare, që t'i ftojnë kolegët deputetë. Në momentin që t'i kemi 61 deputetë në sallë, e votojmë menjëherë, ose e presim orën 2:15.

Edhe një herë, publikisht kërkoj nga kolegët deputetë, të cilët e kanë ndërmend të marrin pjesë në votim, le të vijnë.

Për korrektësi, jemi duke e pritur grupin. Tre-katër minuta, me aq sa po më thotë Administrata.

Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, në emër të grupit punues e ftoj zonjën Evgjeni Thaçi-Dragusha, që të na lexojë projekt-rezolutën dhe ta japë arsyetimin. Urdhëro, zonja Thaçi! Faleminderit!

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Kosovës,
Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, në Seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më 31 janar dhe 1 shkurt 2018 për gjendjen alarmante të cilësisë së ajrit, pas debatit parlamentar, në harmonizim me të gjitha grupet parlamentare, nxjerr këtë:

REZOLUTË

1. Mbrojtja e ambientit të shndërrohet në prioritet shtetëror të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të rishikohet dhe të plotësohet me masa shtesë Strategjia Nacionale për Mbrojtjen e Mjedisit Burimet e Ripërtërishme të Energjisë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2018.
3. Të vendosen elektro-filtrat e cilësisë së duhur në termocentralet e KEK-ut deri në fund të vitit kalendarik 2018.

4. Të bëhet kontrolli i cilësisë së karburanteve dhe gazit sipas ligjeve në fuqi, si dhe të sigurohen kapacitetet e duhura deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 për të siguruar kontroll cilësor.
5. Të ndahet buxhet për izolimin e ndërtesave publike (me prioritet objektet shëndetësore dhe arsimore) për të siguruar efikasitet të energjisë dhe ngrohje të mjaftueshme dhe ambientalisht të pranueshme.
6. Qeveria obligohet ta shikojë mundësinë që të ndajë buxhet shtesë që do t'i shtojë mjeteve tashmë të dedikuara nga MCC (Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit të SHBA-ve) në vlerë prej 22 milionë USD, me qëllimin që të ndihmohen projektet e ndërlidhura me efikasitet.
7. Të shtohen investimet kapitale për Ndrohtoren "Termokos", duke siguruar fonde shtesë për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit, nga 140 MW energji termike të tanishme në 280 MW energji termike, në mënyrë që të zgjerohet më shpejt rrjeti i ndrohtores në të gjitha lagjet e kryeqytetit ku kjo është e mundur nëpërmjet projektit të kogjenerimit. Po ashtu, të krijohen mundësitë që edhe qytetet e tjera të lidhen me këtë projekt, në afat dy vjeçar.
8. Të koordinohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në kërkesat e komunave dhe institucioneve përkatëse, në përputhje me Strategjinë e rishikuar Nacionale për Mbrojtjen e Mjedisit për mbjellje të fidanëve, krijimin e hapësirave të reja gjelbëruese, si dhe të shikohet mundësia e implementimit të pajisjeve me teknologji të avancuar, si drunjtë e mençur.
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga komunat me ajër të ndotur që t'i shikojnë me urgjencë politikën për subvencionimin e qytetarëve që përdorin ngrohje me lëndë djegëse të dëmshme për ambientin dhe këtyre t'u krijohen mekanizma për të kaluar në mënyra më të pastra për ngrohje.
10. Qeveria të marrë vendim për ndalimin e përdorimit të thëngjillit për ngrohje të ndërtesave kolektive.
11. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës, respektivisht ministria përkatëse që investitorët e interesuar për investime në ndërtimin e kapaciteteve me Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë t'i ndihmojë që të pajisen me dokumentacion dhe lejet e duhura që të fillojnë ndërtimin e këtyre kapaciteteve të reja, të bazuara në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
12. Të ndërmerren hapa konkretë për lidhjen në gazsjellës nëpërmjet Shqipërisë, i cili krijon mundësinë e përdorimit të gazit, që do të kishte përfitime mjedisore dhe ekonomike.
13. Të ndërmerren hapa konkretë nga Qeveria e Kosovës që t'i ndihmojë qytetet e prekura nga ndotja e ajrit në ndërtimin e flotës për transport publik, duke shikuar edhe mundësitë për ndërtimin e kapaciteteve për transport modern elektrik.
14. Të menaxhohen efektshëm dhe të kontrollohen në mënyrë rigorozë deponitë e mbeturinave.

15. Kërkohet nga Qeveria që të marrë masa në sigurimin e cilësisë në kontrollin teknik të automjeteve sipas ligjeve në fuqi, direktivave të BE-së, me theks të veçantë në kontrollin e cilësisë së gazrave që emitohen nga këto automjete.
16. Kërkohet nga Qeveria dhe institucionet përkatëse që t'i respektojnë të gjitha ligjet në fuqi që ndërlidhen me ndotjen e ambientit, si dhe nga inspektoratet komunale dhe shtetërore që ta monitorojnë situatën në përputhje me ligjin.
17. Të inkurajohen dhe të përkrahen projektet kreative në funksion të përmirësimit të gjendjes aktuale shqetësuese të ndotjes së ajrit.
18. Në rast se Qeveria e Kosovës nuk i zbaton masat e propozuara, Kuvendi i Kosovës t'i fillojë procedurat për ndryshimet e nenit 52 të Kushtetutës së Kosovës, në mënyrë që e drejta për ajër dhe ujë të pastër të përfshihet si e drejtë e garantuar e njeriut me Kushtetutë.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim-rezolutës. Aktualisht i kemi 71 deputetë të pranishëm. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 73 deputetë. 73 deputetë janë për.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Rezolutën lidhur me ndotjen alarmante të ajrit. Faleminderit, kolegë!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*